



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

"Trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i personave të dënuar"

Tiranë, shkurt 2026

PËRMBAJTJA		Faqe
1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT		5
1.1 Konteksti i problemit social.....		5
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....		6
2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM		6
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....		6
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....		10
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....		11
2.4 Pesha në buxhet.....		12
2.5 Feedback-u i subjektit gjatë auditimit.....		14
3. DETAJET E AUDITIMIT		14
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....		14
3.2 Objektivi i auditimit.....		16
3.3 Pyetjet e auditimit.....		16
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....		16
4. SHITJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE		17
Pyetja kryesore: A siguron sistemi penitenciar trajtim dinjitoz, rehabilitim dhe riintegrim efektiv të personave të dënuar në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, për rikthimin e tyre në shoqëri?.....		17
Mesazhi i auditimit.....		17
4.1 A sigurojnë IEVP-të kushte dhe trajtim dinjitoz të të dënuarve në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare?.....		17
4.2 A sigurojnë programet e rehabilitimit dhe formimit profesional, përgatitjen e nevojshme të të dënuarve për rikthim aktiv në jetën shoqërore dhe ekonomike?.....		48
4.3 A ofrohen mekanizma dhe mbështetje e vazhdueshme për ish të dënuarit pas lirimit, për të lehtësuar rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri?		57
4.4 A sigurohet bashkëpunimi dhe kordinimi efektiv ndërmjet institucioneve përgjegjëse për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve?		74

Lista e shkurtimeve

RSH	Republika e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MD	Ministria e Drejtësisë
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme Shërbimi i Provës
AP	Avokati i Popullit
IEVP	Institucione të Ekzekutimit të Veprave Penale
IMP	Institucione mjekësore të posaçme
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
R&R	Rehabilitim dhe Ri-integrim
SKZHI II	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
OJF	Organizata jofitimprurëse
OSHC	Organizata e shoqërisë civile
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
KKSHM	Komiteti kombëtar për shëndetin mendor
KDNJ	Konventa për të drejtat e njeriut
KPTTÇP	Konventa për parandalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor e poshtëruës

PËRMBLEDHJE

Auditimi me temë "Trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i personave të dënuar", kishte si objektiv kryesor vlerësimin e kushteve të dënuarve në burgjet shqiptare dhe punën e bërë për rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve për rikthimin e tyre në shoqëri e familje me dinjitet, si dhe trajtimin e veprimtarive të institucioneve përgjegjëse, lidhur me garantimin e kushteve për një trajtim dinjitoz, sipas standardeve të kërkuara. Në këtë mënyrë, është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëpërmjet, identifikimit të mangësive lidhur, me shkallën e plotësisht dhe zbatimit të standardeve, me kryerjen e proceseve rehabilituese e integruese sa më me efektivitet dhe me propozimin e masave korigjuese, për të përmirësuar proceset dhe kushtet e trajtimit të dënuarve.

Periodha e auditimit ishte nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2024. Auditimi u fokusua në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, së bashku me disa njësi varësie (IEVP-të), Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Provës dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit.

Subjektet e përzgjedhura si dhe periodha e auditimit ishte për të pasur një panoramë më të plotë, lidhur me kompetencat dhe proceset që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të mirë menaxhimit të trajtimit dinjitoz të dënuarve në burgje dhe proceset e rehabilitimit dhe riintegrimin në shoqëri e familje. Auditimi u orientua në disa kolona bazë sa i përket veprimtarive dhe procedurave të ndjekura nga institucionet përgjegjëse në plotësimin e kushteve të ambienteve të vuajtjes së dënimit, si në akomodimin e tyre dhe në kushtet e tjera të nevojshme për nevojat që kanë si për argëtim, arsim dhe aftësim profesional, krijimin e klasave, laboratorëve dhe mundësimin e punësimit brenda burgjeve sipas legjislacionit të punës në fuqi. Po kështu në kolonat kryesore ishte auditimi i procedurave dhe proceseve që kryhen për rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve në kushtet brenda dhe pas përfundimit të dënimit e daljes në shoqëri e familje, duke kontribuar për tu shmangur recidivizmi dhe kthimi në aktivitet kriminal, bashkëpunimi me institucionet e tjera si Shërbimi i Provës, Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit e Bashkitë e vendit, këto si pritësit e para pas daljes nga burgju.

Sistemi penitenciar në Shqipëri nuk ka garantuar ende kushte dhe trajtim të plotë rehabilitimi dhe riintegrimi në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Masat e programuara si për përdorimin e burimeve financiare dhe strukturën e tyre, nuk janë orientuar dhe ndërlidhur drejt arritjes së objektivave specifike për financime të qëndrueshme në objektet e vuajtjes së dënimit për arritjen e standardeve të kërkuara. Infrastruktura është e amortizuar, me raste ekstreme si IEVP - të Rrogzhinë e Lushnje, ndërkohë që investimet kapitale janë fokusuar kryesisht në siguri dhe transport, jo në përmirësimin e kushteve të qëndrimit, arsimit, formimit profesional dhe aktiviteteve rekreative.

Nuk ka pasur bashkëpunim efektiv ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Shërbimit të Provës, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit, Ministrisë së Arsimit, pushtetit vendor dhe operatorëve ekonomikë, me marrëveshje që nuk janë zbatuar plotësisht dhe mekanizma referimi që nuk japin rezultate, të cilat nuk kanë shërbyer plotësisht, për kthimin e ish të dënuarve pranë familjeve e shoqërisë, si të barabartë, si dhe për shmangien e recidivizmit. Sistemi i burgjeve ka funksionuar kryesisht si strukturë ruajtjeje dhe jo si mekanizëm i plotë rehabilitimi e riintegrimi, duke rritur rrezikun e recidivizmit, duke mos përmbushur pritshmëritë ligjore dhe shoqërore. Investimet e kryera dhe menaxhimi i shërbimeve mbështetëse në përmirësimin e kushteve nuk e kanë arritur qëllimin e tyre në kryerjen e një procesi profesional, të drejtë e efektiv, në rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve pas lirimit, për trajtimin dinjitoz sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Programet rehabilituese – arsim, formim profesional, punësim, trajtim psiko-social dhe përgatitje prag-lirimi – mbeten me shtrirje të kufizuar, cilësi të ulët dhe nuk lidhen mjaftueshëm me nevojat reale të të dënuarve dhe tregut të punës, si brenda ashtu edhe pas lirimit.

Në përfundim janë gjeneruar gjetje, të cilat theksojnë mangësi të subjekteve nën auditim për të cilat janë dhënë rekomandime specifike shoqëruar me afatet kohore konkrete për zbatimin e tyre.

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

1.1 Konteksti i Problemit Social

Trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i personave të dënuar përbën një komponent themelor të sistemit të drejtësisë penale, me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë publike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm social. Qëllimi i dënimit me heqje lirie, sipas standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit kombëtar, nuk është vetëm izolimi i individit nga shoqëria, por nxitja e ndryshimit pozitiv të sjelljes dhe përgatitja e të dënuarit për t'u riintegruar si qytetar aktiv pas përfundimit të dënimit.¹

Shoqëria shqiptare ka përjetuar gjatë tri dekadave të fundit një proces të thellë demokratizimi dhe konsolidimi institucional, me synimin për ndërtimin e një shteti të së drejtës që respekton dinjitetin njerëzor. Edhe pse pjesa më e madhe e kuadrit ligjor është harmonizuar me standardet ndërkombëtare, zbatimi në praktikë përballet me kufizime që lidhen me burimet, infrastrukturën dhe kapacitetet profesionale.

Respektimi i dinjitetit njerëzor dhe siguri i kushteve që mundësojnë rehabilitimin dhe përmirësimin personal janë parime themelore të një sistemi penitenciar funksional. Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat Mandela)² përcaktojnë se qëllimi i dënimit nuk është ndëshkimi, por përgatitja e individit për një jetë të përgjegjshme dhe integrimin në shoqëri pas lirimit nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale.

Në kontekstin shqiptar, respektimi i këtyre standardeve ndërkombëtare mbetet një sfidë. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në fund të vitit 2024 në sistemin penitenciar ndodheshin gjithsej 4965 persona, prej të cilëve 2179 të dënuar dhe 2786 të paraburgosur. Kjo përbërje tregon një nivel të lartë të paraburgimit (rreth 56 %), i cili ngre shqetësime lidhur me respektimin e parimit të pafajësisë deri në shpalljen e fajësisë dhe me sigurimin e kushteve të përshtatshme të qëndrimit për këtë kategori.

Sistemi penitenciar në Shqipëri përballet me probleme të vazhdueshme, të evidentuara edhe në auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe në raportet ndërkombëtare, si mbipopullimi, infrastruktura e amortizuar, mangësi në shërbimet e hotelerisë dhe ato bazë, mungesa e stafit të specializuar, si dhe kapacitete të kufizuara për ofrimin e programeve rehabilituese dhe risocializuese. Sipas Raportit vjetor SPACE I të Këshillit të Evropës (2024), Shqipëria renditet ndër vendet evropiane me nivel të lartë mbipopullimi në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, çka ndikon në reduktimin e aksesit në programe trajtimi, në sigurimin e kujdesit shëndetësor në përputhje me standardet dhe në mundësitë për zhvillimin e aktiviteteve përgatitore për lirim dhe riintegrimin në shoqëri.³

Nga një këndvështrim social, personat e dënuar përfaqësojnë një grup të ndjeshëm që përballet me vështirësi të shumta pas daljes nga burgju. Mungesa e qasjes në arsim, punësim, strehim dhe kujdes shëndetësor, si dhe stigmatizimi social, e bëjnë procesin e riintegrit të vështirë dhe rrisin rrezikun e rikthimit në kriminalitet. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) thekson se mungesa e koordinimit midis institucioneve të burgjeve dhe shërbimeve komunitare pas lirimit është një nga faktorët kryesorë që pengon rehabilitimin afatgjatë dhe zvogëlon sigurinë publike.⁴

¹ Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” neni 12; Rregullat Mandela, Rregulli 91

² The United Nations Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners (the Nelson Mandela Rules) https://www.un.org/en/events/mandeladay/mandela_rules.shtml

³ Council of Europe – Prisons and Prisoners in Europe 2024: Key Findings of the SPACE I survey https://wp.unil.ch/space/files/2025/07/250715_key-findings-space-i_prisons-europe-2024_full.pdf

⁴ World Health Organization & United Nations Office on Drugs and Crime, “Prisons and Health”, 2014 https://www.unodc.org/documents/hiv-aids/publications/Prisons_and_other_closed_settings/2014_WHO_UNODC_Prisons_and_Health_eng.pdf.pdf

Qeveria shqiptare ka përfshirë objektivat e rehabilitimit dhe riintegritimit në dokumentet strategjike si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, Udhërrëfytyesi i Shtetit të së Drejtës si dhe Master Plani i Burgjeve 2024–2030, të cilat synojnë forcimin e rolit të shërbimeve psikosociale, arsimit, punësimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Megjithatë, sfidë mbetet zbatimi efektiv dhe vlerësimi i ndikimit real të ndërhyrjeve, në funksion të garantimit të kushteve të përshtatshme të trajtimit dhe zhvillimit të një procesi rehabilitimi me efektivitet të matshëm dhe qëndrueshmëri sociale.

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfytyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficientia dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

KLSH ndërmori auditimin “*Trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i personave të dënuar*”, për periudhën 2022–2024, duke e konsideruar këtë proces si një ndër çështjet më të ndjeshme të shoqërisë shqiptare dhe impakt të lartë social, me synim përmirësimin e trajtimit të tyre.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

- Ministria e Drejtësisë (MD)
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB)
- Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)
- Shërbimi i Provës (SHP)
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Provës (DRSHP)

Ministria e Drejtësisë (MD) organizohet dhe funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore në fuqi, ndjek dhe përgjigjet për realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë, si dhe harton projektet e akteve ligjore e nënligjore në fushën e drejtësisë. Ka për kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Ministria e Drejtësisë drejton sistemin e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale, drejton sistemin e ekzekutimit të vendimeve civile dhe të titujve ekzekutivë, kujdeset për ndjekjen dhe bashkërendimin e marrëdhënieve me shoqërinë civile për fushën e drejtësisë,

ndjek bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale dhe civile dhe, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është palë, realizimin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet kompetente të shteteve të tjera, si dhe me organizma ndërkombëtarë, kryen funksione dhe veprimtari të tjera në përputhje me ligjin⁵.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB)

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, ku detyra kryesore është menaxhimi i institucioneve kriminale, si dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për zbatimin rigoroz të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, duke i shndërruar dënimet penale në mundësi riedukimi.

Objektivat kryesore të sistemit të burgjeve janë si më poshtë:

- Mbajtja e të burgosurve dhe të paraburgosurve në kushte të përshtatshme sigurie dhe strehimi.
- Trajtimi human i të dënuarve dhe të paraburgosurve.
- Menaxhimi i efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë së përgjithshme në burgje dhe qendra të paraburgimit.
- Ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe trajtimin e personave të burgosur, në përputhje me legjislacionin në fuqi e standardet më të mira ndërkombëtare, me qëllim garantimin e të drejtave të personave të dënuar dhe të paraburgosur, si dhe rehabilitimin social e riintegrimin e të dënuarve.

IEVP-të janë autoritete administrative që ekzekutojnë vendimet e dhëna nga gjykata për mbajtjen dhe mbikëqyrjen e të burgosurve. Aktualisht ka gjithsej 24 burgje, 1 spital burgu dhe 1 institut për të mitur me kapacitet për të strehuar 6284 të burgosur.. Shifra mesatare e mbipopullimit referuar kapaciteteve të burgjeve ka pësuar rënie me -368 persona, në vitin 2022, me -82, në vitin 2023 dhe -775 persona në vitin 2024, si pasojë e amnistisë së miratuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kryen këto detyra:

- a) Bashkëpunon me institucionet e drejtësisë penale, institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura;
 - b) Garanton kushtet për ekzekutimin e vendimeve penale, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare, në funksion të rehabilitimit social dhe riintegrimin të të dënuarve;
 - c) Mundëson trajnim dhe kualifikime të veçanta në fushat përkatëse për personelin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale;
 - d) Harton aktet nënligjore në zbatim të legjislacionit në fuqi që rregullon sistemin e burgjeve;
 - e) Informon në mënyrë të vazhdueshme publikun për veprimtarinë e saj, në mënyrë që të kuptohet më mirë roli i sistemit të burgjeve në trajtimin e të burgosurve;
 - f) Ndjek vlerësimin e riskut dhe të nevojave të të burgosurve, si dhe realizon kategorizimin e shpërndarjen e tyre në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale;
 - g) Siguron shërbimet e kujdesit shëndetësor për të burgosurit gjatë kohës së qëndrimit në institucion, si dhe kushtet, mjetet e personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve;
 - h) Garanton ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor të nevojshëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe, në rast se ofrimi i këtyre shërbimeve është i pamundur të kryhet në këto institucione, shërbimet mundësohen në struktura shëndetësore të specializuara jashtë sistemit të burgjeve;
 - i) Nxit përfitimin, njohjen dhe certifikimin e kualifikimeve profesionale, si dhe kryerjen e lehtësimin e ndjekjes së kurseve profesionale, duke përdorur kurset me kohë të pjesshme;
- Në fushën e menaxhimit të burgjeve DPB ka për detyrë:
- j. Krijimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues duke siguruar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të sigurojnë një trajtim njerëzor të personave me liri të kufizuar dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi.

⁵ Ligji Nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e MD", i ndryshuar.

k. Zhvillimin e një strategjie të përshtatshme për sistemin e burgjeve dhe kushtet sociale në Shqipëri.

l. Hartimi i programeve të specializuara për të rritur punësimin e të burgosurve për çdo burg duke patur parasysh kushtet e çdo institucioni.

ll. Forcimi i sistemit të burgjeve dhe rritjen profesionale të stafit, duke i motivuar për të kryer një shërbim sa më të mirë, gjë e cila do të rriste sigurinë në shoqëri dhe do të kishte efekte pozitive në mbarëvajtjen e punës së institucionit.

m. Kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi⁶.

Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP-të) kanë për mision krijimin e kushteve të duhura për mbajtjen dhe trajtimin e personave të akuzuar e dënuar për kryerjen e veprave penale, ose të dënuar nga gjykata për këtë arsye, me qëllim që të mundësohet rehabilitimi shoqëror, në përputhje me rregullimet legjislativë në fuqi. IEVP-të janë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila është përgjegjëse për forcimin e sistemit të burgjeve dhe rritjen profesionale të stafit, duke i motivuar për të kryer një shërbim sa më të mirë, gjë e cila ndikon në rritjen e sigurisë në shoqëri dhe ka efekte pozitive në mbarëvajtjen e punës dhe zbatimin e programeve rehabilituese e përgatitjen për riintegrim në shoqëri pas kryerjes së dënimit nga të burgosurit.

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) kryejnë detyrat e mëposhtme:

- a) Presin, sistemojnë, trajtojnë, rehabilitojnë dhe riintegrojnë personat e burgosur;
- b) Sigurojnë trajtimin me dinjitet të personave të burgosur në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe të akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë;
- c) Sigurojnë mundësinë e trajtimit të të burgosurit nga mjeku specialist, sipas nevojave konkrete dhe sipas një regjimi kontrolli të mirëpërcaktuar;
- d) Sigurojnë trajtimin e veçantë dhe pa diskriminim për të burgosurit e mitur, gratë, personat me çrregullime të shëndetit mendor, të pasura ose të fituara giatë burgimit, dhe të burgosurit me aftësi të kufizuara;
- e) Sigurojnë rehabilitimin social dhe riintegrimin social e ekonomik që në fazën e paraburgimit;
- f) Garantojnë standardet e kushtet higjieno-sanitare, veshjen dhe kushtet e fjetjes së personave të burgosur, si dhe kushtet e ndriçimit, ngrohjes e ajrimit;
- g) Nxisin përfitimin, njohjen dhe certifikimin e kualifikimeve profesionale, si dhe kryerjen e lehtësimin e ndjekjes së kurseve profesionale, duke përdorur kurset me kohë të pjesshme;
- h) Detyra të tjera të parashikuara në akte ligjore dhe nënligjore.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), ka **mision** që të zhvillojë dhe mbështesë fuqinë punëtore nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të arsimit profesional, formimit, orientimit profesional dhe punësimit. Ai gjithashtu ofron mbështetje financiare dhe orientim në karrierë për punëkërkuarit e papunë. AKPA synon t'u ofrojë punëdhënësve shërbime të përputhjes së punëkërkuarit dhe mbështetje të tjera për të përmbushur nevojat e burimeve njerëzore të të gjithë punëdhënësve.

Vizioni i AKPA është të bëhet partneri i zgjedhur për të gjithë rinjtë, kursantët, punëkërkuarit dhe punëdhënësit, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të Formimit Profesional dhe punësimit me cilësi të lartë.

AKPA, në procesin e rehabilitimit dhe ri-integrimit të personave të dënuar mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi, kryesisht në Ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar, aktet nënligjore në zbatim të tij si edhe në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (DPB) nr. 17028 prot., datë 29.10.2024 dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (AKPA) nr. 2650 prot., datë 30.10.2024.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, nëpërmjet institucioneve ofruese të formimit profesional në procesin R&R merr përsipër:

⁶ VKM Nr. 127, datë 3.3.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”;

- a) Të ofrojë bashkëpunimin e ndërsjellët me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për formimin profesional të të burgosurve me kurse afatshkurtra.
- b) Të sigurojë zbatimin e procedurave dhe dokumentimin e proceseve për regjistrimin dhe pjesëmarrjen e të burgosurve në kurset e formimit profesional, deri në përfundimin e kursit dhe testimin përfundimtar për certifikimin e njohurive.
- c) Të sigurojë personelin mësimor dhe mësimdhënësit e formimit teoriko-praktik, në varësi të numrit të të burgosurve që ndjekin formimin profesional, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.
- ç) Për çdo ndryshim të mundshëm të personelit mësimor apo mësimdhënësve të formimit teoriko-praktik, të lajmërojë me shkrim drejtuesin e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale.
- d) Të përgatisë planet mësimore dhe programet lëndore për formimin profesional të të burgosurve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.
- e) Të monitorojë cilësinë e mësimdhënies në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (SHP)

Shërbimi i Provës ushtron funksionet e mëposhtme:

- a) mbikëqyr ekzekutimin e dënimeve alternative ndaj personave nën mbikëqyrje në zbatim të vendimeve gjyqësore dhe urdhrat të ekzekutimit të prokurorit, ku përfshihet edhe mbikëqyrja e të:
 - i) dënuarit të varur nga droga ose alkooli, i cili i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm rehabilitues;
 - ii) dënuarit të liruar me kusht;
- b) harton dhe mbikëqyr mënyrën e zbatimit të planit individual të trajtimit të personit nën mbikëqyrje, duke marrë për bazë risqet dhe nevojat për rehabilitimin dhe riintegrimin e tij shoqëror;
- c) mbështet personin nën mbikëqyrje, për kapërcimin e vështirësive për riintegrimin shoqëror gjatë dhe pas përfundimit të periudhës së provës.
- ç) adreson problematikat për punësim, strehim, arsimim, kualifikim dhe nevojat për mbrojtje sociale të personit nën mbikëqyrje, në mënyrë që të reduktohet në të ardhmen rreziku i recidivizmit dhe të mundësohet riintegrimi i tij në shoqëri;
- d) harton raporte vlerësimi dhe/ose raporton pranë prokurorisë dhe gjykatës në përputhje me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale dhe aktet e tjera ligjore apo nënligjore në fuqi;
- dh) mbledh në mënyrë sistematike të dhëna rreth veprimtarisë me personat nën mbikëqyrje;
- e) mbështet përmirësimin e praktikës së punës me personat nën mbikëqyrje.

2. Shërbimi i Provës ofron shërbime të aksesueshme për personat nën mbikëqyrje me shtetësi të huaj ose personat pa shtetësi, të dënuar nga gjykatat shqiptare. Për këtë qëllim, Shërbimi i Provës bashkëpunon me agjencitë dhe institucionet e shërbimit të provës në vendet e origjinës së shtetasve të huaj nën mbikëqyrje në zbatim të marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, për të lehtësuar sistemitet e nevojshme mbikëqyrëse gjatë kthimit të këtyre personave në vendin e origjinës⁷.

2.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim

Baza ligjore kryesore që rregullon aktivitetin e subjektit lidhur me çështjen nën auditim që do të jetë burimi i kriterëve të auditimit.

2.2.1 Kriteret politike

- Master Plani i MD 2024-2030⁸;

⁷ Ligji Nr.78/2020, datë 25.06.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës", i ndryshuar,

⁸ Miratuar me VKM 621, datë 22.10.2021

- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (DPB) nr. 17028 prot., datë 29.10.2024 dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (AKPA) ne. 2650 prot., datë 30.10.2024 ;
- Marrëveshje Bashkëpunimi nr. 8766/1 datë 24.11.2014, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.
- Marrëveshja e bashkëpunimit me Institutin për Aktivizëm dhe Ndryshim Social me nr. 300 prot., datë 08.02.2024;
- Marrëveshja e bashkëpunimit me Qendrën për Zhvillim Komunitar “Sot për të ardhmen” me nr. 364 prot., datë 20.02.2024;
- Marrëveshja e bashkëpunimit me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve me nr. 239 prot., datë 02.02.2024⁹;
- Nr. 5587 prot., datë 06.07.2009 MD dhe nr. 1366, datë 07.07.2009 MPCSSHB ”Memorandum bashkëpunimi midis MD dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta”.

2.2.2 Kriteret teknike dhe të monitorimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji Nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e MD”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e veprave penale”;
- Ligji Nr. 78/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 146/2015 “Për punëkërkuesit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 15/20 I 7 "Për arsimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;
- VKM nr. 867/2014 "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore", i ndryshuar;
- VKM nr. 554/2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive" i ndryshuar;
- VKM-ja Nr.837, datë 28.10.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për ofrimin e shërbimeve të punësimit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 535, datë 8.7.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të punëve publike në komunitet”;
- VKM nr.348, datë 29.4.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”;
- VKM nr. 17, datë 15.1.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”;

⁹ Marrëveshja e bashkëpunimit me Fakultetin e Drejtësisë me nr. 227 prot., datë 01.02.2024;
 Marrëveshja e bashkëpunimit me Fakultetin e Shkencave Sociale me nr. 943 prot., datë 10.06.2024;
 Marrëveshja e bashkëpunimit me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara me nr. 622 prot., datë 05.04.2024;
 Marrëveshja e bashkëpunimit me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit me nr. 1015 prot., datë 30.05.2022;
 Marrëveshja e bashkëpunimit me Shoqatën “Community Aid” me nr. 1018/2 prot., datë 08.06.2022;
 Marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin e Durrësit “Aleksandër Moisiu” me nr. 292 prot., datë 02.02.2023;
 Marrëveshja e bashkëpunimit me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me nr. 1237 prot., datë 17.06.2022;
 Marrëveshja e bashkëpunimit (Memorandum mirëkuptimi) ndërmjet Degës Territoriale Gjirocastër me Fondacionin “Antigonea” me nr. 555/2 prot., datë 19.04.2022;
 Marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” me nr. 565 prot., datë 21.03.2023;
 Marrëveshje bashkëpunimi me 53 Bashki të cilat i përkohjnë vitit 2022;
 Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Degës Territoriale Gjirocastër me “Shoqatën Multifunkionale për kulturë, edukim dhe zhvillim” me nr. 1005/1 prot., datë 30.05.2022;
 Marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin “Barleti” me nr. 317 prot., datë 13.02.2024;

- VKM Nr. 127, datë 3.3.2021 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve";
- Urdhër nr.519 datë 8.9.2021 i Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores së Disiplinës për Policinë e Burgjeve";
- VKM nr. 209 datë 06.04.2022 "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve";
- VKM nr. 646, datë 5.10.2022 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private, zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegrit social";
- VKM nr. 401, datë 19.6.2024 "Për përcaktimin e procedurave, kriterëve dhe rregullave për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegrit social";
- Urdhri i Kryeministrit nr. 173, datë 10.09.2024 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Shërbimit të Provës";
- Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 446, datë 19.09.2024 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Shërbimit të Provës";
- Udhëzimi nr. 5, datë 24.6.2024 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara, për mënyrën e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional të personave të dënuar me burgim që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale";
- Udhëzimi i përbashkët nr. prot., datë 24.06.2024 ndërmjet ministrisë së Drejtësisë dhe ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional të personave të dënuar me burgim që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale", si dhe te aktet e tjera ligjore në fuqi, duke vlerësuar arsimin, trajnimin profesional dhe ri-integrimin e personave të paraburgosur dhe të dënuar me burgim në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, si të drejta themelore".
- Rehabilitimi dhe riintegrimi jashtë kontekstit të burgut për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm Udhëzues për politikëbërësit dhe ofruesit e shërbimeve në Evropën Juglindore. OSBE Janar 2020¹⁰

• akte të tjera që mund të dalin gjatë auditimit.

Kriteret e monitorimit dhe raportimit:

- raporte vjetore DPB, AKPA
- analiza vjetore 2022, 2023, 2024 DPB, AKPA
- pasqyra statistikore DCS 2022-2024
- raportime në UPR Geneva nëntor 2024

2.3 Rëndësia e produkteve të subjekteve

Dokumentet kryesore të përgatitura për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimi e personave të dënuar janë:

- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (DPB) nr. 17028 prot., datë 29.10.2024 dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (AKPA) nr. 2650 prot., datë 30.10.2024;
- Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 8766/1 datë 24.11.2014, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë;
- Udhëzimi nr. 5, datë 24.6.2024 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara, për mënyrën e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional të personave të dënuar me burgim që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale";
- Udhëzimi i përbashkët nr. prot., datë 24.06.2024 ndërmjet ministrisë së Drejtësisë dhe ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara

¹⁰ Udhëzuesi i OSBE Vjenë Janar 2020

për mënyrën e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional të personave të dënuar me burgim që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”;

- VKM nr. 646, datë 5.10.2022 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private, zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegritimit social”, si dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Bazuar në sa më sipër, arsimimi, trajnimi profesional, riintegrimi dhe rehabilitimi i personave të dënuar në IEVP, janë të drejta themelore që duhet të respektohen, me synim hartimin e dokumenteve të punës nga institucionet përkatëse për rifitim të besimit dhe përgatitjen e tyre për jetën në liri.

2.4 Pesha në buxhet

Grupi i auditimit ka trajtuar buxhetin e angazhuar për të dënuarit në dy drejtime: Fonde të përdorura për trajtimin e të burgosurve në ambientet e IEVP-ve dhe fonde të përdorura për projekte apo procese për aftësimin profesional, arsimimin, laboratorë profesional dhe ambiente të përshtatshme për takime e qendrim me familjen dhe njerëzit e afërt të tyre dhe që i shërbejnë rehabilitimit dhe riintegritimit të dënuarve. Fokusi u vendos tek Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP-të, duke qenë se këto institucione janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejt me shërbimet që i ofrohen personave të dënuar, dhe efektet e politikave dhe aktiviteve të ndërmarra në këtë drejtim janë evidente dhe të matshme në riintegrimin e të dënuarve pas mbarimit të dënimit.

Dy subjektet e tjera AKPA dhe DP e Shërbimit të Provës nuk kanë fonde specifike të ndara për rehabilitimin dhe riintegrimin e personave që përfundojnë dënimin ose dalin me dënime alternative e mbikëqyrje.

Për analizimin e buxhetit të parashikuar dhe alokuar për periudhën 01.01.2022-31.12.2024, grupi i auditimit, mbështetur në të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, është fokusuar tek IEVP-të të cilat janë të dedikuara për shërbimin e trajtimin sa më dinjitoz të burgosurve. Objektivat dhe qëllimi i IEVP-ve, është përgatitja dhe zbatimi i programeve që i shërbejnë rehabilitimit dhe riintegritimit të tyre, nëpërmjet krijimit të kushteve sa më të mira të jetesës, infrastrukturës nevojshme për aftësim profesional, arsimim e edukim shoqëror sa më rezultativ e për ti përgatitur për një jetë më të mirë në shoqëri.

Në auditimin e kryer mbi fondet e planifikuara dhe përdorura për trajtimin e të burgosurve në burgje dhe kryerjen e proceseve të rehabilitimit dhe riintegritimit të tyre brenda burgut, por dhe pas daljes, analizimi i buxhetit u shtri në zërat kryesorë të buxhetit të DPBurgjeve (administratë dhe IEVP-të).

Tabela nr.1 Të dhënat e buxhetit për DP Burgje dhe IEVP-të .

Mijë/lekë

Zërat	Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024	
	Plan B. rishik.	Fakti	Plan B. rishik.	Fakti	Plan B. rishik.	Fakti
Sistemi i Burgjeve buxheti¹¹:	1,634,860	1,541,956	2,228,197	2,198,726	2,009,934	1,863,747
Sistemi (shpz. personeli & operative 000/ lekë (llog.600+601/602)	1,181,550	1,117,441	2,067,722	1,999,051	1,707,829	1,677,421
Sistemi (shpz. Kapitale/investime llog. 231 dhe projekte)	447,040	418,474 (93.6%)	216,800	195,013 (90%)	298,000	182,290 (62%)
Transferta brendshme për të dënuarit e moshës së	6,270	6,041	4,675	4,662	4105	4,037

tretë/kalimtare e ndihmë ekonomike llog. 604-606						
% e ndryshimit të buxhet të sistemit gjatë vitit (plan.Rish/Fakt)		-5.7%		-1.4%		-7.3%

Burimi: DPB/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga analizimi i tabelës së mësipërme konstatohet se, buxheti faktik i total sistemit të burgjeve ka pësuar rritje dhe ulje në varësi të viteve e konkretisht: Buxheti i vitit 2022 në krahasim me vitin paraardhës ka pasur rritje të vogël dhe fakti se nga buxheti i rishikuar gjatë vitit në vlerë 1,634,860 mijë lekë, rezulton se është përdorur buxheti faktik në vlerë 1,541,956 mijë lekë ose realizuar buxheti në total në masën 94% vitin 2022. Investimet në këtë vit buxhetor janë realizuar në masën 94.3 %, ku nga 447, 040 mijë lekë planifikuar janë përdorur 418,474 mijë lekë, konkretisht nuk ka përfunduar “Rikonstruksioni i godinave në IEVP Pojskë”. Investimet kryesore kanë qenë kryesisht “Blerje Automjete” në vlerë 127,954 mijë lekë dhe pajisje 83,344 mijë lekë krahas mirëmbajtjes dhe vendosjen e sistemit elektronik të menaxhimit vizitave hyrje-dalje në vlerë 145,290 mijë lekë. Siç konstatohet vërehet se fondet e planifikuar për investime e Meremetime të mëdha, nuk konsistojnë në veçimin e fondeve për investime kapitale, pasi po të shikohet vlera e amortizimit të objekteve sipas bilancit vitit buxhetor 2022 arrin në 580,000 mijë lekë dhe së paku fondi për investime duhet të jetë i barabartë me rreth 600,000 mijë lekë, në fakt kemi planifikim në vlerë 447,040 mijë lekë ose minimumi -153,000 mijë lekë, ku me këto afë që duhet të financoheshin mund të ndërtohej një burg i ri.

Buxheti i vitit 2023 në krahasim me vitin 2022 ka patur rritje në vlerë + 686,241 mijë lekë (1,541,956-2,228,197) ku në këtë vit nga buxheti i planifikuar e rishikuar në vlerën 2,228,197 mijë lekë janë përdorur në fakt 2,198,726 mijë lekë ose realizuar buxheti në masën 98.6 %. Në këtë vit buxhetor 2023 rritja më e madhe ka qenë në strukturën e shpenzimeve operative llog.602 në dyfishimin e vlerës e detyruar kjo për përdorim në mirëmbajtje e shpenzime të tjera për të bërë riparime e plotësime të ndryshme (kjo analizë kjo që do bëhet në shtjellimin e çështjes në materialin auditues), si dhe rritja e pagave dhe kontributit sig. Shoqërore rreth + 200,000 mijë lekë, ndërsa investimet janë ulur duke arritur nivel të ulët që në planifikim – 50% të investimeve të vitit paraardhës 2022 dhe këto janë realizuar në masën 90%, kjo ka sjellë një ndikim negativ në planifikimin dhe kryerjen e investimeve që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës të dënuarve apo planifikimin dhe kryerjen e investimeve afatgjatë në rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kushteve, përmes investimeve të qëndrueshme dhe që plotësojnë standardet e kërkuara. Po kështu në sistemin penitenciar ka dhe burgje të tjera që duan ndërhyrje , pasi gjendja është e pakënaqshme (gjersisht do e trajtojmë në materialet e auditimit).

Në lidhje me trajtimin e peshës në buxhet për objektin e rehabilitimit dhe riintegrimin nuk kemi të dhëna dhe nuk mundemi të gjejmë gjurmë auditimi e të hartojmë letrat e punës, paasi në zërat e buxhetit apo artikujt nuk kemi veçmas fonde apo burime financiare të destinuara për këtë qëllim, ndaj nuk kemi objekt trajtimi tek kjo pikë e programit. Trajtimi ynë jetë në vijim të auditimit kryesisht në efektivitetin dhe eficiencën e përdorimit të burimeve të ndryshme ekonomike e njerëzore në shërbim të përmirësimit të treguesve të trajtimit dinjitoz e rehabilitimin gjatë kohës vuajtjes dënimit dhe riintegrimin e të dënuarve në shoqëri pas përfundimit të dënimit si i barabartë.

Nga vlerësimi dhe analizimi i treguesve konstatohet se fondet e programuara ,alokuar në vitet buxhetore për periudhën 2022-2024 në zërin “investime” llogaria 230-231, nuk kanë pësuar rritje dhe fakti se investimet e vitit 2024 janë barazi me investimet e vitit 2022, tregon se vëmendja ndaj përmirësimit të kushteve dhe infrastrukturës në burgje nuk ka qenë e duhura. Nevojat për investime kapitale janë të mëdha, por është e nevojshme që rritja e standardeve të kushteve në ambiente sa më të mira, do të krijojë kushte për një trajtim dinjitoz të dënuarve në ambientet e IEVP-ve. Në vlerësimin analitik të zërit “Investime”, nuk evidentohet se nga DPB ka një planifikim real për investime për krijim ambientesh puntorie apo klasa për

përgatitjen e aftësimin profesional për profesionet kryesore që kërkon tregu jashtë mureve të burgut. Kjo u shërben të burgosurve të përfitojnë nga programet e rehabilitimit dhe të riintegrit, duke përfituar profesione që do ju vlejshëm shumë pas përfundimit të dënimit e përfshirjen në shoqëri me dinjitet e aftësi profesionale, që të përballojnë jetesën e tyre dhe familjes, pra të kenë një integrim efikas dhe mos ti kthehen kriminalitetit. Analizë të detajuar sipas llojit të investimeve do të kryejmë në trajtimin në materialet e auditimit në fazat e tjera në vijim.

2.5 Feedback-u i subjekteve në fazën studimore

Gjatë fazës studimore, subjektet nën auditim, i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese, gjithashtu dhe i janë përgjigjur në të njëjtën mënyrë plotësisht të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, që lidhet me vjeljen e të dhënave paraprake.

Vlen të theksohet gatishmëria e Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Drejtorisë Përgjithshme të Shërbimit Provës, gjatë gjithë auditimit në lidhje me kërkesat e grupit të auditimit.

3. Detajet e auditimit

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve

Vlerësimi i risqeve ka për qëllim identifikimin dhe analizimin e faktorëve që mund të ndikojnë negativisht në realizimin e objektivave të institucioneve përgjegjëse për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve, duke ndikuar në efektivitetin e politikave penitenciare dhe të drejtësisë penale. Analiza është mbështetur në shqyrtimin e dokumenteve strategjike dhe planifikuese, kuadrit ligjor dhe nënligjor, raporteve të auditimeve të mëparshme të KLSH-së, si dhe të dhënave të siguruar nga institucionet përgjegjëse.

Ky proces ka evidentuar risqe që lidhen me koordinimin institucional, burimet njerëzore, kushtet infrastrukturore të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe me efektivitetin e programeve të rehabilitimit dhe riintegrit pas lirim.

Tabela nr.2 Risqet e identifikuar:

Fusha e aktivitetit	Përshkrimi i riskut	Ndikimi që mund të kenë risqet e identifikuar	Niveli i riskut	Pyetja e auditimit
Kushtet dhe trajtimi në IEVP-të	Kushtet e akomodimit, higjienës dhe kujdesit shëndetësor në disa IEVP nuk plotësojnë plotësisht standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për trajtim dinjitoz.	Ndikon negativisht në mirëqenien dhe dinjitetin e të dënuarve, si dhe në efektivitetin e rehabilitimit.	I lartë	1.1 A sigurojnë IEVP-të kushte dhe trajtim dinjitoz të të dënuarve në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare?
Infrastruktura rehabilituese	Infrastruktura në disa IEVP, nuk është e përshtatshme për zhvillimin e programeve arsimore, profesionale dhe psikosociale.	Kufizon mundësinë e përfshirjes aktive të të dënuarve në programe zhvillimi e aftësimi profesional, si dhe përgatitje për jetën pas dënimit.	I lartë	1.1 A sigurojnë IEVP-të kushte dhe trajtim dinjitoz të të dënuarve në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare?
Burimet njerëzore dhe kapacitetet	Ka mungesë të stafit të specializuar psikosocial, arsimor dhe profesional në IEVP-të.	Cënohet cilësia e trajtimit dhe përgatitjes për riintegrim; efektiviteti i ulët i zbatimit të	I lartë	1.2 A sigurojnë programet e rehabilitimit dhe formimit profesional përgatitjen e

		programeve për këtë qëllim.		nevojshme të të dënuarve për rikthim aktiv në jetën shoqërore dhe ekonomike?
Programet e rehabilitimit dhe formimit profesional	Programet ekzistuese janë jo gjithmonë të përshtatura sipas profilit dhe nevojave të të dënuarve dhe nevoja që kërkon tregu jashtë burgut.	Ul efektivitetin e rehabilitimit dhe aftësinë e të dënuarve për t'u përshtatur pas lirimit në shoqëri e punësim.	I lartë	1.2 A sigurojnë programet e rehabilitimit dhe formimit profesional përgatitjen e nevojshme të të dënuarve për rikthim aktiv në jetën shoqërore dhe ekonomike?
Mbështetja pas lirimit dhe riintegrimi	Mungojnë mekanizmat e ndjekjes dhe mbështetjes pas lirimit, si dhe bashkëpunimi me strukturat vendore e shërbimet sociale pranë tyre.	Ish-të dënuarit mbeten pa përfshirje socialeve shoqërore, strehim e afrimin pranë grupeve sociale të përshtatshme për riintegrim; rritet rreziku i rikthimit në kriminalitet.	I lartë	1.3 A ofrohen mekanizma dhe mbështetje e vazhdueshme për ish-të dënuarit pas lirimit, për të lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri?
Financimi dhe burimet buxhetore	Fonde të pamjaftueshme buxhetore për programe rehabilitimi, ambjente, laboratorë praktike profesionale dhe pajisje trajnimit.	Kufizim i programeve dhe mungesë efikasiteti në përvetësimin e profesioneve nga të dënuarit dhe mungesë qëndrueshmërie në ndërhyrje nga institucionet pjesë e kllitj zinxhiri reformues.	I mesëm	1.2 A sigurojnë programet e rehabilitimit dhe formimit profesional përgatitjen e nevojshme të të dënuarve për rikthim aktiv në jetën shoqërore dhe ekonomike?
Koordinimi ndërinstytucional	Koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve mbetet i kufizuar.	Sjell fragmentim në veprimet dhe mungesë vazhdimësie dhe harmonizimi në proceset e rehabilitimit dhe riintegrimin, ul eficientë e punës së specialistëve të fushës sociale.	I lartë	1.4 A sigurohet bashkëpunim dhe koordinim efektiv ndërmjet institucioneve përgjegjëse për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve?
Monitorimi dhe vlerësimi i programeve	Nuk funksionon një sistem i plotë për matjen dhe vlerësimin e rezultateve të programeve të rehabilitimit dhe riintegrimin.	Nuk matet ndikimi real i efektivitetit dhe efikasitetit i zbatimit të programeve për rehabilitimit dhe riintegrimin.	I mesëm	1.4 A sigurohet bashkëpunim dhe koordinim efektiv ndërmjet institucioneve përgjegjëse për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve?
Ndikimet sociale dhe stigmatizimi	Stigmatizimi i ish-të dënuarve nga komuniteti vështirëson riintegrimin e tyre social dhe ekonomik në jetën e lirë jashtë burgut.	Rrit rrezikun e recidivizmit dhe ul efektivitetin e politikave të rehabilitimit dhe riintegrimin në shoqëri.	I mesëm	1.3 A ofrohen mekanizma dhe mbështetje e vazhdueshme për ish-të dënuarit pas lirimit, për të lehtësuar riintegrimin dhe

				riintegrimin e tyre në shoqëri?
--	--	--	--	---------------------------------


3.2 Objektivat e auditimit

Auditimi me temë “*Trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i të dënuarve*” kishte si qëllim kryesor të vlerësojë nëse institucionet përgjegjëse kanë siguruar një sistem efektiv, të koordinuar dhe të qëndrueshëm për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë penale.

Në këtë kuadër, objektivat specifike të auditimit ishin

- Vlerësimi i kushteve dhe trajtimit të të dënuarve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, nëse ato janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për trajtim human.
- Vlerësimi i efektivitetit të programeve të rehabilitimit dhe formimit profesional, duke analizuar nëse ato kontribuojnë në përmirësimin e aftësive dhe sjelljeve të të dënuarve dhe përgatitjen e tyre për një jetë të përgjegjshme pas lirimit.
- Vlerësimi i mekanizmave të riintegrit social dhe ekonomik, nëse institucionet përkatëse sigurojnë bashkëpunim, mbështetje dhe ndjekje efektive pas lirimit nga burgu.
- Vlerësimi i koordinimit ndërinstitutional dhe monitorimit, nëse strukturat përgjegjëse bashkëpunojnë dhe raportojnë në mënyrë efektive për arritjen e qëllimeve të rehabilitimit dhe riintegrit.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i auditimit ka përfshirë institucionet publike që ushtrojnë funksione kyçe në hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të dënuar, si pjesë e sistemit të drejtësisë penale. Auditimi synoi të vlerësojë efektivitetin e masave të ndërmarra për garantimin e kushteve të përshtatshme të qëndrimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP), funksionimin e programeve të rehabilitimit dhe formimit profesional, si dhe mbështetjen pas lirimit për një riintegrim të qëndrueshëm në shoqëri.

Auditimi u shtri në institucionet që kanë rol qendror në këtë proces, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Provës.

Auditimi mbuloi periudhën 2022–2024 dhe synon të ofrojë një vlerësim objektiv mbi funksionimin e sistemit të trajtimit, rehabilitimit dhe riintegrimit të personave të dënuar, duke identifikuar boshllëqet institucionale, praktikat e mira dhe mundësitë për përmirësim në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të drejtësisë penale.

4. SHITJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

Pyetja kryesore: “ *A siguron sistemi penitenciar trajtim dinjitoz, rehabilitim dhe riintegrim efektiv të personave të dënuar, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, për rikthimin e tyre në shoqëri* ”?

Mesazhi i auditimit:

Sistemi penitenciar në Shqipëri nuk garanton ende kushte dhe trajtim të plotë rehabilitimi dhe riintegrimi për personat e dënuar, kjo në mospërputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Masat e programuara për përdorimin e burimeve financiare nuk janë orientuar dhe ndërlidhur drejt arritjes së objektivave specifike për financime të qëndrueshme në objektet e vuajtjes së dënimit. Bashkëpunimi ndërinstytucional ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Shërbimit të Provës, AKPA-së, Ministrisë së Arsimit, pushtetit vendor dhe operatorëve ekonomikë është i pjesshëm dhe shpesh formal, me marrëveshje që nuk zbatohen plotësisht dhe mekanizma referimi që nuk japin rezultate dhe nuk ka shërbyer plotësisht për kthimin e ish të dënuarve pranë familjeve dhe ri integrimin e tyre në shoqëri. Sistemi i burgjeve funksionon kryesisht si strukturë ruajtjeje dhe jo si mekanizëm i plotë rehabilitimi e riintegrimi, duke rritur rrezikun e recidivizmit dhe duke mos përmbushur pritshmëritë ligjore. Investimet e kryera dhe menaxhimi i shërbimeve mbështetëse në përmirësimin e kushteve nuk e kanë arritur qëllimin e tyre në kryerjen e një procesi profesional, të drejtë e efektiv në rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve pas lirit. Dobësitë në planifikimin e investimeve, menaxhimin financiar, dokumentimin, monitorimin dhe auditimin e brendshëm kufizojnë më tej efikasitetin e sistemit. Përqindja shumë e lartë e të paraburgosurve dhe mbipopullimi në disa Institucione Ekzekutimi të Vendimeve Penale (IEVP) krijojnë problematika në menaxhimin e paraburgimit dhe në përdorimin e masave alternative ndaj burgimit. Infrastruktura është e amortizuar, me raste ekstreme si në IEVP-të Rrogozhinë e Lushnje, ndërkohë që investimet kapitale janë fokusuar kryesisht në siguri dhe transport, jo në përmirësimin e kushteve të qëndrimit, arsimit, formimit profesional dhe aktiviteteve rekreative. Programet rehabilituese – arsim, formim profesional, punësim, trajtim psiko-social dhe përgatitje prag-lirimi mbeten me shtrirje të kufizuar, cilësi të ulët dhe nuk lidhen mjaftueshëm me nevojat reale të të dënuarve dhe tregut të punës, si brenda ashtu edhe pas lirit.

4.1 A sigurojnë IEVP-të kushte dhe trajtim dinjitoz të të dënuarve në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare?

Miratimi i paketës penitenciare në vitin 2020 dhe përafrimi i legjislacionit.

Miratimi i paketës penitenciare në vitin 2020, i cili është aktualisht në fuqi, erdhi si nevojë për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga një sërë aktesh ndërkombëtare, siç janë Rregullat Evropiane të Burgjeve¹², të miratuara nga Komiteti i Ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, më 12 shkurt 1987, dhe rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT).

Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar dhe i miratuar në datën 25.6.2020, i cili ka si objekt të vetin, përcaktimin e të

¹² <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae>

drejtave dhe trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, organizimin e sistemit të burgjeve, si dhe kompetencat e detyrat e organeve shtetërore kompetente. Nëpërmjet këtij ligji, synohet garantimi i kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

Ky ligj, zbatohet për të paraburgosurit dhe të dënuarit me burgim me vendim penal të formës së prerë të gjykatave shqiptare, si dhe për të paraburgosurit dhe të dënuarit me vendime të gjykatave të huaja, në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi. “Rregullat e parashikuara në këtë ligj zbatohen për të gjithë të burgosurit, shtetas shqiptarë, shtetas të huaj dhe personat pa shtetësi”¹³.

Referuar respektimit të të drejtave të njeriut ky ligj kuadër sanksionon se: “Të burgosurit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast, ndaj të burgosurit ndalohet tortura, trajtimi çnjerëzor, degradues ose poshtërues.”¹⁴.

Si akt rregullator i sistemit penitenciar, në mënyrë të qartë, ky ligj ka receiptuar dhe sanksionuar parashikimin kushtetues i cili përcakton se: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”¹⁵.

Sikurse u nënvizua më sipër, ky ligj përcakton se trajtimi me dinjitet i të burgosurve, duke respektuar të drejtat themelore të tyre, garantohet jo vetëm nga zbatimi i legjislacionit në fuqi, por edhe i akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Shqipërinë.

Orientimi politiko - juridik i vendit tonë, i cili duhet të ketë në qendër të sistemit, garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të individit, e ka kushtëzuar evoluimin e kuadrit rregullator, edhe me detyrimin e përafrimit me akte të miratuara nga organizata shumëpalëshe, sikurse janë edhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës, meqë Shqipëria është shtet anëtar i KiE -së.

Gjatë viteve, Këshilli i Evropës ka hartuar disa standarde specifike, në fushën penitenciare. Këto standarde, paraqiten në tekste ligjore të detyrueshme, për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, duke përfshirë edhe Shqipërinë, sikurse janë, konventat dhe protokollet. Ato janë, gjithashtu, edhe pjesë e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Përveç kësaj, disa standarde të hollësishme përcaktohen edhe në rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. *Këto rekomandime, ndonëse këshilluese për nga natyra, pasqyrojnë konsensusin politik të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës sa u përket parimeve të përgjithshme për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, si dhe për menaxhimin e institucioneve penitenciare. Këto standarde u adresohen autoriteteve kombëtare përkatëse, por pikësisht, punonjësve të burgjeve që janë në kontakt të përditshëm me personat e privuar nga liria.*

Më datë 24.11.2022, gjatë shqyrtimit bilateral, në Grupin e Punës të Bashkimit Evropian për Kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, Ekipi Negociator për Anëtarësimin e Shqipërisë, pasi nënvizoi se reforma e sistemit penitenciar në Shqipëri konsiderohet një përparësi për vendin tonë dhe se “Parimet, udhëzimet dhe direktivat kryesore që rrjedhin nga kuadri ligjor evropian dhe ndërkombëtar, janë të përfshira në paketën e re të ligjit penitenciar të miratuar në vitin 2020, që synon garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria”, bëri një parashtrim të detajuar mbi nivelin e përparimit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Evropës dhe atë të Kombeve të Bashkuara.

¹³ Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i miratuar në datën 25.6.2020, neni 4, paragrafi 2.

¹⁴ Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i miratuar në datën 25.6.2020, neni 5, paragrafi 1.

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 25. <https://www.qsut.gov.al/wp-content/uploads/2020/02/Kushtetuta-e-Republikes-se-Shqiperise.pdf>

Aspirata e vendit tonë për një sistem penitenciar profesional, sikurse nënvizuar gjatë shqyrtimit dypalësh, kalon nëpërmjet vlerësimit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me akte të qënësishme si:

- ✓ Rekomandimi Rec (2006)13 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për përdorimin e arrestit me burg, kushtet në të cilat ndodh dhe dhënien e garancive kundër abuzimit;
- ✓ Rekomandimi CM/Rec (2008)11 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për Rregullat Evropiane për të dyshuarit/të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve dhe masave;
- ✓ Rekomandim (2006)2 i Këshillit të Ministrave për shtetet anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, nga njëra anë; dhe me
- ✦ “Rregullat Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat e Nelson Mandelës)”¹⁶; dhe
- ✦ “Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve”¹⁷, miratuar më 2 nëntor 1989, nga ana tjetër.

Referuar objektit të trajtuar në këtë grup pune, rezultoi se:

Neni 4, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian "Ndalimi i torturës dhe trajtimit ose ndërshtimit çnjerëzor ose degradues"¹⁸, është përafruar plotësisht nëpërmjet parashikimeve të:

- ❖ Neni 25 i Kushtetutës;
- ❖ Neneve 86, 87, 250 dhe 252 të Kodit Penal;
- ❖ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.

Nga ana tjetër, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹⁹ dhe protokollat e saj plotësuese, janë ratifikuar nga Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996 “Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Ndërsa, “Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese”²⁰, miratuar më 18 dhjetor 2002 në Asamblenë e Kombeve të bashkuara me Rezolutën A/RES/57/199 dhe “Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (OPCAT)”²¹, janë ratifikuar nëpërmjet:

- ❖ Ligjit Nr. 7727, datë 30/06/1993 “Konventa Evropiane kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese”;
- ❖ Ligjit Nr. 81/2020, “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”;
- ❖ Ligjit Nr. 9094, datë 03.07.2003 “Për ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (OPCAT)”;
- ❖ Ligjit Nr. 78/2020, “Për Organizimin dhe Funkionimin e Shërbimit të Provës”;
- ❖ Ligjit Nr. 79/2020, “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”;
- ❖ dhe Ligjit Nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”.

Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtit ose Ndërshtimit Çnjerëzor ose Poshtërues, është ratifikuar edhe nëpërmjet një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore në sinkron me legjislacionin të më poshtë;

- ❖ Ligji nr. 8135, datë 31.07.1996, “Për Aderimin në ‘Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtit ose Ndërshtimit Çnjerëzor ose Poshtërues”;

¹⁶ https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Nelson_Mandela_Rules-E-ebook.pdf

¹⁷ <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-child>

¹⁸ file:///C:/Users/asimoni/Downloads/karta%20e%20t%C3%AB%20drejtave%20fundamentale%20e%20bashkit%20evropian-gp_eudor_WEB_MK3211903SOC_002.pdf

¹⁹ https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sqi

²⁰ <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading>

²¹ <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/optional-protocol-convention-against-torture-and-other-cruel>

- ❖ Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ❖ Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
- ❖ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 209, datë 06.04.2022 “Për Miratimin e Rregullore së Përgjithshme të Burgjeve”;
- ❖ Ligji nr. 9069, datë 15.05.2003, “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura”;
- ❖ Ligji nr. 8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”;
- ❖ dhe Ligji nr. 79/2021 “Për të Huajt”.

Me synim garantimin e një trajtimi me dinjitet të të dënuarve të mitur dhe në respekt të të drejtave themelore të njeriut, vendi ynë ka përafruar plotësisht legjislacionin, me “Rekomandimin CM/Rec (2008)11 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për Rregullat Evropiane për të dyshuarit/të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve dhe masave”²², miratuar nga Komiteti i Ministrave më 5 nëntor 2008 në takimin e 1040-të të Zëvendësministrave, nëpërmjet:

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku neni 54, parashikon që: “Fëmijët duhet të marrin mbrojtje të veçantë nga shteti dhe se çdo fëmijë duhet të mbrohet nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe puna, veçanërisht nën moshën minimale të punës, që mund të jetë e dëmshme për shëndetin, moralin e tyre ose të rrezikojë jetën ose zhvillimin e tyre normal”;
- Ligjit nr. 7531, datë 11/12/1991 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”;
- Ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Fëmijë”, neni 81, neni 82, neni 83;
- Ligjit nr. 136/2015 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Ligjit Nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 89/2017;
- Ligjit Nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Burgosurve dhe të Paraburgosurve
- Ligjit Nr. 78/2020, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit të Provës”, dhe një numuri VKM-ve, sikurse:
 - VKM nr. 148, datë 20.3.2019 “Për procedurën e zbatuar nga shërbimi i provës në rast të mosrespektimit të masës alternative të shmangies së ndjekjes penale”;
 - VKM nr. 149, datë 20.3.2019 "Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit dhe aksesin, të dhënat parësore dhe dytësore dhe ofruesin e informacionit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit"; VKM nr. 207, datë 10.04.2019 "Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe procedurën që duhet ndjekur, për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin";
 - VKM nr. 233, datë 17.04.2019, "Për përcaktimin e rregulloreve të veçanta në lidhje me funksionimin e mjediseve, nivelin e tyre të sigurisë dhe standardet e programeve të edukimit dhe rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve"
 - VKM nr. 314, datë 15.05.2019, "Për përcaktimin e rregulloreve specifike në lidhje me strukturën dhe organizimin e Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve"
 - VKM nr. 55, datë 06.02.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionin për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, të cilat janë të njëjtat ndihmë juridike të parë të garantuar nga shteti” dhe
 - VKM nr. 110, datë 06.03.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për përzgjedhjen e organizatave të autorizuar për të marrë ndihmë juridike të parësore të garantuar nga shteti, të mund të kenë nga financimi i buxhetit të shtetit dhe financimit të tyre”.

Rekomandimi Rec (2006)13 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare, “Për përdorimin e arrestit me burg, kushtet në të cilat ndodh dhe dhënien e garancive kundër abuzimit”, i miratuar

²² <https://www.refworld.org/legal/resolution/coeministers/2008/en/69134>

nga Komiteti i Ministrave më 27 shtator 2006 në takimin e 974-t të Zëvendësministrave, “*Duke vënë re numrin e konsiderueshëm të personave të paraburgosur dhe problemet që paraqet mbipopullimi i burgjeve*”, përcakton: “*Duke pasur parasysh si prezumimin e pafajësisë, ashtu edhe prezumimin në favor të lirisë, arresti me burg i personit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale do të jetë përjashtim më tepër sesa normë*” dhe se “*... arresti me burg do të përdoret vetëm kur është tejet i nevojshëm dhe si një masë e llojit të fundit; ai nuk do të përdoret për arsye ndëshkimore.*”²³. Njëkohësisht ky Rekomandim sanksionon se: “*Arrestimi me burg përgjithësisht do të jetë i mundshëm vetëm në rastin e personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale që dënohen me burg.*”²⁴.

Legjislacioni shqiptar është përafuar plotësisht me “Rekomandimin Rec (2006)13 e Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare “Për përdorimin e arrestit me burg, kushtet në të cilat ndodh dhe dhënien e garancive kundër abuzimit”, sikurse nga parashikimet specifike të ligjeve, vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave të mëposhtëm:

- Ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”
 - o Ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” (Nenet 28 dhe 29)
 - o Ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
 - o Ligjit nr. 79/2020, “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”
 - o Ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”
 - o Ligjit nr. 81/2020, “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Sanksione Burgimi dhe të Paraburgosurve”
 - o Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 233, datë 17.04.2019, "Për përcaktimin e rregulloreve të veçanta në lidhje me funksionimin e mjediseve, nivelin e sigurisë së tyre dhe standardet e programeve të edukimit dhe rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve"
 - o Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 209, datë 06.04.2022 "Për Miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve" (Nenet 2 dhe 84)
 - o Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 201, datë 13.03.2017, "Për Skemën e Pagave të Personelit të Policisë së Burgjeve"
 - o Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 519, datë 08.09.2021, "Për Miratimin e Skemës Disiplinore të Policisë së Burgjeve"
 - o Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 409, datë 19.07.2021, "Për Miratimin e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Policinë e Burgjeve"
 - o Urdhri nr. 457 të Ministrit të Drejtësisë, datë 31.12.2020 “Për Rregullat e Hollësishme mbi Hartimin, Zhvillimin dhe Zbatimin e Planit Individual të Trajtitimit”
 - o Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 458, datë 31.12.2020, “Për Rregullat e Hollësishme në lidhje me Kriteret, Procedurën dhe Raportin e Vlerësimit”

Përqindja e lartë e të paraburgosurve në burgjet shqiptare.

Përafrimi i kuadrit ligjor shqiptar me *acquis* komunitare, përtej parashikimeve të përpikta në aktet e lartpërmendura, nuk e ka zgjidhur problematikën e paraburgimit në burgjet e vendit tonë.

Paketa penitenciare e miratuar në 2020, ka lënë të mangët procesin e përafrimit me Rekomandimin Rec (2006)2 e Këshillit të Evropës mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve (49-101), meqë:

²³ Rekomandimi Rec (2006)13 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për përdorimin e arrestit me burg, kushtet në të cilat ndodh dhe dhënien e garancive kundër abuzimit, “Parime të përgjithshme”, paragrafi 3(1) dhe 3(3)

²⁴ Rekomandimi Rec (2006)13 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për përdorimin e arrestit me burg, kushtet në të cilat ndodh dhe dhënien e garancive kundër abuzimit, paragrafi 6,

- Neni 17.3, i cili parashikon: “Të burgosurit konsultohen për aq sa të jetë e mundur, për vendosjen e tyre fillestare dhe për transferimet e mëvonshme nga njëri burg në tjetrin.” *kjo është reflektuar pjesërisht;*
- Neni 18.4, i cili kërkon që ligji kombëtar të parashikojë mekanizma për të siguruar që kërkesat minimale të mos shkelen nga mbipopullimi i burgjeve, *nuk është reflektuar në legjislacionin shqiptar, sikurse dhe;*
- Neni 54.2, i cili kërkon përcaktimin e rrethanave dhe natyrës së kontrolleve.

Lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me këto tre nene, i është kërkuar informacion Ministrisë së Drejtësisë, me e-mail më datë 7 nëntor 2025, por ky institucion nuk ka kthyer përgjigje.

Përtej këtyre aspekteve, lidhur me Rekomandimin Rec (2006)2 e Këshillit të Evropës mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, legjislacioni shqiptar rezultoi i përafruar, në aktet e cituara më sipër.

Situata paraqitet si nga të dhënat, në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3: Gjendja mesatare e të burgosurve gjatë viteve 2022-2024

Viti	Numri i të dënuarve	Numri i të paraburgosurve dhe % e tyre në raport me totalin e të burgosurve	Në mjekim të detyruar	Total	Kapaciteti	Mbipopullimi
2022	2202	2858 - 52,5%	384	5444	5657	-213
2023	2195	2822- 51,7%	437	5454	5727	-273
2024	1800	2941 – 56,4%	471	5212	5747	-535

Burimi: Të dhëna të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Sikurse vihet re nga të dhënat e dërguara nga DPB, numri i të paraburgosurve për vitet 2022, 2023 dhe 2024, arrin në nivelet e **52,5%, 51,7% dhe 56,4%** të totalit të të burgosurve. ***Këto të dhëna përbëjnë shqetësim për faktin se kjo kategori, nga njëra anë, i nënshtrohet regjimit të burgimit, pa një dënim definitiv, sikurse dhe nga ana tjetër, prania e kësaj kategorie në IEVP – të e vendit, trysnon kapacitetet akomoduese të disa prej tyre, duke krijuar mbipopullim.***

Vetë mbipopullimi çënon dhe pamundëson perspektivën e një qëndrimi dhe trajtimi me dinjitet dhe humanizëm të vetë të burgosurve, gjë kjo që kushtëzohet dhe nga kapacitetet e kushtet e kufizuara të burgjeve me standard të vjetra dhe jo bashkëkohor.

Pikërisht këtë shqetësim, lidhur me përqindjen e lartë të të paraburgosurve, në burgjet e vendit tonë, ngre edhe “Raporti vjetor i Këshillit të Evropës mbi popullsinë e burgjeve (SPACE I)”, publikuar më 18 korrik 2025.

Siç është evidentuar në raport, “*Shqipëria mban vendin e parë në Europë për përqindjen e lartë të të paraburgosurve, me 58% të popullsisë së saj penitenciare, e cila nuk ka një dënim përfundimtar nga gjykatat. Me këtë tregues, vendi lë pas edhe Armeninë (53%), Malin e Zi dhe Luksemburgun (47%), duke ngritur shqetësime serioze për respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe si mesatare në Europë është 26% e të burgosurve janë në paraburgim. Kjo nënkupton që më shumë se gjysma e personave në burgjet shqiptare, nuk ka marrë ende një vendim përfundimtar nga gjykata. Kjo gjendje nuk është thjesht statistikore, por shpirtërore dhe shoqërore për një sistem drejtësie që në vend të shpejtësisë dhe efikasitetit, vonon vendimin dhe ndëshkon me pritje. Këto të dhëna, të nxjerra nga anketa vjetore SPACE I, nuk janë thjesht statistika të ftohta, por një reflektim i drejtpërdrejtë i sfidave sistematike me të cilat përballen administratat e burgjeve në mbarë kontinentin. Ato dëshmojnë për krizën në drejtësinë penale, mungesë alternativash ndaj burgimit, si dhe nevojën për reforma të thella, sidomos në menaxhimin e paraburgimit dhe shkurtime reale të dënimeve për krime jo të dhunshme.*”²⁵.

²⁵ <https://start-press.eu/raporti-i-kie-58-e-te-burgosurve-ne-shqiperi-jane-ne-paraburgim/>

Mbipopullimi permanent i disa burgjeve.

Referuar të dhënave mbi situatën e mbipopullimit për periudhën 2022-2024, situata në disa IEVP, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 4: IEVP - të me mbipopullim, gjatë vitit 2022.

IEVP - të me mbipopullim, gjatë vitit 2022				
Nr.	IEVP	Të burgosur	Kapaciteti	Mbipopullimi
1.	Lezhë	503	350	153
2.	Elbasan	147	140	7
3.	Berat	117	110	7
4.	Korçë	407	380	27
5.	Tepelenë	107	75	32
Totali në të gjitha IEVP - të		5350	5657	-307

Burimi: Të dhëna të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Tabela nr.5: IEVP - të me mbipopullim, gjatë vitit 2023.

IEVP - të me mbipopullim, gjatë vitit 2023				
Nr.	IEVP	Të burgosur	Kapaciteti	Mbipopullimi
1.	Kukës	39	36	3
2.	Lezhë	587	350	237
3.	Elbasan	183	160	23
4.	Korçë	455	380	75
5.	Tepelenë	121	75	46
Totali në të gjitha IEVP - të		5645	5727	-82

Burimi: Të dhëna të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Tabela nr.6: IEVP - të me mbipopullim, gjatë vitit 2024.

IEVP - të me mbipopullim, gjatë vitit 2024				
Nr.	IEVP	Të burgosur	Kapaciteti	Mbipopullimi
1.	Lezhë	435	350	85
2.	Elbasan	171	160	11
3.	Korçë	398	380	18
4.	Tepelenë	92	75	17
Totali në të gjitha IEVP - të		4965	5747	-782

Burimi: Të dhëna të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Siç shikohet nga të dhënat e evidentuara në tabelat e mësipërme, rezultojnë se gjatë vitit 2022 ka pasur mbipopullim në IEVP – të e Lezhës, Elbasanit, Beratit, Korçës dhe Tepelenës, përkatësisht me 153, 7, 7, 27 dhe 32 të burgosur mbi kapacitetet akomoduese të burgjeve.

Gjatë vitit 2023, ka pasur mbipopullim në IEVP – të e Kukësit, Lezhës, Elbasanit, Korçës dhe Tepelenës, përkatësisht me 3, 237, 23, 75 dhe 46 të burgosur mbi kapacitetet akomoduese të këtyre institucioneve. Po ashtu, gjatë vitit 2024, mbipopullimi ka rezultuar një problem i dukshëm në IEVP – të e Lezhës, Elbasanit, Korçës dhe Tepelenës, përkatësisht me 85, 11, 18 dhe 17 të burgosur mbi kapacitetet akomoduese të këtyre institucioneve.

Kjo situatë mbipopullimi permanente në disa nga IEVP, përjashtuar rastin e IVEP – së së Lezhës e cila është një strukturë e dedikuar për personat me masë mjekësore, dëshmon se mungon një qasje programuese shpërndarjeje të burgosurve drejt IEVP – ve të tjera, ku ka kapacitete akomoduese të disponueshme. Vetë të dhënat e vëna në dispozicion nga DPB, dëshmojnë, se sistemi penitenciar në total, rezultojnë me kapacitete akomoduese të paezauruara. Situata e konstatuar e mbipopullimit në IEVP – të e lartpërmendura, pamundëson kushtet e një jetese dinjitoze dhe njerëzore, në përputhje me standardet bashkëkohore evropiane.

Problematikat lidhur me Strategjitë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe 2024-2030, sa i përket, aktiviteteve, masave dhe objektivave që fokusojnë të dënuarët.

Me miratimin e VKM Nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit”, Qeveria me afirmimin e “Qëllimit të tretë të politikës”: “Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane

të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit” synon veç tjerash arritjen e dy objektivave specifik, atë 3.4 dhe atë 3.5.

Objektivi specifik 3.4 është i orjentuar për “Një shërbim prove efektiv dhe efikas që përdor standardet operacionale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira të BE-së”. Strategjia përcaktonte se “Nëpërmjet këtij objekti specifik synohej një shërbim prove efektiv dhe efikas, i cili përdor standardet operacionale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet risocializimin, riintegrimin, rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira të BE-së”. Kjo pasi “Numri i personave në shërbimin e provës dhe i dënimeve alternative në Shqipëri është rritur, duke ulur kështu presionin mbi gjykatat dhe kostot njerëzore të dënimeve me burgim”²⁶.

Ndërsa Objektivi specifik 3.5 është i orientuar për “Zhvillimin e sistemit penitenciar bazuar në standardet evropiane, që siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane zhvillimi individuale.”.

Bazuar në vlerësimin e masave të zbatuara/të pazbatuara për realizimin e këtyre dy objektivave, përmbushja e tyre ka pasur ecurinë e mëposhtme.

Lidhur me **Masën 3.4.2** “Përgatitja e paketës së ndërhyrjeve ligjore në kuadrin nënligjor të DPSHP-së, konsultimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve ligjore e nënligjore”, parashikuar të ezaurohet brenda vitit 2022, DPSHP përgjigjet se: “Aktualisht DPSHP ka kuadrin ligjor dhe nënligjor të miratuar, por aktualisht nuk ka nga DPSHP dhe Ministria e Drejtësisë propozim për ndryshime ligjore.”²⁷, duke mos evidentuar në mënyrë konkrete hapat e bërë për përmbushjen e kësaj mase..

Lidhur me **Masën 3.4.4** “Trajnimi i nëpunësve të DPSHP-së për rritjen e performancës në kryerjen funksioneve (trajnim bazë dhe vazhdues).”, parashikuar të ezaurohet brenda vitit 2023, konstatohet DPSHP nuk ka pasqyruar informacion për realizimin e këtyre aktiviteteve gjatë vitit 2022. Në vitin 2023 nga DPSHP janë zhvilluar 58 trajnime, me 29 punonjës të trajnuar. Ndërkaq në vitin 2024 janë zhvilluar 64 trajnime, ku kanë marrë pjesë 32 punonjës të shërbimit.

“Dizenjimi dhe instalimi i teknologjisë së informacionit bashkëkohor si dhe sistemit të administrimit të çështjeve, duke krijuar lidhje me sistemin e integruar të drejtësisë elektronike” si **Masa 3.4.7**, e parashikuar për t’u realizuar gjatë viteve 2021 – 2022, **rezulton akoma e pazbatuar**, meqë sikurse pohuar nga DPSHP, “Aktualisht në funksionim është vetëm sistemi për hedhjen e të dhënave për të miturit në konflikt me ligjin.”²⁸.

Masa 3.4.9 “Kryerja e analizës mbi rishikimin e akteve nënligjore specifike, rregulloreve, udhëzimeve, standardeve, përfshirë afatet kohore dhe formatet për punën pas dënimit.”, e parashikuar të përmbushet brenda vitit 2022, **akoma nuk është zbatuar**, meqë “Kjo analizë është në veprim, por akoma nuk është finalizuar.”²⁹.

Po ashtu, edhe **Masa 3.4.16** “Forcimi i bashkëpunimit me institucionet përkatëse të drejtësisë (gjykatat, prokurorinë, sistemin penitenciar) për punën e shërbimit të provës (trajnime/workshop).” **rezulton se “Nuk ka akte konkrete**. Bashkëpunimi me këto institucione bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.”, pavarësisht se afatet e përmbushjes të kësaj mase, përkohë me periudhën 2022 – 2024.

²⁶ VKM – ja Nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit”.

²⁷ Përgjigje e DPSHP – së, dhënë pyetsorit të GA.

²⁸ Përgjigje e DPSHP – së, dhënë pyetsorit të GA.

²⁹ Përgjigje e DPSHP – së, dhënë pyetsorit të GA.

Lidhur me **Masën 3.4.17** “Përgatitja e një programi të përbashkët komunikimi me popullatën e gjerë”, e parashikuar të përmbushet gjatë periudhës 2021 – 2025 rezulton, se *kjo masë mbetet akoma e pazbatuar*, meqë “DPSHP nuk e disponon një program të tillë”³⁰.

“Zhvillimi i kapaciteteve të stafit për të siguruar një normë prej 50 stazhierësh për staf në përputhje me standardet evropiane dhe për të siguruar stafin e duhur për zyrat vendore” e parashikuar si **masa 3.4.19**, për tu përmbushur në vitet 2021 – 2022, *nuk është zbatuar*, meqë sikurse shprehet DPSHP: “Vazhdohet puna për plotësim stafi”³¹.

Referuar masave të programuara për arritjen e **Objektivit specifik 3.5**, sikurse nga vetë shpjegimet e Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve, **Masa 3.5.11**: “Hartimi, konsolidimi dhe finalizimi i memorandumit të bashkëpunimit me MSHMS-në për kujdesin dhe trajtimin e shkelësve të papërgjegjshëm dhe të pacientëve me probleme mendore, të dënuar dhe të atyre në paraburgim, dhe memorandume me institucionet e tjera”, është realizuar me “Miratimin e Memorandumit të Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë, Nr. 4787 Prot, datë 23.11.2021 dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbështetjes Sociale, Nr. 6111 Prot, datë 23.11.2021, "Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore" dhe plani i veprimit” dhe të Udhëzimit të përbashkët MSHMS - së dhe MD - së, Nr.1 prot, datë 17.03.2023. Përtej miratimit të tyre, dhe gadishmërisë së MD - së, procesi zbatimit, has vështirësi meqë MSHMS nuk u përmbahet përcaktimeve, sa dakordësuar mes dy institucioneve”.³²

Nga ana tjetër, **Masa 3.5.17** “Konsolidimi dhe përmirësimi i mekanizmave ndërinstitucionalë për adresimin e shkelësve ekstremistë të dhunshëm (1-7 mbledhje koordinimi)”, rezulton e zbatuar meqë, Drejtoria e Përgjithëshme e Burgjeve me mbështetjen/ekspertizën e siguruar nga Këshilli i Evropës në kuadër të projektit rajonal për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në sistemin penitenciar të vendeve të Ballkanit Perëndimor - “Rritja e kapaciteteve të sistemit penitenciar në adresimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në burgje në vendet e Ballkanit Perëndimor” ka miratuar përmes Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 829 Prot, datë 26.05.2023 “Për fuqizimin e shërbimit psiko-social në kuadër të punës rehabilituese me të burgosur të radikalizuar dhe ekstremistë të dhunshëm”, dokumentet si vijon:

Instrumenti Nr.1: “Metodologjia për rehabilitimin e të burgosurve të radikalizuar në Shqipëri”;
Instrumenti Nr. 2: “Vlerësimi dhe klasifikimi i nevojave për rrezikun terrorist dhe ekstremist”;
Instrumenti Nr. 3: “Udhëzues përdorimi - Vlerësimi dhe klasifikimi i nevojave për rrezikun terrorist dhe ekstremist”;

Instrumenti Nr. 4: “Udhëzimet e praktikuesve për parandalimin e radikalizmit në shërbimin e burgjeve në Shqipëri”;

Instrumenti Nr. 5: “Mjeti bazë i shqyrtimit për identifikimin e sjelljes ekstremiste të dhunshme”;
Instrumenti Nr. 6. “Instrumenti për vlerësimin e rrezikut dhe Nevojave specifike të VEP”;
Instrumenti Nr.7: “Lista e kontrollit të shenjave të radikalizmit”.

DPB në bashkëpunim me Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social, ka zhvilluar forume ndërinstitucionale me pjesëmarrës nga agjenci të ndryshme, në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit me qëllim rintegrimin e këtij target grupi. Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës po vijohet me hartimin e tërë gamës së instrumenteve dhe procedurave standarde të veprimit dhe ndërverimit ndërinstitucional për këtë target grup.

Lidhur me masat e përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale 2021- 2025, për realizimin e **Objektivit Specifik 3.5** “Zhvillimi i një sistemi efikas penitenciar bazuar në strategjinë për reformën e këtij sistemi, e cila siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane individuale zhvillimi” e cila fokusohet, tek politikat dhe trajtimi i stafit të sistemit penitenciar, Grupi i Auditimit u ndal tek vlerësimi i lidhjes që kanë me këtë objektiv, **Masa 3.5.11** dhe **Masa 3.5.17** dhe shtroi pyetjen se “si lidhen ato me arritjen e **Objektivit Specifik 3.5**?”

³⁰Përgjigje e DPSHP – së, dhënë pyetsorit të GA.

³¹ Përgjigje e DPSHP – së, dhënë pyetsorit të GA.

³² Përgjigje e DPSHP – së, dhënë pyetsorit të GA

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk u shpreh lidhur me këtë pyetje, në përgjigjet dhënë pyetsorit të përgatitur nga GA.

Nga ana tjetër, për masat e tjera, përkatësisht: Masa 3.5.5, Masa 3.5.8, Masa 3.5.9, Masa 3.5.11, Masa 3.5.14 dhe Masa 3.5.16, Grupi i Auditimit vlerëson se janë realizuar plotësisht.

- VKM – ja Nr. 787, datë 18.12.2024 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2024–2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve – (SND 2024 - 2030)” u miratua pasi me 19 korrik 2022, ishte mbajtur Konferenca e Parë Ndërqeveritare, e cila inicioi procesin e takimeve dypalëshe BE – Shqipëri.

Raporti Vjetor i Monitorimit për vitin 2023, mbi zbatimin e SND 2021-2025, është raporti vjetor i tretë i monitorimit të zbatimit të SND 2021-2025 dhe përkon me realizimin e gjysmës së afatit kohor 5 vjeçar, të zbatueshmërisë së SND 2021-2025, Ky raport nënvizon se lidhur me sistemin penitenciar shqiptar mbetet sfida ulja e mbipopullimit në burgje. Miratimi i SND 2024-2030, rivendosi në afat disa nga masat dhe aktivitetet e objektivave specifik 3.4 dhe 3.5 të SND –së 2021-2025.

Në kuadrin e politikave të përgjithshme shtetërore, më herët, ishte miratuar “Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Evropian 2022-2030”³³, nëpërmjet VKM – së Nr. 88, datë 22.2.2023, dokument ombrellë që siguron prioritetizimin e politikave në bazë të gjitha strategjive sektoriale apo edhe ndërsektoriale. SKZHIE 2022-2030 e cila përcakton drejtime politike prioritare afatmesme dhe afatgjatë për zhvillimin dhe integrimin e vendit, në njërën nga shtatë fushat e përgjegjësisë për sistemin e drejtësisë, atë të katërtën, fokuson çështjet e “Sistemi të Vuajtjes së Dënimit”.

Një akt tjetër që i parapriu miratimit të SND 2024-2030 ishte miratimi me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr. 441, datë 6.9.2024 të “Planit të zhvillimit të sistemit të burgjeve 2024-2030”, i njohur ndryshe si “Master Plani i ri i Burgjeve”, ku prioritet përbën ngritja e kapaciteteve të stafit dhe përmirësimi i performancës profesionale”³⁴.

Në SND – në 2024 – 20230, qeveria shqiptare e vlerëson si prioritet të saj, arritjen e Qëllimit Politik 3: “Rritja e efikasitetit të institucioneve në sistemin e drejtësisë”. Me synim arritjen e këtij Qëllimi, veç objektivave të tjerë, Objektivi Specifik 3.6 “Përmirësimi i kapaciteteve të MD dhe institucioneve të varësisë për të përforcuar aksesin në drejtësi”, “përfshin disa masa kyçe të cilat janë: konsolidimi i Masterplanit të Burgjeve për rinovimin e infrastrukturës dhe rritjen e kapaciteteve akomoduese; miratimi i Planit të Integritetit për të adresuar risqet e integritetit në sistemin penitenciar; dhe miratimi i rregullave të brendshme për institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, për të përmbushur rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe CPT-së.”³⁵.

Sikurse përcakton SND 2024-2030, “Gjithashtu synohet ngritja e kapaciteteve për të zbatuar rekomandimet e CPT-së dhe optimizimi i ndërhyrjeve përmes instrumenteve psiko-edukative dhe mbështetje psiko-sociale. Në këtë kuadër, do të sigurohen burimet e nevojshme për ndërtimin/rikonstruksionin e institucioneve për ekzekutimin e vendimeve penale. Do të rritet efikasiteti i IEVP-ve dhe Shërbimit të Proves, si dhe kapacitetet e DNJF-së.”.

Rezultatet e pritshme për realizimin e këtij objektivi specifik shpallen, si më poshtë:

- Deri në fund të vitit 2030 pritet të ketë rritje progresive të numrit të të burgosurve të përfshirë në aktivitetet rehabilituese, kundrejt numrit total të personave që vuajnë dënimin, duke forcuar kështu rehabilitimin e tyre dhe integrimin e mëvonshëm në shoqëri.

³³ <https://www.mod.gov.al/politikat-e-sigurise/dokumente-strategjike/6954-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim-evropian-2022-2030>

³⁴ VKM – ja Nr. 787, datë 18.12.2024 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2024–2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve – (SND 2024-2030)”.

³⁵ VKM – ja Nr. 787, datë 18.12.2024 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2024–2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve – (SND 2024-2030)”.

- Deri në fund të vitit 2030 do të ketë përmirësim progresiv të situatës së mbipopullimit në burgje si rrjedhojë e adresimit të sfidave në sistemin e drejtësisë dhe politikave efektive të paraburgimit.

Bazuar në vlerësimin e masave/aktiviteteve të zbatuara / të pazbatuara për realizimin e këtij Objektiv, përbushja e tyre ka pasur ecurinë e mëposhtme.

Për realizimin e **Masës 3.6.1** “Konsolidimi i Masterplanit të Burgjeve duke përfshirë masa për rinovimin e infrastrukturës së burgjeve dhe rritjen e kapaciteteve akomoduese për të dënuarit me burgim”, parashikohen 3 Aktivitete.

Referuar **Aktivitetit 3.6.1.2** “Ngritja e një ekipi të qëndrueshëm, me integritet, të motivuar dhe profesional nëpërmjet aktiviteteve të rregullta dhe specifike për rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimi i një sistemi për vlerësimin e performancës dhe promovimin e stafit”, zbatimi i tij ka filluar me miratimin e Masterplanit, pavarësisht se përpjekje për forcimin e burimeve njerëzore janë bërë në vijimësi. Lidhur me këtë Aktivitet, gjatë vitit 2024 është realizuar procedurës së ngritjes në gradë në vitin 2024, e cila u zhvillua në zbatim të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve Nr. 666, datë 17.05.2024, "Për fillimin e procedurave të dhënies së gradave të Punonjësve të Policisë së Burgjeve", me angazhimin e Sektorit të Ecurisë së Karrierës, gjatë cilit u morën masat për verifikimin e dokumentacionit dhe shpalljen e listave të kandidatëve për konkurrimin për gradat:

Referuar **Aktivitetit 3.6.1.3** “Forcimi i procesit të rehabilitimit dhe ri-integrimit të të burgosurve nëpërmjet zbatimit të instrumenteve edukativ dhe përfshirjes së institucioneve të tjera”, rezulton se, pas trajnimit të stafit, fillimit të zbatimit të 5 (pesë) moduleve: Dhunuesit seksualë; Dhuna në familje; Korrigjimi i sjelljes së të dënuarve; Abuzimi me drogën; Punësimi, në 4 IEVP të vendit, hartimit dhe miratimit po ashtu, tre instrumente, psiko-edukativë, gjatë 2024 u hartuan/miratuan 11 instrumente: Për herë të parë u hartua instrumenti “*Udhërrëfyesi për rehabilitimin dhe ri-integrimin e të burgosurve*”³⁶.

Për realizimin e **Masës 3.6.2** “Miratimi i Planit të Integritetit që adreson risqet e integritetit në sistemin penitenciar.”, janë programuar 3 Aktivitete.

Referuar **Aktivitetit 3.6.2.3** “Vlerësimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe efektet e masave të përcaktuara lidhur me e personelin dhe imazhin e institucionit.”, rezulton se, “Lidhur me personelin e burgjeve, të gjitha rekrutimet janë kryer vetëm me proces konkurimi të hapur, duke u bazuar në Rregulloren e Brendshme, për metodat e punës dhe etikën e punonjësve të DPB dhe IEVP-ve. Po ashtu, janë kryer trajnime para marrjes së detyrës dhe trajnime në detyrë, si dhe ka vijuar bashkëpunimi me organet ligjzbatuese për raste të dyshuara për korrupsion dhe veprime arbitrare”³⁷.

Për realizimin e **Masës 3.6.3** “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve miraton rregullat e brendshme për çdo institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, duke synuar adresimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Komitetit të Helsinkit dhe CPT”, janë programuar 3 Aktivitete:

Aktiviteti 3.6.3.1 “Hartimi dhe miratimi i Rregullave të brendshme për çdo IEVP, duke synuar adresimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Komitetit të Helsinkit dhe CPT”;

Aktiviteti 3.6.3.2 “Vlerësimi i zbatimit të Rregullave të Brendshme dhe përmirësimi sipas nevojave”;

Aktiviteti 3.6.3.3 “Rritje e kapaciteteve të stafit për implementimin e Rregullave të Brendshme”. Të treja këto aktivitete janë në proces realizimi.

Po ashtu vijon puna për zbatimin e **Masës 3.6.4** “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Ministria e Drejtësisë, vazhdojnë të ndërmarrin masa për ngritjen e kapaciteteve për të rritur aftësinë raportuese dhe zbatuese të rekomandimeve të CPT-së” dhe Aktiviteteve të

³⁶ Miratuar me Urdhër Nr. 1687, datë 27.09.2024. Ky dokument strategjik ka shënuar një faqe të re për Drejtorinë në perspektivën e standardizimit / unifikimit të qasjes psiko-sociale me të burgosurit, si dhe dokumentimit të punës rehabilituese bazuar në standardet evropiane. Dokumenti është hartuar bazuar në modulet e miratuara ndër vite nga ekspertë të KiE.

³⁷ Përgjigje e DPB – së, dhënë pyetsorit të GA

programuara. 3.6.4.1 “Krijimi i një njësie vetëm për raportimin në lidhje me Integrimin Evropian” dhe 3.4.6.2 “Rritja e kapaciteteve dhe specializimi i anëtarëve të njësisë raportuese”, pasi përkatësisht: “Në projekt organikën e re të dërguar në muajn tetor 2025, është propozuar krijimi i sektorit të integritimit evropian 2+1” dhe “Janë zhvilluar nga MD trajnime lidhur me procesin e raportimit”³⁸.

Të gjitha Masat nga 3.6.5 deri 3.6.9 dhe Aktivitetet e programuara për janë në proces e sipër zbatimi. Duke pasur parasysh se SND 2024 – 2030, është miratuar në gjysmën e periudhës për të cilën ishte parashikuar të ishte në fuqi SND 2021 – 2025, atëherë shumë masa dhe aktivitete janë vënë në afat, me miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 – 2030.

Urdhri i Ministrit të Drejtësisë, nr. 441, datë 6.9.2024 të “Planit të zhvillimit të sistemit të burgjeve 2024-2030”, i njohur ndryshe si “Master Plani i ri i Burgjeve”.

Në parantezë të objektivave dhe masave të miratuara në Master Plan, Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nënvizon, se: “Sistemi i zbatimit të vendimeve penale me burgim, për një periudhë 30 vjeçare ka pësuar ndryshime në zhvillimet sasiore dhe pëmbajtjen e tij, duke iu përshtatur ndryshimeve politike sociale dhe ekonomike, që kanë ndodhur në vendin tonë përgjatë kësaj periudhe. Ndryshimet kryesore evidentohen në filozofinë humanitetit të trajtimit të të burgosurve, e cila është mbështetur:

- në një korrnizë ligjore të përafërt me standartet ndërkombëtare,
- në motivimin, trajtimin e stafit dhe krijimin e një kulture institucionale të bazuar në ligjshmëri dhe standartet europiane
- në investime të rëndësishme në ndërtimin e godinave të përshtatëshme dhe me kushte sigurie optimale”³⁹.

Ky dokument shumë i rëndësishëm, fokuson posaçërisht sistemin penitenciar, problematikat e konstatuara ndër vite dhe heq linjat guidë të zhvillimit të tij, me synim realizimin e misionit të shpallur për “një shërbim profesional në burgje që ofron qëndrim të sigurt dhe njerëzor, që garanton mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të personave të privuar nga liria dhe që u jep atyre mundësi rehabilitimi për komunitete më të sigurta”.

Referuar masave të programuara në “Planin e zhvillimit të sistemit të burgjeve 2024-2030” si dhe afateve të përcaktuara për zbatimin e tyre situata paraqitet si më poshtë.

Sistemi i zbatimit të vendimeve penale, aplikohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës, bazuar në katër ligje:

Ligji Nr.79/2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale"

Ligji Nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"

Ligji Nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të Provës"

Ligji Nr.80/2020 "Për Policinë e Burgjeve"

“Duke u nisur edhe nga eksperiencia e vendeve të tjera, por edhe nevoja për një menaxhim më të mirë, si në aspektin e kostove dhe nevoja e trajtimit të unifikuar të stafit lidhur me karrierën, trajtimin ekonomik, rotacionin, stautsin, mbështetjen logjistike të agjencisë dhe efektivitetin e shfrytëzimit të aseteve në dispozicion, nevojitet hartimi i një ligji të vetëm”⁴⁰.

Për sa më lart, Master Plani i ri i Burgjeve, në kuadër të **Objektivit 1**: “Forcimi i kapaciteteve organizative dhe funksionale të sistemit zbatimit të vendimeve penale” ka përcaktuar për të zbatuar Masën 1.2 lidhur me “Hartimin e një ligji të vetëm mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe me masa në komunitet, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit”. Masa 1.2, miratuar dhe shpallur prej shumë kohësh, akoma nuk është konkretizuar me një ligj unifikues, rezulton e pazbatuar akoma, pavarësisht se jemi në përfundim të afatit të parashikuar (viti 2025), pasi sikurse shprehet DPB, “... duhet të merret një vendim politik dhe në nivel

³⁸ Përgjigje e DPB – së, dhënë pyetsorit të GA

³⁹ Urdhri i Ministrit të Drejtësisë, nr. 441, datë 6.9.2024 të “Planit të zhvillimit të sistemit të burgjeve 2024-2030”, paragrafi i “Hyrjes”.

⁴⁰ Urdhri i Ministrit të Drejtësisë, nr. 441, datë 6.9.2024 të “Planit të zhvillimit të sistemit të burgjeve 2024-2030”.

qendror dhe janë në pritje të vendimit të qeverisë për të ngritur grupin e punës për aktivitetet e hartimit të akteve”⁴¹.

Bazuar në Ligjin Nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, “*Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale*” dhe “*ushtron kompetenca, mbështet, bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë e saj, sipas këtij ligji, lidhur me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, me institucionet e sistemit të burgjeve, të shërbimit të provës...*”⁴².

IEVP Rrogozhinë dhe Lushnje nuk përmbushin kërkesat e domosdoshme, për të funksionuar normalisht.

Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 441, datë 6.9.2024 “Për miratimin e planit të zhvillimit të sistemit të burgjeve 2024-2030”, ka përcaktuar si Objektiv të tij, nr. 2 angazhimin për “Krijimin e një ambjenti të sigurtë dhe promovues”.

IEVP Rrogozhinë, i cili është në funksionim nga viti 2001 me një kapacitet rreth 343 shtretër dhe popullim aktual prej 261 të burgosur (në datë 13.10.2025), funksionon si burg i sigurisë së zakonshme. Por zakonisht aty vendosen të dënuar me dënime të ulta, ose që e kanë kryer pjesën më të madhe të dënimit.

Nga vizita e grupit të auditimit në terren dhe referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogozhinë është në gjendje tejet të degraduar dhe për shumë arsye, nuk siguron kushte për trajtim me dinjitet dhe njerëzor, duke mos plotësuar standardet shqiptare dhe evropiane.

E njëjtë është gjendja edhe në IEVP Kosovë - Lushnje, ku kushtet nuk plotësojnë standardet. Për shkak të kësaj situatë, me mungesa qoftë dhe për kushte minimale, është e planifikuar për mbyllje edhe në Master Planin e miratuar, prandaj është emergjente mbyllja e këtij institucioni, nëse nuk merren masa rehabilituese.

Lidhur me infrastrukturën konstatohet: përdorimi i gjerë i telit me gjemba (edhe ky i arnuar); pjesa e sipërme e ndërtesës është e pasigurt dhe e degraduar; kushtet e akomodimit janë shumë të dobëta; mungojnë fare hapësirat e dedikuara, ose janë të papërshtatshme për funksionin e tyre, sikurse “Dhoma e prindërimit” në qiell të hapur, mungojnë ambiente për formim profesional, klasa për arsimin e amortizuar, etj.

Të njëjtat vlerësime ndajnë edhe ekspertët anglezë në konkluzionet e tyre, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 2016.⁴³

Që “Gjendja aktuale e kushteve të trajtimit të këtij institucioni dhe kushteve të sigurisë, nuk përmbushin kërkesat më të domosdoshme për funksionim si burg”⁴⁴, ky është një fakt i pranuar nga vetë Ministri i Drejtësisë, sikurse në Masterplan. “Mbyllja e burgut të Rrogozhinës dhe ridikompozimi i tij” është parashikuar si Masa 2.7, në fuksion të arritjes së Objektivit 2.

Duke pasur parasysh, se “*Sistemi i burgjeve, në ushtrimin e veprimtarisë, udhëhiqet nga parimet dhe respektimi i të drejtave si më poshtë vijon:*

- *I burgosuri trajtohet me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat e tij njerëzore.*
- *I burgosuri gëzon të gjitha të drejtat që nuk i janë kufizuar apo hequr në mënyrë të ligjshme nga vendimet e dënimit apo masat e sigurisë me burgim.*

⁴¹ Përgjigje e DPB – së, dhënë pyetsorit të GA.

⁴² Ligji Nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, neni 5, paragrafet 1 dhe 3.

⁴³ Urdhri i Ministrit të Drejtësisë, nr. 441, datë 6.9.2024 të “Planit të zhvillimit të sistemit të burgjeve 2024-2030”, faqe 34

⁴⁴ Urdhri i Ministrit të Drejtësisë, nr. 441, datë 6.9.2024 të “Planit të zhvillimit të sistemit të burgjeve 2024-2030”, faqe 34.

- *Kushtet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, që cenojnë të drejtat e njeriut nuk justifikohen nga mungesa e burimeve*⁴⁵, *kjo gjendje vlerësohet si e papranueshme dhe në shkelje të këtyre kritereve ligjore.*

Këto kushte cenojnë kriteret e një trajtimi me dinjitet dhe humanizëm të të burgosurve, sikurse parashikuar edhe tek “Rregullat Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat e Nelson Mandelës)”⁴⁶.

Pyetja se “Përse nuk është mbyllur I EVP i Rrogozhinës, referuar gjendjes së tij dhe rekomandimeve të dhëna, me synim arritjen e Objektivit 2 “Krijimi i një ambjenti të sigurtë dhe promovues?””, - DPB i është përgjigjur se arsyet e mosmbylljes lidhen me:

“Mundësitë akomoduese (mundësitë e munguara) të I EVP-ve të Sistemit të Burgjeve, që ofrojnë distanca sa më të vogla me këtë institucion;

Mundësia (ndr. mundësia e munguar) në raport me detyrimin për të ofruar punësim për stafet policore dhe civile.

Sa më sipër, nevoja për të plotësuar kërkesat rrjedhojë e mbylljes së I EVP Tepelënë (bazuar në Urdhërit Ministrit të Drejtësisë nr. 636, datë 29.10.2025, për një ndryshim në Urdhërin Nr 624, datë 16.12. 2024, të Minstrit të Drejtësisë “Për klasifikimin e Insitucioneve të Ekzekutimit të Veprave Penale”, (proces i cili ka filluar), bazuar në vlerësimin e situatës dhe nevojës për krijuar një infrastrukture (kushte) promovuese dhe të sigurtë. *Kjo ka detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve që në mungesë të fondeve për një investim të ri të ofrojë projekte për donatorë për rikonstruksionin e këtij institucioni, pra të jetë një investim i qendrueshëm bashkëkohor.*

Mbyllja e burgut të Rrogozhinës është në proces, pasi duhet të planifikohet garantimi i kapaciteteve të nevojshme⁴⁷.

Përtej arsyeve të parashtruara nga DPB, lidhur me mosmbylljen akoma të I EVP – së së Rrogozhinës dhe Lushnjes, pavarësisht gjendjes së mjerueshme prej kohësh (konstatuar së pari në 2016 nga ekspertët anglezë), *kushtet e konstatuara janë në shkelje të detyrimit për të ofruar trajtim me dinjitet ndaj të burgosurve dhe për sa cenojnë të drejtat e njeriut, ato nuk justifikohen nga mungesa e burimeve.*

Foto Nr. 1. Pamje nga I EVP Rrogozhinë



Burimi: Grupi i Auditimit

⁴⁵ VKM Nr. 209, datë 6.4.2022 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”, neni 2, paragrafet 1, 2 dhe 3.

⁴⁶ https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Nelson_Mandela_Rules-E-ebook.pdf


⁴⁷ Përgjigje e DPB – së, dhënë pyetsorit të GA.

Foto Nr. 2. Pamje nga I EVP Rrogzhinë



Burimi: Grupi i Auditimit

Foto Nr. 2. Pamje nga I EVP Rrogzhinë



Burimi: Grupi i Auditimit

Rikonstruksioni i godinave të pabanueshme, në Institucionin Mjekësor të Posaçëm /Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale – Lezhë.

Gjatë vitit 2024 janë menaxhuar gjithsej 21 institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, prej të cilave: 8 institucione paraburgimi; 10 institucione burgimi; 1 institucion për trajtimin e të miturve (në Kavajë), si dhe 2 institucione të veçanta shëndetësore për të burgosurit: Institucioni Mjekësor i Posaçëm - Lezhë (IMP/IEVP Lezhë), si dhe IVSHB (Spitali i Burgjeve) Tiranë.

Deri në nëntor të vitit 2021 meshkujt me masa mjeksore, mjekim i detyruar dhe mjekim i përkoshëm, janë mbajtur në I EVP - Krujë (Zahari), ndërsa gratë janë mbajtur në një pavion të Qendrës Spitalore të Burgjeve. Për shkak të kushteve tejet të rënda të trajtimit të shtetasve me masë mjeksore në I EVP Krujë, ky institucion u mbyll dhe këta shtetas u transferuan në I EVP-në Lezhë.

Me transferimin e këtyre shtetasve, të cilët janë subjekt edhe i Ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe në mbështetje të menaxhimit të shërbimeve për ta, janë nënshkruar:

- Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për trajtimin e personave me masë mjekësore” dhe “Plani i përbashkët i veprimit për përmirësimin e kushteve dhe të trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore”;

- Memorandumi i Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë nr. 4787 Prot, datë 23.11.2021 dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 6111 Prot, datë 23.11.2021, "Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore" dhe plani i veprimit;
- Udhëzimi i përbashkët i MSHMS – së dhe MD – së, me nr.1 prot, datë 17.03.2023.

Më datë 23.10.2025 grupi i auditimit vizitoi IMP/IEVP – Lezhë, strukturë e cila është e dedikuar eskuzivisht për akomodimin e shtetasve me masë mjekësore.

Sikurse nga të dhënat e konstatuara nga grupi i auditimit, kapaciteti i kësaj strukture, është 214 persona. Aktualisht, aty janë të akomoduar 464 persona me masë mjekësore, pra me një popullim 216% të kapaciteteve. Hapësirat e banimit kutërbojnë erë të rëndë.

Në "Raportin mbi situatën e sigurisë dhe të drejtave të njeriut në burgje dhe paraburgime", referuar në Gjenevë në datat 4-15 nëntor 2024, pranë Këshillit të të Drejtave të Njeriut, lidhur me transferimin e personave me masë mjekësore drejt IEVP – së Lezhë, thuhet se: "Kjo qasje është parashikuar si zgjidhje afat shkurtër deri në ngritjen e një institucioni të ri", ndërkohë që citohet: "Problem shqetësues mbetet mbipopullimi, pasi kapaciteti në dispozicion nuk mbulon numrin e lartë të pacientëve"⁴⁸

Sistemimi i personave me masë mjekësore është bërë në dy godina të rikonstruara (godinat nr. 4 dhe nr. 5), të përshtatura dhe të mobiluara me buxhetin e shtetit, ndërkohë që "godinat nr. 1, 2 dhe 3, janë shpallur si të pabanuara"⁴⁹(dëmtuar nga termeti).

Duke pasur parasysh se "*Sistemi i burgjeve, në ushtrimin e veprimtarisë, udhëhiqet nga parimet dhe respektimi i të drejtave si më poshtë vijon:*

- *I burgosuri trajtohet me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat e tij njerëzore.*
- *I burgosuri gëzon të gjitha të drejtat që nuk i janë kufizuar apo hequr në mënyrë të ligjshme nga vendimet e dënimit apo masat e sigurisë me burgim.*
- *Kushtet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, që cenojnë të drejtat e njeriut nuk justifikohen nga mungesa e burimeve"⁵⁰, Ky mbipopullim i cili është më shumë se dyfishi i kapaciteteve akomoduese të IMP/IEVP–Lezhë, krijon kushte të cilat vlerësohen si të papranueshme dhe në shkelje të përcaktimeve ligjore.*

Infrastruktura dhe fondet buxhetore të përdorura nga sistemi i burgjeve kanë përmbushur nevojat e një trajtimi dinjitoz dhe investimet e kryera në IEVP-të.

Burimet financiare dhe investimet kanë rëndësi thelbësore për përmirësimin e kushteve dhe shërbimit për të burgosurit dhe për zhvillimin e sistemit të burgjeve në përgjithësi. Investimet në infrastrukturë janë pjesa më e dukshme dhe e prekshme nga personat që qëndrojnë në këto institucione. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe të gjitha IEVP-të në varësi të saj financohen nga buxheti i shtetit. Kështu, përjashtuar investimet që mund të realizohen me mbështetjen e një donatori, zhvillimi i sistemit penitenciar varet tërësisht nga fondet publike të alokuara për të.

Më konkretisht, në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 objektivi 4.3 "Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë, parashikohen një sërë objektivash dhe aktiviteteve të lidhura me sistemin penitenciar, si dhe rritja e mbështetjes së saj për institucionet e varësisë", ku është kërkuar kryerja e analizës së situatës së kontrollit të brendshëm financiar në shërbimin e burgut, përfshirë kontrollin e brendshëm të MD-së për mbikëqyrjen e njësisë dhe përgatitja e një vlerësimi të detajuar të rrezikut në lidhje me administrimin financiar në burgje (nën objektivi 4.3.4)⁵¹. Nga auditimi konstatohet se në lidhje me këtë pikë edhe pse dokumenti strategjik ndodhet në vitin e fundit të zbatimit të tij, nuk është bërë progres i dukshëm dhe nuk është gjeneruar asnjë nga produktet e kërkuara, veçanërisht me kontrollin e brendshëm

⁴⁸ "Raporti mbi situatën e sigurisë dhe të drejtave të njeriut në burgje dhe paraburgime", referuar në Gjenevë në datat 4-15 nëntor 2024, pranë Këshillit të të Drejtave të Njeriut.

⁴⁹ Përgjigja e DPB –së, dhënë pyetsorit të grupit të auditimit.

⁵⁰ VKM Nr. 209, datë 6.4.2022 "Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve", neni 2, paragrafet 1, 2 dhe 3.

⁵¹ Strategjia Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 objektivi 4.3 dhe 4.3.4

financiar, pra mungon ngritja e një sistemi kontrolli të brendshëm financiar në proceset financiare që kryhen në IEVP-të në administrimin dhe dokumentimin e lëvizjes së vlerave materiale e monetare.

Auditimi është përqëndruar në analizën e informacioneve dhe dokumentacionit të marrë gjatë auditimit në terren, kryesisht në kushtet e trajtimit dhe qëndrimit të dënuarve në IEVP-të e sistemit burgjeve, duke analizuar e vlerësuar përdorimin me efektivitet e ekonomikitet të fondeve të vëna në dispozicion të DPB-së, për sigurimin e kushteve sa më të mira dhe afër standardeve që kërkohen nga plotësimi i kërkesave të institucioneve ndërkombëtare dhe ratifikimit të Konventave ndërkombëtare, që kërkojnë trajtim dinjitoz e pa diskriminim të dënuarve në burg. Grupi i auditimit ka audituar për nga rëndësia buxhetin dhe është përqëndruar tek investimet dhe shpenzimet hoteleri, etj., por pa lënë menjanë investimet dhe shpenzimet për rritjen e sigurisë në burgje me kushtet e zhvillimeve teknologjike të kohës për një siguri sa më të lartë në burgje.

Efektiviteti dhe ekonomikiteti i përdorimit të fondeve buxhetore në DPB-ve dhe njësitë vartëse, janë vlerësuar nga grupi i auditimit si objektiv auditimi për të konkluduar në anët pozitive të menaxhimit të fondeve buxhetore dhe evidentuar ato mangësi e problematika, të cilat me rekomandimet tona do të sjellin përmirësimin e menaxhimit dhe rritjen e efektivitetit e ekonomikitetit në vlerën e parasë. Përqëndrimi i analizave dhe trajtimit të buxhetit të angazhuar për të dënuarit në drejtim të planifikimit dhe përdorimit të fondeve të vëna në dispozicion për trajtimin e të burgosurve në ambientet e IEVP-ve, si dhe fondeve të përdorura për projekte apo procese për aftësimin profesional, arsimimin, laboratorë profesional dhe ambiente të përshtatshme për takime e qëndrime me familjen dhe njerëzit e afërt të tyre dhe që i shërbejnë rehabilitimit dhe riintegritit të dënuarve. Fokusi u vendos tek Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP-të (njësitë vartëse), duke qenë se këto institucione janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejt me shërbimet që i ofrohen personave të dënuar, dhe efektet e investimeve dhe fondeve të përdorura për sigurimin e kushteve dinjitoze në ambientet e qëndrimit të dënuarve.

Në dy subjektet e tjera AKPA dhe DP Shërbimit të Provës është evidentuar fakti se nuk kanë fonde specifike të ndara e të cilësuar për rehabilitimin dhe riintegritin e personave që përfundojnë dënimin ose dalin me dënime alternative e mbikëqyrje, të cilët janë përfshirë në programe punësimi apo riintegriti dhe mungon një evidencë financiare analitike dhe bindëse, ku të mbështetemi si grup auditimi.

Objektivat dhe qëllimi i IEVP-ve, është përgatitja dhe zbatimi i programeve buxhetore në shërbim të sigurimit të kushteve brenda standardeve të rehabilitimit dhe riintegritit të tyre, nëpërmjet krijimit të kushteve sa më të mira të jetesës, infrastrukturës së nevojshme për aftësim profesional, arsimim e edukim shoqëror sa më rezultativ e për t'i përgatitur për një jetë më të mirë në shoqëri.

Në auditimin e kryer mbi fondet e përdorura për trajtimin e të burgosurve në burgje dhe kryerjen e proceseve të rehabilitimit dhe riintegritit të tyre brenda burgut, por dhe pas daljes, analizimi i buxhetit u shtri në zërat kryesorë të buxhetit të DPB (administratë dhe IEVP-të), pikërisht investimet dhe shpenzimet për Meremetime të mëdha, që ndikojnë direkt në përmirësimin e kushteve të jetës në burg dhe rrisin sigurinë e të dënuarve në përputhje me zhvillimet bashkëkohore teknologjike.

Të dhënat kryesore mbi të cilën është kryer analiza janë në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.7: Të dhënat e buxhetit për DP Burgje dhe IEVP-të.

Mijë/lekë

Zërat	Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024	
	Plan B. rishik.	Fakti	Plan B. rishik.	Fakti	Plan B. rishik.	Fakti
Sistemi i Burgjeve buxheti⁵²:	1,634,860	1,541,956	2,228,197	2,198,726	2,009,934	1,863,747

Sistemi (shpz. personeli & operative 000/ lekë (llog.600+601/602)	1,181,550	1,117,441	2,067,722	1,999,051	1,707,829	1,677,421
Sistemi (shpz. Kapitale/investime llog. 231 dhe projekte)	447,040	418,474 (93.6%)	216,800	195,013 (90%)	298,000	182,290 (62%)
Transferata brendshme për të dënuarit e moshës së tretë/kalimtare e ndihmë ekonomike llog. 604-606	6,270	6,041	4,675	4,662	4105	4,037
% e ndryshimit të buxhet të sistemit gjatë vitit (plan.Rish/Fakt)		-5.7%		-1.4%		-7.3%

Burimi: DPB/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga analizimi i tabelës së mësipërme konstatohet se, buxheti faktik në total i sistemit të burgjeve ka pësuar ndryshime përgjatë viteve, konkretisht: Buxheti i vitit 2022 në krahasim me vitin paraardhës ka pasur rritje të vogël dhe fakti se nga buxheti i rishikuar gjatë vitit në vlerë 1,634,860 mijë lekë, rezulton se është përdorur buxheti faktik në vlerë 1,541,956 mijë lekë ose realizuar buxheti në total në masën 94% vitin 2022. Investimet në këtë vit buxhetor janë realizuar në masën 94.3 %, ku nga 447,040 mijë lekë planifikuar janë përdorur 418,474 mijë lekë, konkretisht nuk ka përfunduar Rikonstruksioni i godinave në IEVP Pojskë ku është përdorur vlera 40,594 mijë lekë nga 44,250 mijë lekë ku diferenca rezulton se është garancia 5% e mbajtur për punimet. Investim kryesor ka qenë edhe “Blerje Automjete” në vlerë 127,954 mijë lekë nga 130,750 mijë lekë të planifikuara nëpërmjet rialokimit me shtesa +94,750 mijë lekë, rialokim ky në pakësim të zërit “Investime për studim-projektim” dhe zërin “Rikonstruksion i Godinës IEVP Vaqarr” me vlerë – 50,000 mijë lekë, si dhe Zërin “Përmirësimi kushteve fizike të jetesës nëpërmjet përmirësimit të përgjithshëm të infrastrukturës ndërtimore në IEVP” në vlerë – 59,369 mijë lekë. Në analizën dhe vlerësimin e kryer nga ana e grupit auditimit konstatohet se ndryshimi i destinacionit të këtij fondi është i drejtë, pasi vetë përcaktimi si zë, nuk është konkret dhe citimi nuk shpreh drejt e saktë se çfarë investimi është, në cilat objekte konkrete (IEVP) do të zbatohet, sipas Projekt studimit apo kërkesave për nevoja ndërhyrje dhe në cilat zëra kryesor punimesh do të kryhen. Zë i veçantë dhe me rëndësi është “Furnizim e vendosje pajisje elektronike” në vlerën 83,344 mijë lekë, krahas mirëmbajtjes janë kryer dhe vendosja e sistemit elektronik të menaxhimit vizitave hyrje-dalje në vlerë 145,290 mijë lekë, me synimin rritje e sigurisë së të dënuarve në ambientet e burgut. Siç konstatohet, vërehet se fondet e planifikuar për Investime e Meremetime të mëdha, nuk konsistojnë në veçimin e fondeve për investime kapitale, pasi po të shikohet vlera e amortizimit të objekteve sipas bilancit financiar të vitit buxhetor 2022, arrin në 580,000 mijë lekë dhe së paku fondi për investime duhet të jetë i barabartë me rreth 600,000 mijë lekë. Në fakt kemi planifikim fonde në vlerë 447,040 mijë lekë ose minimumi -153,000 mijë lekë, vlerë amortizimi që nuk mbulohet në këtë vit buxhetor, duke mos ndikuar në përmirësimin e kushteve, por duke e rënduar situatën, pasi nuk kryhet mbulimi me fonde i nevojave për meremetime të mëdha e mirëmbajtje. Kjo diferencë mund të përfaqësojë ndërtimin e një burgu të ri, i cili do ndikonte në uljen e mbipopullimit dhe përmirësimin e infrastrukturës së objekteve të vuajtjes së dënimit.

Buxheti i vitit 2023 në krahasim me vitin 2022 ka patur rritje në vlerë + 686,241 mijë lekë (1,541,956-2,228,197) dhe në këtë vit nga buxheti i planifikuar e rishikuar në vlerën 2,228,197 mijë lekë janë përdorur në fakt 2,198,726 mijë lekë ose realizuar buxheti në masën 98.6 %. Në këtë vit buxhetor 2023, rritja më e madhe ka qenë në strukturën e shpenzimeve operative llog.602 në dyfishimin e vlerës e detyruar kjo për përdorim në mirëmbajtje e shpenzime të tjera për të bërë riparime e plotësime të ndryshme. Kjo rritje ka ardhur nga rritja e pagave dhe kontributit sig. shoqërore rreth + 200,000 mijë lekë, ndërsa Investimet janë ulur duke arritur nivel të ulët që në planifikim – 50% të investimeve të vitit paraardhës 2022 me realizim në masën 90%.

Ky ndryshim i treguesve të buxhetit të DPB, ka sjellë një ndikim negativ në planifikimin dhe kryerjen e investimeve që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës të dënuarve apo planifikimin dhe kryerjen e investimeve afatgjatë në rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kushteve, përmes investimeve të qëndrueshme kapitale në infrastrukturën e ngritjes së objekteve të reja sipas standardeve të kërkuara. Po kështu në sistemin penitenciar ka dhe burgje të tjera që duan ndërhyrje pasi me gjendjen që janë meremetimet e pjeshme nuk japin siguri për kushte të qëndrueshme e cilësore, pasi amortizimi i tyre është në kufijtë e fundit, siç janë IEVP Rrogozhinë, burgu i grave “Ali Demi”, burgu i Shënkollit dhe burgu Tepelenë (i mbyllur aktualisht), etj.

Buxheti i vitit 2024 në krahasim me vitin 2023 ka patur ulje të finacimit nga buxheti dhe kjo konstatohet që në planifikim ku kemi fond të planifikuar në total vlerën 2,009,934 mijë lekë nga plani i vitit 2023 që ishte 2,228,197 mijë lekë ose një planifikim më pak në vlerën -218,263 mijë lekë, me realizim në vlerën 1,863,747 mijë ose – 150,000 mijë lekë më pak nga planifikimi.

Në këtë vit buxhetor 2023, rritja më e madhe ka qenë në strukturën e shpenzimeve operative llog.602 në dyfishimin e vlerës, kjo ka ardhur nga nevojat në rritje për përdorim në mirëmbajtje e shpenzime të tjera për të bërë riparime e plotësime të ndryshme. Kjo ulje ka ardhur nga mosrealizimi i zërit “Investime” në llogarin 231, ku nga plani 298,000 mijë lekë, janë realizuar investime në vlerë 182,290 ose 62% e planit, tregues ky i dobët në performacën buxhetore dhe treguesi më i ulët i tre viteve 2022-2024 që janë objekt auditimi.

Për periudhën objekt auditimi 2022-2024, nga grupi i auditimit konstatohet një menaxhim dhe shpërndarje e mirëmenduar e investimeve nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Projekteve(DSHP) në DP Burgje, ku theksi është vënë në drejtim të rritjes së sigurisë së të dënuarve dhe në investime me impakt të lartë në siguri dhe lëvizje të sigurt të dënuarve për nevoja në gjykata dhe transferime, ku investimi në autoburgje dhe autoambulanca sigurie , ka përmirësuar shumë sigurinë në lëvizje dhe për transferimet e të sëmurëve për nevoja të institucioneve përkatëse. Nga vlerësimi dhe analizimi i treguesve, pa mohuar punën e mirë të Drejtoria e Shërbimeve dhe Projekteve në DP Burgje, konstatohet se fondet e programuara, alokuar në vitet buxhetore për periudhën 2022-2024 në zërin “Investime” llogaria 230-231, nuk kanë pësuar rritjeardhur kjo dhe nga alokimet në mes vitit buxhetor duke i pakësuar ato.

Fakti se investimet e vitit 2024 janë të barabarta me investimet e vitit 2022, tregon se vëmendja ndaj përmirësimit të kushteve dhe infrastrukturës në burgje nuk ka qenë e duhura që në planifikimin e buxhetit, pasi duhet që të ketë një plan afatgjatë për investimet kapitale me synim krijimin e ambienteve me standardet e kërkuara dhe që sigurojnë kushtet për trajtim dinjitoz. Nevojat për investime kapitale janë të mëdha, por është e nevojshme që rritja e standardeve të kushteve në ambiente sa më të mira, do të krijojë kushte më të mira e të pranueshme të dënuarve në ambientet e IEVP-ve.

Në vlerësimin analitik të zërit “Investime”, *nuk evidentohet se nga DPB ka një planifikim real për investime për krijim ambientesh puntorie apo klasa për përgatitjen e aftësimin profesional për profesionet kryesore që kërkon tregu jashtë mureve të burgut.* Kjo u shërben të burgosurve të përfitojnë nga programet e rehabilitimit dhe të riintegritimit, duke përfituar profesione që do ju vlejshëm shumë pas përfundimit të dënimit e përfshirjen në shoqëri me dinjitet e aftësi profesionale, që të përballojnë jetesën e tyre dhe familjes, pra të kenë një integrim efikas dhe mos ti kthehen kriminalitetit.

Në investimet kryesore kemi “Rinovimi e 3 IEVP-ve dhe rikonstrukcion e infrastrukturës parësore si:

- Përmirësimi i Infrastrukturës Parësore në vlerën e 355,636,000 leke e përfunduar dhe marrë në dorëzim në Gusht 2025.
- Ka përfunduar hidroizolimi i taracave të 9 IEVP-ve: Fushë-Krujë, Durrës, Kavajë, Peqin, Mine Peza, Lushnjë, Korçë, Berat dhe Vlorë.
- Blerje Autoambulanca dhe Autoburgje në vlerën e 127,620,000 leke të përfunduar dhe marrë në dorëzim në Korrik 2025.

- Hartim/Projektimi dhe Ndërtimi e Burgut të Ri në Kukës me vlerë 640,000,000 lekë, është shpallur fituesi, kontrata për zbatim lidhet brenda muajit Nëntor 2025, ndërsa I EVP Tepelenë për mungesë të kushteve të trajtimit dhe kapacitet të ulët është mbyllur me Urdhër Nr.636, datë 29.10.2025 të Ministrit të Drejtësisë, siç është parashikuar në Master Planin 2025-2030.

Mbi përdorimin e buxhetit dhe ndikimi në buxhetin e DPB në funksion të plotësisimit nevojave dhe kushteve të trajtimit.

Në mungesë të të dhënave financiare lidhur me rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve grupi i auditimit nuk ka mundur të bëjë një analizë të fondeve apo shpenzimeve të realizuara për këtë qëllim. Trajtimi ynë në vijim të auditimit do të përqëndrohet kryesisht në efektivitetin dhe eficiencën e përdorimit të burimeve të ndryshme ekonomike e njerëzore në shërbim të përmirësimit të treguesve të trajtimit dinjitoz e rehabilitimin gjatë kohës vuajtjes dënimit dhe riintegrimin e të dënuarve në shoqëri pas përfundimit të dënimit si i barabartë.

Nga ana jonë u vlerësua pasqyra e “Detajimit të Shpenzimeve kapitale 2024-2026 për sistemin e burgjeve” të Ministrisë Drejtësisë sipas ligjit të buxhetit nr.97/2023 dhe konstatohet se parashikimi për llogarinë 231 “Investime” në tre vitet 2024-2026 është parashikuar në vlerë 300,000 mijë lekë, parashikim ky jo i argumentuar në raport me nevojat që paraqiten, pasi po të kemi parasysh se vetëm amortizimi që ndodh në çdo vit radhazi (për tre vite nuk është i njëjti në vlerë e përqindje), nuk është bindës planifikimi i të njëjtit fond buxhetor. Buxhetet e tre viteve 2022-2024 janë buxhete historike dhe ndryshimi i vogël, nuk ka sjellë përmirësim kushtesh thelbësore për të dënuarit, por vetëm kanë mbajtur funksionalitetin e tyre me shërbime të domosdoshme dhe të nevojshme.

Përdorimi i buxhetit për vitin 2022 në zërin investime ka qenë 418,473 mijë lekë, viti 2023 në vlerë 195,129 mijë lekë dhe viti 2024 vlerë 181,300 mijë lekë, pra investimet faktike kanë ardhur në ulje dhe për këtë kërkohet rishikim me grup pune për një planifikim sa më afër nevojave dhe ndikimit në përmirësimin e kushteve në burgjet e vendit. Në analizën e nënzhërave të këtij plani, konstatojmë se nuk kemi parashikim për asnjë investim kapital si ndërtim të ri apo Meremetime të mëdha (rikonstruktion thelbësor).

Fakti që në zërin e buxhetit “Financime të huaja” është zero, tregon se nuk ka asnjë financim të huaj. Kjo ka ardhur dhe nga puna e dobët prezantimit të nevojave nëpërmjet projekteve të ndryshme nga Ministria e Drejtësisë dhe DPB, në përthithjen e fondeve të huaja nga BE, Këshilli i Europës dhe institucionet ndërkombëtare.

Ministria e Drejtësisë dhe DPB, në punën e tyre nuk kanë patur bashkëpunimin dhe kujdesin e duhur për të ngritur sisteme efikase menaxhimi e kordinimi për të mobilizuar dhe mbledhur burime të përshtatshme financiare të brendshme dhe të huaja. Kjo kërkon një qasje të strukturuar për mënyrën e realizimit të tij, duke i shpërndarë dhe përdorur këto fonde, në fonde investimi dhe burime financiare, për të përmbushur më mirë nevojat që ka sistemi i burgjeve në Shqipëri.

Është e nevojshme që të dihen nga strukturat menaxhuese të DPB dhe I EVP-të se çfarë kontributesh kërkohen nga Qeveria dhe partnerët e zhvillimit për të mbushur këto mangësi, si dhe rritjen e financimit për përmirësimin e kushteve të burgjeve sipas kërkesës, krijimin, plotësimin e kushteve dhe standardeve që kërkohen.

Është kërkesë shumë e domosdoshme që në lidhje me sistemin penitenciar(burgjeve), që të rritet efikasiteti i përdorimit të fondeve publike dhe duhet bërë një strategji kombëtare zhvillimore me hartimin e një programi të veçantë kombëtar të investimeve në këtë sistem, gjithmonë i harmonizuar dhe si pjesë e strategjisë kombëtare të investimeve në ngritjen e një sistemi penitenciar sa më të sigurt, dinjitoz e bashkëkohor.

Nevoja për financim të qëndrueshëm të shërbimit për të dënuarit në I EVP-të.

Në auditimin e dokumentacionit dhe vlerësimin e situatave financiare që janë përballur I EVP që janë ndërtime të vjetra dhe me amortizim historik që cënon jo vetëm nivelin e trajtimit, por dhe sigurinë në burgje për periudhën e auditimit 2022-2024 me referencë krahasuese viti 2020-2021, është evidentuar fakti se këto institucione kanë buxhete historike(vetëm për vazhdimësi

dhe jo buxhete me ndikim thelbësor në shpenzime dhe investime) dhe po të shikohen alokimet që janë kryer në këtë periudhë, konstatohet se ato janë kryer për të përballuar nevojat e domosdoshme. Në asnjë rast nuk kemi alokime shtesë për përmirësim të dukshëm e real të kushteve të trajtimit të dënuarve dhe krijimin e kushteve rehabilituese e riintegruese të dënuarve në I EVP-të(ambiente të veçanta për aftësim profesional, arsimim, laboratorë, ambiente familjare me standarde, etj.) Këto alokime nuk kanë qenë të qëndrueshme, por janë kryer me shtesa e pakësime, duke mbajtur një buxhet historik me rritje tepër të vogël dhe jo me ndikim të dukshëm.

Është shumë e nevojshme për DPB dhe I EVP-të që të trajtojnë të dënuarit me kushte sa më të mira e dinjitoze dhe të kenë një financim të qëndrueshëm, ku të përfshijnë mbulimin me fonde të gjitha nevojat e paplotësuara për shërbime dhe vështirësitë financiare që mund të lindin nga mungesa e aftësisë paguese për pagesat për shërbime hotelerie dhe mirëmbajtjen e ambienteve të qëndrimit të dënuarve.

Në auditimin e kryer për shpenzimet operative nga llogaria 602 në tre vitet janë kryer blerje për artikuj gazermimi “Materiale të buta e veshëmbathje e orendi hotelerie që synojnë përmirësimin e kushteve të dënuarve me vlerë 38,400 mijë lekë me kontratë nr. 18392/3 datë 25.11.2024 dhe një blerje/furnizim në vitin 2022 me vlerë 24,588 mijë lekë dhe viti 2023 me vlerë 43,530 mijë lekë, por në këto blerje nuk ka asnjë blerje për veshje me shenja treguese për të dënuarit, gjë kjo që duhet të rivlerësohet e të shikohen mundësitë për blerje uniforme me shenja treguese, duke marrë përvojën në vendet fqinje.

- Nga auditimi i kryer në terren dhe nga vlerësimi i gjendjes së administrimit, dokumentimit , lëvizjes dhe ruajtjes së materialeve të konsumit dhe inventar në magazina e që përdoren në sistemin e regjimit të I EVP-ve, u konsatua se mungon dokumentimi ligjor dhe financiar i tyre sipas kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Menaxhimi financiar dhe kontrolli” i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 dhe ligjin nr.14/2023 dhe Udhëzimit të MF nr 30, datë 27.12.2011 “Menaxhimi i Aktiveve në sektorin publik e privat”. Mangësitë e konstatuara janë në mënyrën e dokumentimit të lëvizjes së materialeve nga magazina qendrore e I EVP-së në regjim, ku dokumentacioni i plotësuar në ato raste që ishte ishte abuziv dhe i pa plotësuar sipas kërkesave ligjore, kjo u konstatua në I EVP Korçë, Lezhë etj. Konkretisht; Fletë daljet shoqëruese të brendshme ishin plotësuar me mangësi; mungon nr. rendor i faturës shoqëruese, por në mënyrë të kundraligjshme pretendohet se kemi datën nr. rendor. Kjo është e papranueshme, pasi artikujt që shkruhen nuk mbyllet numëri i tyre, por lihet i hapur dhe lë shteg për abuzim, mund të shtohen artikuj dhe sasi pa kufizim nga magazinieri dhe personat e tjerë të interesuar, në shumë raste ishin , ose me një firmë dhe pa firmë të marrësit në dorëzim. Kartelat tyre dhe mënyra e dokumentimit nuk është e plotë dhe nuk plotësoheshin në kohë reale dhe derisa mbështetjet nga fletë shoqëruese fiktive e të parregullta e bën nul procesin e dokumentimit të lëvizjes së materialeve në regjim dhe sektorët e tjerë ndihmës. Konstatimet e këtyre subjekteve janë evidentuar dhe nga Auditi i Brendshëm e DPB-së, por nga grupi i auditimit të brendshëm , jo vetëm nuk ka pasqyrim real, por është kaluar si një shkelje e zakonshme. Detyrimi i audiituesve të brendshëm ka qenë që të thelloheshin, të nxirrni efektet dhe vlerat e shpërdorimit me sistemin e kryqëzimit të veprimeve, të nxirrnin përgjegjësinë direkte dhe të pergatisnin rekomandime të qarta e me afate të caktuara për zbatim e njoftim të zbatimit tyre.

Nga auditimi dhe verifikimi i shërbimeve ndaj të dënuarëve në Qendrën Spitalore të Burgjeve (QSB)Tiranë, I EVP Shënkoll, I EVP Korçë dhe I EVP Pojskë, u konsatuan mangësi e parregullsi në administrimin e medikamenteve në farmacinë e QSB-së, në dhomat e doktorëve dhe infermiereve, konkretisht, mungon dokumentimi i rregullt i medikamenteve në sasi e vlerë, dhe përdorimi i tyre nuk dokumentohet i plotë. Në ambientet ku mbahen medikamentet nuk ka dokumentacion si libër magazine, proces verbale për medikamentet që u mbaron afati i përdorimit, ato mbahen sëbashku me medikamentet e tjera dhe bëhen objekt abuzimi dhe rrezikojnë jetën e të dënuarve nëse ato përdoren në mënyrë të pavullnetshme duke u perzier me medikamentet e përdorura. Nuk ka asnjë proces verbal apo dokument në ruajtje ku të jetë

shënuar sasia, vlera dhe afati i skadencës dhe të ketë mbishkrimin “Të skaduara” Rrezik, Mos i përdor” jashtë aftit skadencës” dhe të jenë vendosur në një ambient të veçantë sipas rregullave deri në azgjesimin e tyre.

- Në institucionet e trajtimit të veçantë në I EVP Shënkoll (pjesa e trajtimit të personave që janë të dënuar dhe kanë probleme shëndetit mendor dhe Spitalin e Burgut Tiranë rezulton se situata buxhetore e shpenzimeve dhe kostos për një pacient, nuk ka arritur të plotësojë kushtet bazë të trajtimit të drejtë e dinjitoz të këtyre personave. Kjo e argumentuar nga vlerësimi i kushteve që kanë si në hoteleri dhe në ambiente ku ka mbingarkesë në numrin e pacientëve që qëndrojnë në një dhomë (ambienti).

- Ka munguar vëmendja për përmirësimin e kushteve në trajtimin e dënuarve me masë sigurie në I EVP Shënkoll, ku numri i pacientëve dhe kapaciteti i këtij ka mbingarkesë jashtë kushteve e kriterëve të caktuar për një trajtim dinjitoz e të drejtë. Është në projekt për tu filluar ndërtimi i një ambienti të ri brenda burgut, por nuk ka planifikim fondesh, por vetëm premtim.

- Është konstatuar se në disa I EVP janë punësuar të dënuar, gjë kjo që ka dhënë impakt pozitiv në krijimin e kushteve të përshtatshme për rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve. Punësimi i tyre bazohet në parime dhe konkretisht sipas VKM nr.602, datë 13.10.2021 “ Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj” Kreu I,” Rregulla të përgjithshme”, pika 4 ku citohet:

“Punësimi i të burgosurit udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

a) parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit;

b) parimi i ndalimit të punës së detyruar;

c) parimi i llogaridhënies;

ç) punësimi në përputhje me aftësitë dhe njohuritë profesionale;

d) parimi i shpërblimit të drejtë për punën e kryer.”⁵³

Punësimi i të burgosurve nuk është i lidhur ngushtësisht me shpërblimin për punën e kryer, por me nxënien, ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive e të njohurive profesionale gjatë ekzekutimit të vendimit, duke garantuar njëkohësisht edhe shpërblimin e drejtë të të burgosurve.

DPB dhe I EVP-të janë të detyruar që të krijojnë kushte për punësim për të burgosurit sipas legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës, duke u përafuar me konsumin e kohës nëpërmjet punësimit në ambientet e vuajtjes dënimit dhe kontributin financiar në familje, faktor ky që e përafuron shumë për riintegrimin familjar e shoqëror të dënuarve. Drejtori i I EVP-së vlerëson kërkesat e të burgosurve për vendin vakant, duke referuar kriterëve që përmbush si: gjendjen ekonomike të familjes së tij, kohën e qëndrimit në Institucion, kohën e kaluar në gjendje joaktive në punë gjatë periudhës së ekzekutimit të vendimit me burgim, sjelljen dhe vlerësimin e riskut të të burgosurit, aftësitë profesionale, fizike e mendore, detyrat e tjera të ngjashme të kryera në të kaluarën, personalitetin, mundësitë objektive dhe hapësirat e lira në ambientet e institucionit ku zhvillohet aktiviteti i punës, si dhe çdo element tjetër për kryerjen e punës. Është e rëndësishme përcaktimi i kushteve shëndetësore të të burgosurit, të cilat vërtetohen nga mjeku përgjegjës për kontrollin e tyre, i cili e pajis të burgosurin me vërtetimin se është klinikisht i shëndetshëm për punë. Punësimi i të dënuarve bëhet sipas kushteve të caktuara në VKM nr.602 datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj” dhe sipas shkresës nga Ministria e Financës Nr.11720/1 Prot datë 22.06.2022 “Mbi punësimin e të burgosurve” e cila ka përcaktuar artikullin buxhetor për kryerjen e pagesës së tyre Artikulli buxhetor 606 “Transferta tek individit”. Zëri në buxhet është parashikuar në artikullin buxhetor 606.

⁵³ VKM nr.602, datë 13.10.2021 “ Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”

Llog 606 **Tabela nr.8 Transferta per buxhetet familjare pagesat e te denuarve te punesuar ne DPBurgje**

Periudha	Llogaria ekonomike/Pagesat per Te Denuarit	Fakti i Realizuar ne buxhet vjetor (606 per te denuarit)	Numri i te punesuarave te burgosur	Pagesa vjetore per çdo të dënuarve të Punësuar	Pagesa Mujore për çdo të dënuarve të Punësuar
2022	Trasferta 606	6,591,448	190	34,692	2,891
2023	Trasferta 606	20,198,836	468	43,160	3,597
2024	Trasferta 606	23,583,813	233	101,218	8,435
Totali		50,374,097	891	56,537	4,712

Burimi: DPB/Përpunimi: Grupi i auditimit KLSH

Shënim: Aneksi 1 Tabela e detajuar sipas I EVP-ve bashkëlidhur aneksit të Projektraportit të auditimit.

Sipas statistikave të marra dhe evidencave të përgatitura nga grupi i auditimit të KLSH-it, për të punësuarit në I EVP-të e sistemit të burgjeve rezultojnë si më poshtë:

Për periudhën 2022-2024 janë paguar nga llogaria ekonomike nr.606 “Pagesa për të punësuarit në I EVP-të” në vlerë totale 50,374,097 lekë me një pagë mesatare në vit 56,537 lekë/vit dhe pagë mesatare mujore përafërsisht 4,712 lekë/muaj, ku rezultojnë se kanë punuar përafërsisht 891 të dënuar për këtë periudhë. Duke vlerësuar punësimin e këtyre të dënuarve ku përveç përfitimit material e ndihmesës që japin në ekonominë e familjeve tyre, punësimi i tyre ka arritur të përafrojë shumë të dënuar në riintegrimin familjar e shoqëror të tyre. Kjo shikohet dhe nga kërkesat për punësim, ku në vitin 2022 kanë marrë pjesë 190 të dënuar, ndërsa në vitin 2023 numri i dënuarve që kryejnë punë brenda sistemit në I EVP është 468 të dënuar, pra +278 të dënuar, ose një rritje prej 246% dhe në vitin 2024 numri i të punësuarve në I EVP-të ishte 233 të dënuar, por këtu shikojmë rritjen e pagesës vjetore në vlerë mesatare 101,218 lekë/vit dhe mesatare mujore 8435 lekë/ muaj. Siç shikohet, kanë punuar një numër i konsiderueshëm i të dënuarve, duke rritur nivelin e shpërblimit për punë të kryer nga viti në vit siç është e paraqitur në tabelën e mësipërme dhe aneksit shoqëruar të Projektraportit të auditimit. Nga ana e grupit të auditimit vlerësohen pozitivisht masat e marra për rritjen e të punësimit nga të dënuarit dhe marrjen e hapave shumë të rëndësishëm që ndikojnë në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin të dënuarve, si në kohën e vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga burgu. Është evidentuar fakti se i gjithë procesi i përzgjedhjes, punësimit me kontratë punëdhënës/punëmarrës mbështetet në legjislacionin në fuqi për punësimin, ku citojmë se dhe parimet e kryerjes së këtij procesi kaq të rëndësishëm bazohen në trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimit, parimin e shpërblimit të drejtë për punën e kryer. Por evidentojmë faktin ***se këta të dënuar të punësuar nuk janë të sigurve, veçanërisht për aksidentet në punë dhe për dëmtime të tjera që mund të ndodhin në proceset e punëve që kryhen***, pasi nënkuptohet se nuk janë mbrojtur nga aksidentet në punë apo dëmtimet e ndryshme gjatë punës, çfarëdo lloj procesi pune të kryer. Duke vlerësuar rëndësinë e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminues nga ana e grupit të auditimit u thelluar në analizimin e ligjshmërisë së këtyre mosveprimeve të stafit drejtues e menaxhues të DPB e I EVP-ve me legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës me veçorinë që kanë këta të dënuar. Konstatohet se nuk kanë asnjë pengesë ligjore për sigurimin shoqëror, ndërsa sigurimi shëndetësor nuk mund të aplikohet, pasi ai financohet nga buxheti për medikamente e shpenzime personeli mjekësor në burgje.

Është në të mirën e rritjes së sigurisë në burg për të dënuarit që të kryjnë punë dhe të jenë të sigurve si çdo shtetas që kryen një punë, të kenë lehtësira për rehabilitimin dhe riintegrimin pas përfundimit të kryerjes së dënimit dhe mos të jetë barrë në ambientin familjar e shoqëror, por të ndihet dinjitoz dhe i sigurt për vijimin e jetes pas lirit, me njohjen e viteve të punës si vite pensioni. Kjo mbështetet në nenin 1 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “ Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me amendamente ligjore dhe ndryshuar dhe me aktin normativ nr. 1, datë 25.1.2017; aktin normativ nr. 7, datë 30.11.2019, ndryshuar me

ligjin nr. 65/2020, datë 21.5.2020, aktin normativ nr. 33, datë 11.12.2020; ligjin nr. 64/2023, datë 21.7.2023) i përditësuar ku citohet se:

Sigurimi shoqëror i detyrueshëm është jofitimprurës, që mbron me të ardhura:

a) Personat e punësuar në lidhje me:

- *paaftësinë e përkohshme në punë për shkak të sëmundjes;*
- *barrë lindjen;*
- *pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes;*
- *aksidentin në punë dhe sëmundjet profesionale;*
- *papunësinë.*

DPB duhet të kishte patur bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet përkatëse si faktor në këtë çështje si; Ministrinë e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Inspektoriatin e Punës, për të konkluduar në mënyrën më të drejtë të llogaritjes së kontributit në referim të shpërblimit (pagës), si nga buxheti dhe nga vetë të dënuarit si përfitues të drejtëpërdrejtë, mënyrat dhe format duhet të ishin gjetur konform legjislacionit në fuqi. Kjo është e shprehur dhe në VKM nr. 602 datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”, Pika 1 e Kreut III “Marrëdhëniet e punës të të burgosurve” ku citohet:

“1. Për punësimin e të burgosurve, kontrata e punës mund të lidhet drejtpërdrejt ndërmjet punëdhënësit dhe të burgosurit, me pëlqimin e Institucionit, në rastet kur punëdhënësi ka përzgjedhur të burgosur të posaçëm për kryerjen e një pune të caktuar, për shkak të aftësive ose njohurive të posaçme të tyre”. Argumenti i grupit auditimit mbështetet në pikën 10 të VKM-së, ku citohet: “Për të burgosurin e punësuar zbatohen rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës”. Mos thellimi i analizës së implementimit të legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës në procesin e punësimit nga drejtuesit e DPB dhe pagesave të kryera për punën që kanë kryer të dënuarit, pa u llogaritur sigurimet shoqërore i ngarkon me përgjegjësi, pasi kanë cënuar të drejtat e të dënuarve që ju jep ligji. Detyrimi i kryerjes së rillogaritjes ose zgjidhjes së problemit të sigurimit të dënuarve që janë marrëdhënie pune është e mbështetur në Pjesën II “Personat që përfitojnë nga sigurimet shoqërore”, neni 6 ku citohet: Neni 6 “Mbrotjtja e detyrueshme” i ndryshuar,

“Sigurimet shoqërore mbrojnë në mënyrë të detyrueshme të gjithë shtetasit ekonomikisht aktivë në Shqipëri, në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë e barrë lindjes, pleqërisë, invaliditetit dhe humbjes së mbajtësit të familjes.

Sigurimet shoqërore, gjithashtu, i japin mbrotjtje të detyrueshme të gjithë personave të punësuar, në rastin e pakësimit të të ardhurave, si pasojë e paftësisë së përkohshme të shkaktuar nga sëmundja, aksidenti në punë, sëmundja profesionale dhe papunësia. Këshilli i Ministrave mund të vendosë për fusha të tjera mbrotjtjeje, si dhe për përjashtime”

Po kështu kemi dhe detyrimet e tjera të ligjit dhe nevoja që duhet të përshtatej VKM -ja ose të kërkoheshin mënyra të tjera efektive, ku të mbroheshin të drejtat e të dënuarve dhe jo diskriminim, Kjo është e mbështetur dhe në Pjesa III “Kontributet”, neni 9 “Llojet e kontributeve për t’u paguar” i ndryshuar, ku citohet: “Personat e punësuar dhe punëdhënësit e tyre janë të detyruar të paguajnë kontribut për sëmundje, barrë lindje dhe pensione, në një shumë që varet nga paga e tyre totale (bruto)”, dhe “Kontributi nuk mund të caktohet nën një pagë minimale dhe mbi një pagë maksimale mujore. Punëdhënësit detyrohen të paguajnë kontribut për aksident në punë e sëmundje profesionale dhe për papunësinë.” Siç shikohet, ky proces paraqet dhe problematika, por këto zgjidhen me frymë bashkëpunimi e në respekt të drejtave që kanë të dënuarit e punësuar dhe jo përjashtimin që sjell diskriminim.

Mbi analizimin e kostove për një të dënuar.

Në një përpunim të dhënave financiare të administruara nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në BP Burgje, evidentohen të dhëna mbi kostot për të burgosurit si një tregues domethënës në lidhje me nivelin financiar të trajtimit me shërbime dhe si tregues që ka vlerë për të kryer analiza financiare mbi efektivitetin dhe efikasitetin e përdorimit të parasë publike për trajnimin e të burgosurve në sistemin e burgjeve. Ky tregues duhet të shërbejë dhe si bazë referimi për strukturim të kostos në mënyrë sa më efektive e me synimin uljen e saj. Nga grupi i auditimit u evidentuan vështirësi në konstatimet e gjurmës së auditimit për një analizë buxhetore sa më të plotë në raport me kostot për çdo të dënuar, pasi në shumë IEVP nuk ka dokumentacion specifik për llogaritjen e kostove në elementët e saj, por ajo është llogaritje e kostos së thjeshtë aritmetike shpenzime total të IEVP-së/numrin e të dënuarve. Kjo për shkak se në IEVP-të nuk ka pasqyra financiare analitike për efekt llogaritje kostoje apo dokumente financiare veçmas, për këtë arsye trajtimi i përdorimit të fondeve për çdo subjekt auditimi i analizuar veçmas sipas situatave buxhetore e financiare me tregues të përpunuar është i vështirë deri i pamunduar. Nga DPB mungon një dokumentim analitik i shpenzimeve, nuk ka kosto të veçantë historike dhe reale, kjo vështirëson grupin e auditimit për një analizë konkrete të kostos për të dënuarit e ditë qëndrimi në burg. Kjo do të mundësonte si drejtuesit por dhe institucionet e mbikqyrjes, monitorimit dhe auditimit të brendshëm e të jashtëm, për të nxjerrë analiza efikase dhe rekomanduar përmirësimin e parasë në këto IEVP sipas legjislacionit në fuqi. Konkretisht situata e kostos totale për të dënuar për çdo IEVP, DPB dhe Sistemi i Burgjeve është në tabelat dhe grafikët si më poshtëm:

Tabela nr.9 . Kosto totale për të dënuar për çdo IEVP, DPB dhe Sistemi i Burgjeve.
Aneksi nr.2 Bashkëlidhur Projektraportit auditimit i detajuar sipas IEVP-ve.

DP Burgje

Viti	Situacioni Vjetor	Nr i te Denuarve mesatar	Kosto Vjetore per te denuar	Kosto Ditore per te Denuar
2022	1,541,955,440	5482	281,276	770.62
2023	2,198,725,873	5689	386,487	1,058.87
2024	1,863,747,257	5224	356,766	977.44


Burimi: DPB

Sistemi i Burgjeve

Viti	Situacioni Vjetor	Nr i te Denuarve mesatar	Kosto Vjetore per te denuar	Kosto Ditore per te Denuar
2022	6,259,540,551	5482	1,141,835	3,128.32
2023	7,794,211,123	5689	1,370,049	3,753.56
2024	7,910,639,124	5224	1,514,288	4,148.73

Burimi: DPB

Grafiku nr.1



Burimi: DPB

Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku nr.1.1

Burimi: DPB

Perpunoi: Grupi i auditimit

Siç vërehet, nga pasqyrat e mësipërme, konstaohet se nuk kemi një vijueshmëri kostoje, pra në ulje ose në ngritje, por kemi lëvizje të kostove në shoifra jo të parnueshme, kjo ka ardhur nga mungesa e evidentimit konkret të shpenzimeve në zëra analitik sipas llojit të shpenzimit e në total për njësi të burgosur. Nga kostoja e vitit 2022 që janë në vlerën 3.899 lekë/ditë /i burgosur, në vitin 2023 kemi një rritje në kosto me vlerë 4.712 lekë, pra + 863 lekë/ditë/burgosur ose +21 %, rritje kjo që ka ardhur dhe nga shpenzimet si DPBurgje, por dhe nga sistemi i burgjeve kemi rritje në vlerë +625 lekë/ditë /burgosur. Këta tregues tregojnë se nuk kemi një rakordancë të kostove në vetvete, pra shpenzimet totale me koston aritmetike për tre vitet, pra nuk kemi një kosto me ulje në vite dhe ka munguar ndjekja apo analizimi i faktorëve që kanë ndikuar në ulje apo ngritje të koston dhe cilët zëra kanë patur peshë specifike më të lartë në kostot efektive.

Tabela nr.10 “Kosto totale për të dënuar për çdo I EVP, DPB dhe Sistemi i Burgjeve “**Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**

Viti	Situacioni Vjetor	Nr i te Denuarve mesatar	Kosto Vjetore per te denuar	Kosto Ditore per te Denuar
2022	1,541,955,440	5482	281,276	770.62
2023	2,198,725,873	5689	386,487	1,058.87
2024	1,863,747,257	5224	356,766	977.44

Burimi: DPB

Sistemi i Burgjeve

Viti	Situacioni Vjetor	Nr i te Denuarve mesatar	Kosto Vjetore per te denuar	Kosto Ditore per te Denuar
2022	6,259,540,551	5482	1,141,835	3,128.32
2023	7,794,211,123	5689	1,370,049	3,753.56
2024	7,910,639,124	5224	1,514,288	4,148.73

Burimi: DPB

Në auditimin e kryer për vlerësimin e hapësirave të përshtatshme/improvizuara për qëllimin e krijimit e kushteve sa më të mira për argëtim dhe aktivitete sportive apo kulturore me të dënuarit dhe për bashkëpunim me shoqata e institucione kulturore e sportive. Institucionet e vuajtjes së dënimit si; I EVP Burrel, Lushnje, “Mine Peza”, “Jordan Misja”, Kukës(fazë ndërtimi të ri), QSB Tiranë, Rrogozhinë, “Ali Demi”, Tepelenë(i mbyllur), janë me infrastrukturë të vjetër, ku mungojnë ambientet e dedikuara për veprimtari edukuese dhe rekreative, apo hapësirat e dedikuara për arsimim, trajnime profesionale, aktivitete kulturore, fetare apo sportive, pasi këto burgje janë ndërtuar dekada më parë dhe janë me kushte të

kufizuara hapësinore dhe me koncepte të vjetra të dënimit, ku fokusi ka qenë vetëm në izolimin e individëve në burg dhe jo rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në familje dhe shoqëri.

Megjithëse në këto institucione nga DPB, janë kryer përshtatje në ambiente multifunktionale, që shërbejnë për ofrimin e shërbimit psiko-social dhe në disa raste përdoren për trajnime profesionale, por nuk plotësojnë kushtet për zhvillim normal e me kushte të praktikave profesionale, pasi nuk ka laboratorë apo pajisje ndihmëse të instaluar, ndërsa për aktivitetet sportive janë përdorur ambientet e ajrimit. Pra siç konstatohet kemi një përshtatje, por jo kushte që sjellin plotësim të nevojës për një trajtim dinjitoz të dënuarve në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin për të qenë të pranueshëm dhe pjesë aktive e familjes dhe shoqërisë e mos të rikthehen në burg.

Burgjet e reja janë projektuar me një qasje më moderne ndaj sistemit penitenciar. Këto institucione në përgjithësi përfshijnë ambiente të posaçme për mësim, biblioteka, klasa, palestera dhe fusha sportive, si dhe hapësira për aktivitete krijuese dhe psikologjike.

Sa i përket ambienteve për takimet me familjarët, i kanë çdo I EVP dhe janë të përshtatur, ndërsa me rritjen e kërkesave nga monitorimi i institucioneve ndërkombëtare dhe ato shqiptare si Avokati i Popullit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, etj., për ngritjen e dhomave të prindërimit, konstatohet se në shumë I EVP janë ngritur dhe aktualisht mungojnë vetëm në I EVP Burrel dhe I EVP Kukës (tani po ndërtohet) ardhur kjo për arsye të mungësës infrastrukturore.

1. Gjetje nga auditimi: Me gjithë përafrimin e kuadrit ligjor shqiptar me *acquis communautaire*, gjatë viteve 2022, 2023 dhe 2024 vërehet se numri i të paraburgosurve, arrin përkatësisht në nivelet e **52,5%, 51,7% dhe 56,4%** të totalit të të burgosurve. Ndërkohë “në mbarë Evropën, vetëm **26%** e të burgosurve janë në paraburgim”⁵⁴. Me këtë ecuri, Shqipëria mban vendin e parë në Evropë për përqindjen e lartë të të paraburgosurve, aktualisht me 58% të popullsisë së saj penitenciare e cila nuk kanë një dënim përfundimtar nga gjykatat. Kjo evidence, dëshmon për problematika në drejtësinë penale, mungesën e alternativave ndaj burgimit, si dhe nevojën për reforma të thella, sidomos në menaxhimin e paraburgimit dhe shkurtime reale të dënimeve për krime jo të dhunshme.

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka përgjegjësi për marrjen e masave për përmirësimin e situatës së mbipopullimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Nga auditimi ka rezultuar se DPB nuk ka bërë shpërndarje të të burgosurve nga I EVP – të me mbipopullim, drejt I EVP – ve me kapacitete të lira akomoduese, duke mos monitoruar siç duhet gjendjen e burgjeve për periudhën 2022-2024.

Rezulton se gjatë vitit 2022 ka pasur mbipopullim në I EVP – të e Lezhës, Elbasanit, Beratit, Korçës dhe Tepelenës, përkatësisht me 153, 7, 7, 27 dhe 32 të burgosur, mbi kapacitetet akomoduese të burgjeve.

Gjatë vitit 2023-2024, në I EVP – të e Kukësit, Lezhës, Elbasanit, Korçës dhe Tepelenës, ka pasur mbipopullim mbi kapacitetet akomoduese të këtyre institucioneve.

Sistemi penitenciar në total, rezulton me kapacitete akomoduese të paezauruara, për vitet 2022, 2023 dhe 2024, përkatësisht me 213, 273 dhe 535 vende të lira.

Kjo situatë mbipopullimi permanente në disa nga I EVP, dëshmon se ka munguar një qasje programuese e shpërndarjeve të burgosurve drejt I EVP – ve të tjera me kapacitete akomoduese të disponueshme.

- Sikurse nga vizita e grupit të auditimit në Institucionin Mjekësor të Posaçëm /Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale - Lezhë, strukturë e cila është e dedikuar vetëm për akomodimin e shtetasve me masë mjekësore, rezultoi se sistemimi i personave me masë mjekësore është bërë në dy godina të rikonstruara (godinat nr. 4 dhe nr. 5), ndërkohë që “godinat nr. 1, 2 dhe 3, janë shpallur si të pabanuara”⁵⁵. Kapaciteti i të dy godinave, është për 214 persona. Aktualisht, aty janë të akomoduar 464 persona me masë mjekësore, pra me

⁵⁴ <https://start-press.eu/raporti-i-kie-58-e-te-burgosurve-ne-shqiperi-jane-ne-paraburgim/>

⁵⁵ Përgjigja e DPB – së, dhënë pyetsorit të grupit të auditimit .

popullim 2,2 herë më shumë se kapacitetet, kjo për shkak të mos rikonstruksionit të tre godinave të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019.

Duke pasur parasysh se “*Sistemi i burgjeve, në ushtrimin e veprimtarisë, udhëhiqet nga parimet dhe respektimi i të drejtave si më poshtë vijon:*

- *I burgosuri trajtohet me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat e tij njerëzore.*
- *I burgosuri gëzon të gjitha të drejtat që nuk i janë kufizuar apo hequr në mënyrë të ligjshme nga vendimet e dënimit apo masat e sigurisë me burgim.*
- *Kushtet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, që cenojnë të drejtat e njeriut nuk justifikohen nga mungesa e burimeve”⁵⁶..*

Këto kushte cenojnë kriteret e trajtimit me dinjitet dhe humanizëm të personave me masë mjekësore dhe mosveprimi për rikonstruksionin e godinave nr. 1, 2 dhe 3, për të pakësuar mbipopullimin aktual, është vetë një shkelje detyrimesh funksionale, përveç se e të drejtave të personave të akomoduar në IMP/IEVP – Lezhë.

3. Gjetje nga auditimi: Sistemi i zbatimit të vendimeve penale, aplikohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës, bazuar në katër ligje:

- Ligji Nr.79/2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale";
- Ligji Nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve";
- Ligji Nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të Provës";
- Ligji Nr.80/2020 "Për Policinë e Burgjeve".

Duke u nisur nga eksperiencia e vendeve të tjera, por edhe nevoja për një menaxhim më të mirë, si në aspektin e kostove, ashtu dhe referuar nevojës për një trajtim të unifikuar të stafit lidhur me karrierën, trajtimin ekonomik, rotacionin, statusin, mbështetjen logjistike të agjencisë dhe efektivitetin e shfrytëzimit të asetëve në dispozicion, nevojitet hartimi i një ligji të vetëm.

Për sa më lart, Master Plani i ri i Burgjeve⁵⁷, në kuadër të Objektivit 1: “Forcimi i kapaciteteve organizative dhe funksionale të sistemit zbatimit të vendimeve penale” parashikon të zbatohet Masën 1.2, lidhur me “Hartimin e një ligji të vetëm mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe me masa në komunitet, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit” nga Ministria e Drejtësisë dhe DPB. Masa 1.2, miratuar dhe shpallur prej shumë kohësh, akoma nuk është konkretizuar me një ligj unifikues.

4. Gjetje nga auditimi: Nga vizita e grupit të auditimit në terren dhe referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogzhinë dhe ai Lushnje, disponon ambiente dhe kushte akomodimi jashtë cdo standardi duke mos siguruar kushte për trajtim me dinjitet dhe humanizëm për të burgosurit/paraburgosurit.

Lidhur me infrastrukturën, grupi i auditimit vëren se: ka përdorim të gjerë të telit me gjemba (edhe ai i arnuar); pjesa e sipërme e ndërtesës është e pasigurt dhe e degraduar; kushtet e akomodimit janë shumë të dobëta; mungojnë hapësirat e dedikuara, ose janë të papërshtatshme për funksionin e tyre, sikurse “Dhoma e prindërimit” në qiell të hapur, mungojnë ambiente për formim profesional, klasa për arsimin, e amortizuar, etj.

Kjo gjendje vlerësohet si e papranueshme dhe në shkelje të parashikimeve ligjor, lidhur me kriteret e trajtimit me dinjitet dhe humanizëm të të burgosurve. Mbajtja në funksion është në shkelje të përcaktimeve të ligjore.

⁵⁶ VKM Nr. 209, datë 6.4.2022 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”, neni 2, paragrafet 1, 2 dhe 3.

⁵⁷ Urdhri i Ministrit të Drejtësisë, nr. 441, datë 6.9.2024 të “Planit të zhvillimit të sistemit të burgjeve 2024-2030”, i njohur ndryshe si “Master Plani i ri i Burgjeve”.

Lidhur me IEVP – në Rrogozhinë, Ministri i Drejtësisë nuk ka ushtruar kompetencën që i njeh ligji⁵⁸, i cili përcakton: “...mbyllja e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim ose seksioneve të veçanta në këto institucione bëhen me urdhër të ministrit të Drejtësisë”.

5. Gjetje nga auditimi: Në trajtimin e analizimin e planifikimit dhe zbatimit të fondeve buxhetore për vitet 2022-2024 DPB, është evidentuar fakti se fondet e investimeve janë përdorur më shumë për rritjen e sigurisë në burgje dhe përmirësimin e transportit të lëvizjes së të dënuarve, si blerje autoburgje e autoambulanca burgu, gjë ka ndikuar në përmirësimin e situatës në këtë drejtim. Megjithatë konstatohet se në kuadrin e programimit buxhetor sipas kërkesave të ligjit “Për buxhetin”, duhet të ishte vendosur tek prioritetet edhe investimet kapitale për ndërtimin e objekteve të reja apo rikonstruksione (Riparime thelbesore) të objekteve eksistuese që plotësojnë kushtet e qëndrueshmërisë sipas standardeve bashkëkohore të sigurisë.

6. Gjetje nga auditimi: Në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë, Lezhë, Reç, janë evidentuar shkelje në plotësimin e dokumenteve të lëvizjes së materialeve si: çarçafë, peshqirë, pantofla, etj., në sektorin e regjimit dhe sektorët e tjerë, duke mos zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 15.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 30, datë 27.12.2011 “Menaxhimi i Aktiveve në sektorin publik e privat” për plotësimin e dokumentacionit sipas formës dhe përmbajtjes së caktuar dhe lënë shteg për abuzime e shpërdorime, duke cenuar drejpërsëdrejti shërbimin e kërkuar ndaj të dënuarve. Po kështu u konstatuan parregullsi në administrimin e medikamenteve si në dokumentimin e përdorimit të tyre dhe në ruajtjen e magazinimit të medikamenteve të skaduara.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se përgjatë periudhës 2022-2024 në IEVP-të subjekt auditimi, kanë punuar përafërsisht 891 të dënuar për të cilët është bërë një pagesë në vlerë totale 50,374,097 lekë. Megjithatë, për këta të dënuar të punësuar brenda burgjeve, nuk është llogaritur e derdhur kontributi i sigurimeve shoqërore për aksidente në punë, pleqërie, sëmundje profesionale, etj. Mungesa e pagesës së kontributit sigurimeve shoqërore është në kundërshtim me detyrimet e zbatimit të legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës dhe sigurimet shoqërore. Kjo është në kundërshtim me nenin 1 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me amendamente ligjore dhe ndryshuar dhe me aktin normativ nr. 1, datë 25.1.2017; aktin normativ nr. 7, datë 30.11.2019, ndryshuar me ligjin nr. 65/2020, datë 21.5.2020, aktin normativ nr. 33, datë 11.12.2020; ligjin nr. 64/2023, datë 21.7.2023) i përditësuar ku citohet se:

“Sigurimi shoqëror i detyrueshëm është jofitimprurës, që mbron me të ardhura:

a) Personat e punësuar në lidhje me:..... -pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes;- aksidentin në punë dhe sëmundjet profesionale;- papunësinë.”

8. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale mungon dokumentimi i plotë i të dhënave financiare sipas llojit të shpenzimit dhe destinacionit, veçmas si për regjimin, mirëmbajtjen, shpenzimet e sigurisë dhe shpenzimet administrative dhe të inkuadruara në total sipas IEVP-së, si dhe një ndjekje reale të analizimit të zërave të kosto/burgosur. Nuk ka pasur kosto reale/burgosur, por janë bazuar në kosto historike, të pa argumentuara e rillogaritur në periudha periodike me treguesit konkretë.

9. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se në IEVP-të Burrel, Lushnje, “Mine Peza”, “Jordan Misja”, QSB Tiranë, Rrogozhinë, “Ali Demi” i mbyllur, se nuk disponojnë ambiente të përshtatshme për arsimimin dhe aftësimin profesional me laboratorë, ambiente apo pajisje

⁵⁸ Ligji Nr. 81/2020, “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”, i ndryshuar, neni 15, paragrafi 5.

mësimdhenie si mekanike, elektrike, etj. Në këto institucione nuk ka kushte të mirëfillta për aftësim profesional dhe nuk ka bashkëpunim efikas me AKPA-n. Kushtet që na u prezantuan nuk ishin të mira dhe nuk plotësonin kushtet për një trajtim dinjitoz dhe të zhvillohet një aftësim profesional me efikasitet, duke stepur dhe interesin e të dënuarve. Po kështu dhe aktivitetet sportive janë në kushte të kufizuara e nuk ka kushte për zhvillimin e aktiviteteve kulturore.

1. Konkluzion:

Të dhënat mbi përqindjen e lartë të të paraburgosurve, në raport me popullsinë penitenciare, përbëjnë shqetësim për faktin se kjo kategori, nga njëra anë, i nënshtrohet rregjimit të burgimit pa një dënim përfundimtar, sikurse dhe nga ana tjetër, prania e kësaj kategorie në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të vendit tonë, trysnon kapacitetet akomoduese të disa prej tyre, duke krijuar mbipopullim. Vetë mbipopullimi cënon dhe pamundëson perspektivën e një qëndrimi dhe trajtimi me dinjitet dhe humanizëm të vetë të burgosurve, në sistemin tonë penitenciar. Ituata e konstatuar e mbipopullimit në I EVP – të e lartpërmendura, pamundëson kushtet e një jetese dinjitoze dhe njerëzore, në përputhje me standardet bashkëkohore evropiane. Mungesa e hartimit të një ligji të vetëm, mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe me masa në komunitet, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit, nuk i përgjigjet nevojës, për një menaxhim më të mirë, si në aspektin e kostove dhe të trajtimit të unifikuar të stafit lidhur me karrierën, trajtimin ekonomik, rotacionin, stautsin, mbështetjen logjistike të agjensisë dhe efektivitetin e shfrytëzimit të aseteve në dispozicion. Mbajtja në funksion e burgut të Rrogozhinës, është në shkelje të kriterëve infrastrukturore, të cilat cenojnë kushtet për një trajtim me dinjitet e humanizëm të të burgosurve, duke kompromentuar shanset e restaurimit moralo - etik te tyre, në funksion të objektivit të rehabilitimit. Mungesa e rikonstruksionit të godinave të shpallura të pabanueshme nr. 1, 2 dhe 3 në Institucionin Mjeksor të Posaçëm /Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale - Lezhë, pamundëson kushtet e një jetese dinjitoze dhe njerëzore, të personave me masë mjeksore, në përputhje me standardet bashkëkohore evropiane.

2. Konkluzioni: DPB nuk ka një plan afat shkurtër për ndërhyrje me Meremetime të mëdha për objektet ekzistuese dhe plan afat gjatë për ndërtime objektësh të reja me standarde që në planifikim si me burime nga buxheti, por ka një ndalesë të investimeve nga donatorë të huaj e institucione ndërkombëtare. Po kështu vërehet mungesa e vlerësimit dhe vëmendja e duhur nga Ministria e Drejtësisë, si institucioni përgjegjës në hartimin e PBA-së dhe shpërndarjen e fondeve për shpenzime dhe investime, e që ka sjellur një situatë buxhetore të pa qëndrueshme dhe nuk janë përballuar nevojat e këtyre I EVP-ve për shpenzime e investime në përmirësimin e infrastrukturës së të dënuarve.

3. Konkluzioni: Mungon zbatimi i kërkesave ligjore në plotësimin e dokumentacionit financiar në administrimin dhe përdorimin e materialeve të konsumit dhe me inventar të përkohshëm dhe parregullsi të theksuar në administrimin e medikamenteve dhe dokumentimin e medikamenteve të skaduara, duke krijuar rrezik për trajtimin e të dënuarëve.

4. Konkluzioni: Nuk janë zbatuar kërkesat ligjore për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore në procesin e punësimit të dënuarve dhe pagesave të kryera, dhe nuk janë gjetur rrugët për të shmangur pabarazinë dhe diskriminimin e këtyre personave që i përkasin shtrese shoqërore vulnerabël.

5. Konkluzioni: Ka munguar dokumentimi i plotë i treguesve të shpenzimeve për trajtimin e të dënuarve dhe nuk ka analiza konkrete mbi ecurinë e kostos periodike, sipas zërave të shpenzimeve dhe nuk ka shpenzime të ndara për proceset e rehabilitimit dhe riintegrimin, pra nuk ka gjurmë auditimi dhe menaxhimi i tyre nuk bëhet i mbështetur në analiza ekonomiko financiare e kostot për njësi/burgosur.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë të ndërmarrë të gjitha nismat e nevojshme ligjore dhe të bashkëpunojë me institucionet e tjera, me synim uljen e përqindjes të të paraburgosurve, krahasuar me numrin total të të burgosurve në sistemin penitenciar dhe përdorimin burgimit si masë e fundit.

Brenda vitit 2026

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të përmirësojë situatën e mbipopullimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, duke bërë organizimin dhe shpërndarjen e të burgosurve në mënyrë sa më efikase, drejt burgjeve me kapacitete akomoduese të lira, si dhe të garantojë infrastrukture të përshtatshme për trajtimin e personave me masë mjekësore në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale/Institucionin Mjekësor të Posaçëm Lezhë, duke programuar dhe realizuar ndërhyrjet e nevojshme me investime, për rikonstrukcionin e godinave nr. 1, 2 dhe 3.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë të ndërmarrë të gjitha nismat e nevojshme, në kompetencë të saj, për të nxitur dhe orientuar proceset drejt miratimit të një ligji të vetëm, mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe me masa në komunitet, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit të burgjeve.

Brenda vitit 2026

4.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria Përgjithshme e Burgjeve të shqyrtojnë me prioritet, mundësinë e ndërhyrjeve rehabilituese dhe rikualifikuese të mjediseve të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogzhinë dhe Lushnje dhe nëse këto ndërhyrje do konsiderohen zgjedhja jo e duhur, atëherë të vlerësohet edhe mbyllja e tyre, si zgjidhja e fundit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të marrin masa dhe të ngrejnë grup pune, për rishikimin e Planit të investimeve 2025-2027 mbështetur në vlerësimin e nevojave për Investime kapitale (ndërtim objekte të reja për qëndrimin e të dënuarve) dhe përcaktimin e nevojave për Meremetime të Mëdha për ato objekte që kanë qëndrueshmëri, duke kërkuar që në planin buxhetor 2025-2027 të planifikohen fonde për investime në këto dy zëra, pasi nevojat janë emergjente. Duke pasur në vëmendje gjendjen e IEVP-ve Rrogzhinë, Lushnje, Shënkoll, etj. Po kështu të punohet me objektiva të caktuara në rritjen e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare financuese, kontributin e tyre në ndërtimin e objekteve të reja bashkëkohore dhe të marrë masa për një investim të qëndrueshëm e me cilësi.

Brenda vitit 2026

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të analizojë situatën dhe të ngrejë grup auditimi nga Sektori i Auditimit Brendshëm dhe specialistë të logjistikës apo sektorit financës e mjekësor, me program auditimi të veçantë tematik ose të plotë dhe të riauditojë IEVP Korçë, Shënkoll e Qendra e Burgjeve Tiranë, ku të evidentohen e dokumentohen mangësitë e shkeljet ligjore dhe të nxirret përgjegjësia administrative e ligjore për personat përkatës.

Brenda muajit shkurt 2026

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet përkatëse: Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Inspektoriati i Punës, që janë faktor në këtë çështje, të diskutojnë e konkludojnë në përcaktimin e mënyrës më të drejtë të llogaritjes së kontributit në referim të shpërblimit (pagës). Kjo të realizohet si nga buxheti dhe nga vetë të dënuarit, si përfitues të drejtëpërdrejtë për pagesën e këtyre kontributeve për sigurimet shoqërore, në

zbatim të legjislacionit në fuqi dhe trajtimit të barabartë dhe pa diskriminim të dënuarve, që punojnë në kohën e vuajtjes së dënimit, pasi pas tyre qëndrojnë dhe familjet e tyre me nevojat e tyre.

Brenda muajit qershor 2026

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me strukturat drejtuese të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, të hartojnë një model kostoje specifik për të dënuar, për personat me masë mjekësore në IEVP Shënkoll (për pacientët e shëndetit mendor) e Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë për të sëmurë me masë mjekësore dhe të përfshijnë në rregulloret e brendshme detyrimin e personelit financiar e menaxherial, për të hartuar regjistra elektronik të shpenzimeve veçmas, sipas llojit e destinacionit, duke kryer ndarjet e nevojshme të tyre për proceset e veçanta. Nëpërmjet hartimit të analizave të kostove periodike, tremujore e progresive, t'u ofrohet drejtuesve të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve mundësia e një menaxhimi apo drejtimi sa më profesional e bashkëkohor, ku gjurma e auditimit do të sjellë dhe njohjen e tyre me përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet e efektivitet, për shërbimet ndaj dënuarve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit.

Brenda muajit qershor 2026

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa dhe të planifikojë me plan të detajuar që prek nevojat e ndryshimit të kushteve të vuajtjes së dënimit për të dënuarit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel, Lushnje, “Mine Peza”, “Jordan Misja”, QSB Tiranë, Rrogzhinë dhe të investohet për ndryshim rrënjësor si në akomodim, por dhe në krijimin e kushteve sa më të mira e të pranueshme për aftësim profesional, edukim dhe aktivitete sportive e kulturore në këto burgje (IEVP Burrel, Lushnje, “Mine Peza”, “Jordan Misja”, QSB Tiranë, Rrogzhinë) që të sigurojnë një trajtim dinjitoz e me kushte sipas standardeve.

Brenda vitit 2026

9.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të ngrejë grup pune i cili të analizojë situatën e të gjitha burgjeve dhe të përcaktojë ndryshimet e nevojshme lidhur me akomodimin, krijimin e kushteve sa më të mira e të pranueshme për aftësim profesional, edukim dhe aktivitete sportive e kulturore të të burgosurve, në të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të vendit.

Brenda vitit 2026

4.2 A sigurojnë programet e rehabilitimit dhe formimit profesional brenda burgut dhe jashtë, përgatitjen e nevojshme të të dënuarve për rikthim aktiv në jetën shoqërore dhe ekonomike?

Rehabilitimi i personave të dënuar me heqje lirie përbën një ndër detyrat themelore të sistemit penitenciar modern. Ai nënkupton procesin përmes të cilit i dënuari mbështetet dhe aftësohet për t'u rikthyer në shoqëri si individ i përgjegjshëm, aktiv dhe i aftë të jetojë në mënyrë të ligjshme. Rehabilitimi nuk është një proces statik, por një proces i vazhdueshëm dhe shumëdimensional që nis në momentin e hyrjes në institucion dhe vijon deri në riintegrimin e individit në komunitet.⁵⁹

Rehabilitimi përbën një komponent thelbësor të trajtimit penitenciar dhe është qëllimi kryesor i sistemit. Kuadri ligjor në vendin tonë kërkon që trajtimi të fokusohet në rikuperimin social të personit, në rindërtimin e aftësive dhe sjelljeve që i mundësojnë atij funksionimin e qëndrueshëm në familje, në tregun e punës dhe në jetën komunitare. Ky proces mbështetet në

⁵⁹ Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 12, neni 14, neni 16, neni 45

vlerësimin individual të të dënuarit, hartimin e një plani trajtimi të personalizuar dhe zbatimin e programeve arsimore, profesionale, terapeutike dhe psikosociale, të cilat synojnë adresimin e faktorëve që kanë ndikuar në sjelljen kriminale.

Edhe standardet ndërkombëtare theksojnë se dënimi me burgim, duhet të orientohet drejt transformimit pozitiv, e jo vetëm izolimit fizik. Rregullat Mandela theksojnë se rehabilitimi duhet të synojë zhvillimin e potencialit të individit për një jetë produktive pas lirimit.⁶⁰ Po ashtu, Rregullat Evropiane të Burgjeve kërkojnë që institucionet të sigurojnë programe arsimimi, formimi profesional, punësimi, aktivitete kulturore e sociale, si edhe ndërhyrje të strukturuar për menaxhimin e riskut dhe përgatitjen për lirim.⁶¹

Vitet e fundit, në vendin tonë janë ndërmarrë disa nisma për të strukturuar dhe forcuar qasjen rehabilituese në sistemin penitenciar. Gjatë vitit 2024 u hartua Udhërrëfyese për rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve⁶², i cili synon unifikimin e qasjes psiko-sociale dhe standardizimin e dokumentimit të punës rehabilituese. Po ashtu, u përgatit Master Plani i Zhvillimit të Sistemit të Burgjeve 2024–2030⁶³, ku rehabilitimi përfshihet si komponent i rëndësishëm. Në të njëjtën periudhë u nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me AKPA-n⁶⁴, Ministrinë e Arsimit⁶⁵ dhe një sërë bashkish, me qëllim forcimin e arsimit, formimit profesional dhe mbështetjes së procesit të riintegrimit. Megjithëse këto nisma përfaqësojnë hapa pozitivë, procesi i rehabilitimit vijon të përballet me sfida të konsiderueshme në zbatim.

Programet e rehabilitimit nuk janë të individualizuara në bazë të nevojave të secilit të burgosur.

Trajtimi i të burgosurit synon rehabilitimin për riintegrimin e tij në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirimit nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale.⁶⁶ Kuadri ligjor shqiptar përcakton qartë se trajtimi i të burgosurve duhet të kryhet në përputhje me gjendjen dhe nevojat individuale të tyre. Individualizimi i trajtimit mbështetet në vlerësimin e nevojave psikologjike, shoqërore, gjinore, të moshës, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i burgosuri, faktorët e riskut dhe motivimin për t'u përfshirë në veprimtaritë që organizohen në institucion. Vlerësimi bëhet në fillim të trajtimit dhe rezultatet e tij verifikohen vazhdimisht gjatë ekzekutimit të dënimit, duke e përshtatur trajtimin sipas nevojave të të burgosurit.⁶⁷

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga përgjigjet e dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se nuk ekziston një plan trajtimi individual për secilin të burgosur i ndërtuar mbi një vlerësim të plotë të nevojave të tij. Institucionet ofrojnë programe standardizuara, të njëjta për të gjithë, të cilat nuk reflektojnë dallimet e thella në historikun, riskun dhe nevojat specifike të të burgosurve.

Shkaku kryesor i kësaj situatë lidhet me kapacitetet e kufizuara njerëzore dhe organizative. Mungesa e stafit psiko-social dhe mungesa e procedurave të detajuara për vlerësimin dhe rishikimin periodik të nevojave, kanë krijuar një boshllëk në ndërtimin e qasjes së individualizuar të trajtimit. Këto kufizime e bëjnë të pamundur që sistemi të vlerësojë në

⁶⁰ The United Nations Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners (the Nelson Mandela Rules), Rules 4, 89–108. https://www.un.org/en/events/mandeladay/mandela_rules.shtml

⁶¹ Council of Europe, Recommendation Rec(2006)2 of the Committee of Ministers to member states on the European Prison Rules, <https://www.refworld.org/legal/resolution/coeministers/2006/en/11978>

⁶² Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1687 datë 27.09.2024 “Për miratimin e udhërrëfyesit për rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve

⁶³ Miratuar me urdhër nr.441, datë 16.09.2024.

⁶⁴ Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet DPB – AKPA nënshkruar me 23 Tetor 2024

⁶⁵ Marrëveshje mbi procesin arsimor Nr. 3414/1 prot, datë 18.06.2024, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve;

⁶⁶ Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 12 pika 1

⁶⁷ Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 13

mënyrë të thelluar historikun personal, problemet emocionale, varësitë, nivelin e riskut apo faktorët socialë që ndikojnë në sjelljen kriminale të çdo të dënuari.

Si pasojë, trajtimi ofrohet në mënyrë uniforme, pa përshtatje ndaj nevojave reale dhe pa prioritarizim të ndërhyrjeve. Të burgosurit vijnë nga profile të ndryshme, shpesh me çrregullime emocionale, trauma të mëparshme, probleme të shëndetit mendor, varësi nga substancat, mungesë aftësish sociale apo përvoja të dhunshme. Burgimi, si një proces që rëndon gjendjen psiko-emocionale, kërkon ndërhyrje të personalizuar, por mungesa e vlerësimit individual i lë këto problematika të paidentifikuara dhe të paadresuara. Mungesa e individualizimit kufizon ndikimin korrigjues të trajtimit dhe ul aftësinë e sistemit për të përgatitur të dënuarit për një riintegrim të qëndrueshëm pas lirim.

Mungojnë mekanizmat e monitorimit, vlerësimit të cilësisë dhe efektivitetit të programeve rehabilituese.

Vlerësimi, programimi dhe realizimi i trajtimit duhet të bëhen nga personeli i institucionit në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse.⁶⁸ Kuadri ligjor kërkon që programet e trajtimit dhe rehabilitimit të monitorohen dhe vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar që ato të ndikojnë realisht në sjelljen dhe zhvillimin e të burgosurve. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të administruar nga DPB, konstatohet se sistemi penitenciar nuk disponon një proces të formalizuar për vlerësimin e cilësisë dhe efektivitetit të programeve rehabilituese. Nuk janë të përcaktuar tregues rezultatsh, nuk kryhen monitorime të rregullta dhe mungojnë analiza periodike që të matin ndikimin e ndërhyrjeve të dënuarit.

Gjithashtu, nuk ekziston një mekanizëm i standardizuar për vlerësimin e cilësisë së punës së profesionistëve që ofrojnë shërbimet rehabilituese, duke e bërë të vështirë garantimin e ofrimit profesional të shërbimeve.

Një problematikë tjetër lidhet me mungesën e programeve të strukturuar dhe të vazhdueshme të trajnimit për stafin psiko-social, veçanërisht në fusha që kërkojnë ekspertizë të specializuar dhe njohuri të thelluara profesionale. Rregullat Nelson Mandela përcaktojnë se administrata e burgjeve duhet të sigurojë zhvillimin e vazhdueshëm të kurseve të trajnimit në detyrë, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e njohurive dhe kapaciteteve profesionale të personelit, pas fillimit të punës dhe gjatë gjithë karrierës së tyre.⁶⁹

Në mungesë të këtyre instrumenteve, institucionet nuk mund të identifikojnë se cilat programe funksionojnë, cilat kërkojnë përmirësim dhe cilat nuk kontribuojnë në arritjen e objektivave të rehabilitimit dhe kjo situatë pengon ndërtimin e programeve të qëndrueshme dhe efektive.

Tabela nr. 11 Incidentet në I EVP për periudhën 2022-2024

IEVP	Dhunë fizike ndërmjet të dënuarve	Dhunë fizike dhe kundërshtim ndaj stafit	Refuzim ushqimi	Vetëvrasje	Tentativa vetëvrasjeje	Vetë - dëmtime	Total incidente	Total të burgosur	% incidenteve
2022	378	302	31	2	43	19	775	5482	14%
2023	301	267	25	2	10	22	627	5689	11%
2024	407	260	15	1	7	19	709	5224	14%

Burimi: DPB,

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur incidentet e ndodhura në I EVP për periudhën 2022-2024. Incidentet që lidhen me sjellje problematike janë prezente në forma të ndryshme dhe në disa raste paraqesin tendencë rritëse, veçanërisht rastet e dhunës ndërmjet të dënuarve në vitin 2024. Analiza tregon se rreth 14% e të burgosurve janë përfshirë në incidente në vitet 2022 dhe

⁶⁸ Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 14 pika 5

⁶⁹ The United Nations Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners (the Nelson Mandela Rules), Rules 75. https://www.un.org/en/events/mandeladay/mandela_rules.shtml

2024. Ky nivel i lartë i tensioneve dhe episodeve problematike, tregon se programet aktuale të trajtimit nuk kanë arritur të ndikojnë në mënyrë të mjaftueshme në uljen e sjelljeve të rrezikshme, forcimin e aftësive sociale apo përmirësimin e stabilitetit emocional.

Pa një sistem të strukturuar monitorimi dhe vlerësimi, nuk mund të krijohet një panoramë e plotë mbi efektivitetin e programeve rehabilituese. Kjo situatë kufizon mundësinë e sistemit penitenciar për të ndërhyrë në kohë, për të orientuar programet drejt nevojave reale dhe për të siguruar që rehabilitimi të kontribuojë realisht në uljen e recidivizmit dhe përgatitjen e të dënuarve për rikthim të qëndrueshëm në komunitet.

Mungojnë ambientet funksionale për trajtimin dhe formimin profesional në shumicën e I EVP-ve.

Trajtimi i të burgosurit bëhet duke siguruar mjediset dhe mjetet e përshtatshme në përputhje me personalitetin e tij dhe nevojat e veçanta.⁷⁰ Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në varësi të nevojave të trajtimit, sigurohen mjedise, kushte të përshtatshme dhe të nevojshme për zhvillimin e punës, arsimimin parauniversitar dhe profesional, veprimtaritë çlodhëse, kulturore dhe çdo veprimtari tjetër e përbashkët ose individuale.⁷¹

Megjithatë, në disa I EVP mungojnë ambientet e përshtatshme për zhvillimin e trajnimit dhe formimit profesional. Konkretisht në I EVP Tepelenë, Burrel, Lushnje, “Mine Peza”, “Jordan Misja”, Kukës, QSB, Rrogozhinë dhe “Ali Demi”, nuk janë të disponueshme ambiente të dedikuara ose funksionale për zhvillimin e kurseve profesionale dhe veprimtarive praktike të aftësimit. Këto institucione, të ndërtuara dekada më parë, karakterizohen nga kufizime hapësinore dhe një konceptim i vjetër i arkitekturës së burgjeve, ku fokusi historik ka qenë në izolimin e të dënuarve dhe jo në riintegrimin e tyre shoqëror.

Mungesa e infrastrukturës së nevojshme kufizon aftësinë e sistemit penitenciar për të ofruar programe cilësore arsimimi dhe formimi profesional. Për shkak të mungesës së ambienteve të dedikuara dhe bazës materiale të përshtatshme, një pjesë e kurseve zhvillohen vetëm në nivel teorik ose me komponent praktik të reduktuar. Në këto kushte, programet nuk arrijnë t’u ofrojnë të dënuarve aftësitë praktike që kërkon tregu i punës, duke ndikuar në uljen e interesit të tyre për t’u përfshirë.

Përveç ndikimit në cilësinë e procesit mësimor dhe aftësimit praktik, infrastruktura përbën edhe një element thelbësor që ndikon drejtpërdrejt në gjendjen psiko–emocionale të të dënuarve. Ambientet funksionale, të sigurta dhe të organizuara në mënyrë të përshtatshme krijojnë kushte më të favorshme për përfshirje aktive, reduktim të tensioneve dhe promovim të sjelljeve pozitive. Hapësirat e kufizuara, të amortizuara ose të papërshtatshme kontribuojnë në rritjen e stresit, pasigurisë dhe izolimit emocional.

Megjithëse në disa I EVP janë ndërmarrë ndërhyrje infrastrukturore - përfshirë krijimin e punishteve në Fier, Korçë dhe Reç në bashkëpunim me Ambasadën Britanike, si edhe dhënien e pajisjeve didaktike nga Këshilli i Evropës për kurset e instalimeve elektrike, këto përmirësime mbeten të kufizuara në një numër të vogël institucionesh. Disa I EVP kanë krijuar kabinete teoriko–praktike (Reç, Korçë, Fier, Peqin, si dhe IM Kavajë dhe I EVP Pojskë), por pjesa më e madhe e institucioneve vijon të mos disponojë ambiente të dedikuara për formimin profesional. Si rezultat, zhvillimi praktik i programeve është i kufizuar dhe kjo reduktton ndjeshëm efektivitetin e tyre si instrument rehabilitimi dhe aftësimi për tregun e punës.

Të dënuarit kanë akses të kufizuar dhe të pabarabartë në arsimin bazë.

Kushdo ka të drejtën për arsimim.⁷² Arsimi i detyrueshëm përcaktohet me ligj. Të burgosurit që nuk kanë përfunduar arsimin nëntëvjeçar i krijojnë kushte për përfundimin e tij me anë të një programi të veçantë, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.⁷³ Kjo e drejtë

⁷⁰ Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 40 pika 3

⁷¹ Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 47 pika 1

⁷² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 57, pika 1

⁷³ Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 45 pika 2

konsiderohet një element thelbësor i trajtimit të të burgosurve, pasi arsimi ndikon drejtpërdrejt në aftësitë dhe mundësitë e riintegrit të personit pas lirimit.

Megjithatë, analiza e zhvillimit të procesit mësimor gjatë viteve tregon se kjo e drejtë nuk garantohet në mënyrë të barabartë në të gjitha IEVP-të. Në vitin shkollor 2021–2022 procesi arsimor është zhvilluar në vetëm 8 institucione, në vitin 2022–2023 në 11 institucione, ndërsa në vitin 2023–2024 në 10 institucione.⁷⁴ Si rrjedhojë, rreth gjysma e IEVP-ve nuk kanë ofruar programe arsimore, duke kufizuar aksesin e të dënuarve në arsimin bazë.

Tabela nr. 11.1: Ndjekja e arsimit nga të burgosurit sipas muajve gjatë viteve 2022 - 2024

Muaji Viti akademik	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2021-2022	143	205	164	139	135	185	159	138	143	128
2022-2023	158	170	167	188	180	178	175	174	170	145
2023-2024	155	181	182	175	177	167	171	152	146	134

Burimi: DPB,

Përpunoi: Grupi i auditimit

Të dhënat e ndjekjes së arsimit për periudhën 2022–2024 tregojnë se pjesëmarrja e të burgosurve në procesin arsimor mbetet shumë e ulët, rreth **3–4%** e popullsisë së përgjithshme të burgosur. Gjithashtu vërehen luhatje të konsiderueshme nga muaji në muaj, duke treguar se pjesëmarrja nuk është e qëndrueshme dhe se procesi ende nuk ka arritur të krijojë një ritëm të rregullt arsimimi.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk disponon raporte monitorimi të cilësisë së mësimdhënies në IEVP, duke e bërë të pamundur vlerësimin e efektivitetit të programeve arsimore të ofruara. Në mungesë të mekanizmave të monitorimit, nuk ka informacion mbi mënyrën se si zhvillohet mësimdhënia, cilësinë e saj, rezultatet e të burgosurve apo problematikat që ndeshen në praktikë.

Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur nga DPB, rezulton se zhvillimi i procesit arsimor pengohet nga disa faktorë të përsëritur: mungesa e bashkëpunimit në disa raste me autoritetet arsimore vendore; interesi i ulët i të burgosurve për ndjekjen e arsimit, i ndikuar nga specifikat infrastrukturore të institucioneve dhe niveli i mbipopullimit; mungesa e ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e mësimin në disa IEVP; ndërprerja e procesit arsimor për shkak të transferimit të të burgosurve; si edhe mosnjsja e procesit nga fillimi i vitit shkollor.

Si rrjedhojë, një numër i konsiderueshëm i të burgosurve mbeten të përjashtuar nga një e drejtë bazë dhe nga një mundësi thelbësore rehabilitimi. Mospërfshirja në procesin arsimor kufizon zhvillimin e aftësive të dobishme për riintegrim, dobëson efektivitetin e trajtimit penitenciar dhe e bën më të vështirë kalimin drejt jetës së pavarur pas lirimit.

Formimi profesional në burgje është i kufizuar, i fragmentar dhe larg nevojave reale të të dënuarve.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në përputhje me detyrimet e tyre ligjore, synojnë nxitjen e përfitimit dhe certifikimit të kualifikimeve profesionale përmes ofrimit të kurseve të formimit profesional me kohë të pjesshme.⁷⁵ Ky proces përbën një komponent thelbësor të trajtimit rehabilitues, pasi formimi

⁷⁴ Në vitin shkollor 2021–2022 është zhvilluar procesi mësimor në 8 IEVP: në IEVP Lezhë, Kavajë, Rogozhinë, Peqin, Korçë, Vlorë, “Jordan Misja” dhe Fier.

Në vitin shkollor 2022–2023 është zhvilluar procesi arsimor në 11 IEVP: në IEVP Vlorë, Lezhë, Korçë, Rogozhinë, Kavajë, Fushë-Krujë, Peqin, Jordan Misja, Mine Peza, Ali Demi dhe Fier;

Në vitin shkollor 2023–2024 është zhvilluar procesi arsimor në 10 IEVP: në IEVP Vlorë, Lezhë, Korçë, Rogozhinë, Kavajë, Peqin, Jordan Misja, Mine Peza, Ali Demi dhe Fier.

⁷⁵ Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 40 pika 3

profesional kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e aftësive të punës, rritjen e mundësive të punësimit pas lirimimit dhe zvogëlimin e rrezikut të rikthimit në vepër penale, duke ndikuar kështu në riintegrimin e qëndrueshëm të të dënuarve në shoqëri.

Megjithatë, të dhënat për periudhën 2022–2024 tregojnë se aksesimi i këtyre programeve është i ulët dhe jo proporcional me nevojat dhe interesin e të burgosurve.

Tabela nr. 11.2: Numri i të burgosurve që ndjekin formimin profesional dhe numri i I EVP që ofrojnë formim profesional

IEVP	Total të burgosur	Të burgosur që ndjekin formim profesional	% e të burgosurve që ndjekin formim profesional	Total I EVP	IEVP ku ofrohet formim profesional	IEVP ku nuk ofrohet formim profesional
2022	5482	198	3.6%	20	6	14
2023	5689	240	4%	20	6	14
2024	5224	161	3%	22	10	12

Burimi: DPB, të dhënat përpunuar nga grupi i auditimit

Gjatë vitit 2022 formimi profesional është zhvilluar në 6 I EVP (nga 20 I EVP) dhe është ndjekur mesatarisht nga 198 të burgosur në muaj; në vitin 2023 po në 6 I EVP me një mesatare pjesëmarrjeje prej 240 personash; ndërsa në vitin 2024, ndonëse procesi u shtri në 10 I EVP, numri mesatar i pjesëmarrësve ra në 161 persona. Nga kjo rezulton se vetëm 3-4% e të burgosurve ndjekin programe të formimit profesional.

Të dhënat tregojnë një mospërputhje të ndjeshme midis kërkesës dhe ofertës. Sipas DPB, nga një proces vlerësimi i kryer në muajin shtator 2024 në popullatën e të burgosurve, 27% e të burgosurve kanë shfaqur interes për ndjekjen e të paktën një kursi profesional.⁷⁶ Kjo nënkupton që rreth 1500 të burgosur kanë shfaqur interes, ndërsa vetëm 161 prej tyre patën mundësi reale për t'u përfshirë, kjo për shkak të mos gjetjes së specialistëve nga AKPA dhe vetë DPB.

Gjithashtu, është konstatuar se nuk është regjistruar asnjë rast pjesëmarrjeje në kurse jashtë I EVP-ve, edhe pse kjo parashihet në kuadër të mundësive të formimit profesional. Në shumë vende europiane, veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar, Portugali, Spanjë dhe vendet nordike, të burgosurit me risk të ulët dhe mesatar marrin pjesë rregullisht në kurse profesionale jashtë burgut si pjesë e programeve të përgatitjes për lirimim dhe riintegrimin. Këto programe realizohen në bashkëpunim me qendrat publike të formimit profesional, kolegjet komunitare dhe punëdhënësit lokalë, duke ofruar kualifikime të njohura dhe mundësi reale punësimi pas lirimimit. Mungesa totale e këtyre praktikave në Shqipëri tregon një boshllëk të rëndësishëm në qasjen rehabilituese dhe kufizon aftësinë e sistemit për të ndërtuar aftësi të transferueshme në tregun e punës.

Numri i ulët i ndjekjes së këtyre programeve nuk lidhet me mungesën e kërkesës, por me pengesa strukturore që komprometojnë funksionimin efektiv të programeve. Vonesat në sigurimin e dokumentacionit arsimor të të dënuarve (kriter i detyrueshëm për regjistrim), mungesa e infrastrukturës së përshtatshme në disa I EVP dhe vështirësitë për krijimin e grupeve të qëndrueshme për shkak të lëvizshmërisë së të paraburgosurve, përbëjnë faktorët kryesorë që pengojnë zhvillimin normal të procesit të aftësimit profesional brenda burgjeve. Një problematikë tjetër është dhe numri i pjesëmarrësve për hapjen e një kursi specifik, ku numri për fillimin e një kursi është minimumi 7 pjesëmarrës dhe maximumi 15 pjesëmarrës, ku mosha e lejuar është 16 vjeç, kjo sjell vështirësi në plotësimin e grupit. Gjithashtu, mungesa e një buxheti të dedikuar për formimin profesional të të burgosurve ka bërë që ky proces të zhvillohet vetëm në nivel teorik dhe kjo ka sjellë për pasojë mungesë interesi për frekuentim nga të burgosurit. Këto kufizime strukturore bëjnë që formimi profesional të mbetet i fragmentuar, me shtrirje të kufizuara gjeografike dhe me përmbajtje kryesisht teorike, duke reduktuar

⁷⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 45, pika 5

⁷⁶ Kurset e ofruara përfshijnë gjuhë e huaj (anglisht, italisht), pikturë, pirografi, elektrikist, hidraulik, turizëm, kuzhinë, berber, rrobaqepësi, punë me dru dhe saldaturë.

ndjeshëm kontributin e tij në përgatitjen profesionale të të dënuarve për tregun e punës pas lirimit.

Punësimi i të burgosurve është i kufizuar dhe nuk përmbush funksionin rehabilitues.

Ligji parashikon se i burgosuri i aftë për punë ka të drejtë të kryejë një punë të denjë, të zgjedhur prej tij, e cila shpërblehet dhe i njihet në vjetërsi për efekt pensioni. Puna duhet të shërbejë për fitimin, ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive profesionale me synim riintegrimin në shoqëri pas dënimit. Gjithashtu, përshkrimi i punës duhet të jetë në përputhje me gjendjen shëndetësore, njohuritë dhe aftësitë, si edhe me perspektivën e riintegritit.⁷⁷

Nga analiza e të dhënave për periudhën 2022–2024, rezulton se punësimi mbetet një proces i kufizuar, i orientuar kryesisht drejt funksioneve ndihmëse të brendshme të institucioneve, pa përmbushur plotësisht funksionin rehabilitues dhe ekonomik që synon kuadri rregullator.

- Në vitin 2022 u punësuan 388 të burgosur
- Në vitin 2023 u punësuan 334 të burgosur
- Në vitin 2024 u punësuan 356 të burgosur

Këto të dhëna tregojnë se, në rang sistemi, vetëm 6–7% e të burgosurve janë të punësuar, pavarësisht se objektivat rregullatorë synojnë krijimin e mundësive të gjera dhe përfshirëse. Në praktikën ndërkombëtare, niveli i punësimit në burgje varion zakonisht **nga 20% deri në rreth 50%** të popullsisë së burgosur, në varësi të vendit dhe mënyrës së matjes. Sipas të dhënave të Prison Insider, në Belgjikë janë të përfshirë në punësim rreth 30% e të dënuarve;⁷⁸ në Poloni janë të përfshirë në punësim rreth 48% e të dënuarve;⁷⁹ në Francë janë të përfshirë në punësim rreth 28% e të dënuarve;⁸⁰. Nuk kemi një objektiv, pasi mundësitë e punësimit të burgosurve për punësim janë të kufizuara, kjo për shkak të mos aplikimit të punësimit me bashkëpunim me subjekte private.

Gjithashtu, bashkëpunimi me sektorin privat rezulton minimal dhe jo i qëndrueshëm. Sipas DPB, edhe pse gjatë vitit 2024 janë nënshkruar marrëveshje me dy operatorë ekonomikë privatë, të dy operatorët janë tërhequr që në hapat e parë, për shkak të risqeve operacionale, proceduralisht të larta dhe të kostove financiare që vlerësonin se mund t'u krijonte punësimi në ambiente të sigurisë së lartë. Në vitin 2023 nuk është miratuar asnjë marrëveshje e re për punësim në IEVP të tilla si Rrogozhinë, Shkodër, Fier etj., për shkak të mungesës së interesit të operatorëve privatë dhe vështirësive që lidhen me procedurat e sigurisë dhe hyrje–daljet në institucionet e burgjeve.

Mungojnë programe punësimi që sigurojnë certifikim profesional, përvojë praktike të njohur jashtë institucionit, apo mundësi reale për lidhje me punëdhënësit pas lirimit. Kjo situatë kufizon funksionin rehabilitues të punësimit, ul nivelin e përgatitjes ekonomike të të dënuarve dhe rrit rrezikun e rikthimit në kriminalitet, duke qenë se punësimi është një nga faktorët kryesorë që ndikojnë në stabilitetin ekonomik dhe social të të dënuarve pas lirimit.

Përgatitja e të burgosurve që janë në prag-lirimi është e fragmentuar dhe pa rezultate të qëndrueshme.

Institucionet e ekzekutimeve të vendimeve penale në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat jofitimprurëse hartojnë programe rehabilitimi dhe programe riintegrimi praglirimi për adresimin e nevojave të posaçme të secilit të burgosur.⁸¹ Për të mbështetur procesin e riintegritit të të liruuarit në rastet kur rezulton se ai do të përballen me vështirësi pas daljes nga

⁷⁷ Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 43

⁷⁸ <https://www.prison-insider.com/en/countryprofile/belgique-2023?s=vie-quotidienne#travail>

⁷⁹ <https://www.prison-insider.com/en/countryprofile/pologne-2025?s=vie-quotidienne#travail>

⁸⁰ <https://www.prison-insider.com/en/countryprofile/france-2025?s=vie-quotidienne#travail>

⁸¹ Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 12 pika 3

institucioni, njoftohet njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore e vendbanimit të tij për të mundësuar asistencë të mëtejshme.⁸²

Edhe pse kuadri ligjor parashikon hartimin e programeve individuale prag-lirimi dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për mbështetjen e të dënuarve pas daljes nga institucioni, praktika tregon se ky proces nuk funksionon në mënyrë efektive. Sipas të dhënave të administruara nga DPB, gjatë viteve 2022 dhe 2023 janë kryer referime pranë njësive të vetëqeverisjes vendore dhe strukturave përgjegjëse, por asnjë prej këtyre rasteve nuk ka rezultuar i suksesshëm në aspektin e marrjes së shërbimeve apo mbështetjes së nevojshme. Në vitin 2024 janë referuar 115 të dënuar dhe, sipas DPB, vetëm 10 prej tyre janë mbështetur me sukses përmes shërbimeve sociale ose ndërhyrjeve të tjera të nevojshme. Në këtë vit është miratuar edhe regjistri zyrtar i referimeve, duke krijuar një mekanizëm dokumentues dhe gjurmues të procesit.

Pavarësisht rezultateve në 2024, rezultatet e përgjithshme mbeten shumë të ulëta. Mungesa e planeve të personalizuar prag-lirimi, mungesa e koordinimit efektiv ndërinstitucional dhe kapacitetet e kufizuara të njësive vendore bëjnë që shumica e të dënuarve të lirohen pa një plan të strukturuar për strehimin, punësimin apo mbështetjen psiko-sociale. Kjo situatë e cenon vazhdimësinë e procesit rehabilitues dhe rrit gjasën e rikthimit në sjellje kriminale.

10. Gjetje nga auditimi: Sektorët psiko-social në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, nuk hartojnë vlerësime të plota individuale dhe nuk disponojnë plane trajtimi të personalizuar për çdo të dënuar. Institucionet ofrojnë programe standarde dhe uniforme që nuk reflektojnë dallimet në historikun personal, gjendjen psiko-emocionale, nivelin e riskut apo aftësitë sociale të të burgosurve. Kërkesat e kuadrit ligjor kombëtar dhe standardeve ndërkombëtare parashikojnë se trajtimi duhet të bazohet në vlerësime individuale të nevojave dhe në plane të personalizuar rehabilitimi. Kjo situatë shkaktohet nga mungesa e kapaciteteve profesionale dhe numrit të pamjaftueshëm të stafit psiko-social, si dhe mungesa e procedurave të detajuara dhe instrumenteve të standardizuara për vlerësimin dhe rishikimin periodik të nevojave. Si pasojë, trajtimi mbetet i përgjithshëm, pa adresuar problematikat individuale, duke kufizuar efektivitetin e procesit rehabilitues dhe duke rritur gjasat që të dënuarit të mos zhvillojnë aftësitë e nevojshme për riintegrim të suksesshëm pas lirimit.

11. Gjetje nga auditimi: Sistemi penitenciar nuk ka një mekanizëm të strukturuar monitorimi, nuk përdor tregues performance dhe nuk kryen analiza të rregullta të cilësisë së programeve rehabilituese. Kuadri ligjor dhe standardet ndërkombëtare kërkojnë monitorim të vazhdueshëm të programeve për të siguruar cilësi dhe efektivitet. Kjo situatë vjen nga mungesa e një metodologjie të unifikuar, mungesa e kapaciteteve profesionale dhe trajnimeve të vazhdueshme për stafin psiko-social. Si pasojë, institucionet mbikqyrëse si, Avokati Popullit, Këshilli i Europës, Drejtoria përkatëse dhe inspektimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, nuk janë në gjendje të vlerësojnë efektin real të programeve rehabilituese, të identifikojnë mangësitë apo të përmirësojnë ndërhyrjet.

12. Gjetje nga auditimi: Pjesëmarrja e të burgosurve në arsimin bazë mbetet shumë e ulët, vetëm 3–4% e të burgosurve, nga 27% që janë kërkesat. Programet arsimore ofrohen vetëm në një pjesë të IEVP-ve, duke krijuar akses të pabarabartë në këtë shërbim. Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare e njohin arsimin bazë si një të drejtë themelore dhe një element thelbësor të procesit rehabilitues. Kjo situatë shkaktohet nga mungesa e bashkëpunimit të qëndrueshëm me autoritetet arsimore lokale, mungesa e ambienteve të posaçme për zhvillimin e mësimdhënies, mungesë materialesh mësimore, transferimet e shpeshta, mbipopullimi në disa IEVP dhe mungesa e mekanizmave të monitorimit të cilësisë së procesit arsimor. Nga kjo, shumë të dënuar mbeten të përjashtuar nga arsimi bazë, duke humbur një mundësi të

⁸² Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 79 pika 3

rëndësishme rehabilitimi dhe duke pasur aftësi më të kufizuara për riintegrim social dhe ekonomik pas lirimit.

13. Gjetje nga auditimi: Formimi profesional në IEVP është i kufizuar, i fragmentar dhe jo në përputhje me nevojat reale të të dënuarve, pasi vetëm 3–4% e tyre kanë marrë pjesë në kurset profesionale gjatë viteve 2022–2024, ndonëse 27% kanë shprehur interes për t'u përfshirë. Kuadri ligjor e përcakton formimin profesional si detyrim institucional dhe komponent thelbësor të trajtimit rehabilitues, me qëllim pajisjen e të dënuarve me aftësi të nevojshme për riintegrim në tregun e punës pas lirimit. Kjo situatë vjen si rezultat i mungesës së ambienteve të përshtatshme dhe buxhetit të dedikuar, për krijimin e grupeve të qëndrueshme. Si pasojë, programet zhvillohen kryesisht në mënyrë teorike, ofrohen në pak institucione dhe nuk sigurojnë aftësi praktike të transferueshme, duke kufizuar ndjeshëm ndikimin e tyre në përgatitjen e të dënuarve për punësim pas lirimit.

14. Gjetje nga auditimi: Punësimi i të burgosurve është shumë i kufizuar dhe përqendrohet kryesisht në detyra ndihmëse brenda institucioneve, ku vetëm 6–7% e të dënuarve janë të përfshirë në punë gjatë viteve 2022–2024. Ky nivel është ndjeshëm më i ulët se praktikat ndërkombëtare ku punësimi varion nga 20% deri në 50%. Kuadri ligjor kërkon që puna të shërbejë si instrument rehabilitimi dhe të kontribuojë në zhvillimin e aftësive profesionale të të dënuarve, në përgatitjen për punësim pas lirimit dhe në uljen e rrezikut të rikthimit në vepër penale. Megjithatë, kjo kërkesë nuk përmbushet për shkak të mungesës së bashkëpunimit të qëndrueshëm me sektorin privat, barrierave procedurale të sigurisë, mungesës së programeve të strukturuar që ofrojnë certifikim profesional dhe mungesës së mundësive për punësim në aktivitete që lidhen me tregun real të punës. Si pasojë, punësimi aktual nuk e përmbush funksionin rehabilitues, nuk u siguron të dënuarve aftësi të transferueshme pas lirimit dhe rrit rrezikun e rikthimit në kriminalitet, duke dobësuar përgatitjen e tyre ekonomike dhe sociale për jetën në komunitet. Nuk ka asnjë punësim të burgosurve në tregun privat të punës dhe krijimin e mundësive reale për angazhimin e tyre në punë të strukturuar dhe të paguar.

15. Gjetje nga auditimi: Procesi i përgatitjes prag-lirimi është i kufizuar. Edhe pse në vitin 2024 ka filluar të funksionojë një mekanizëm dokumentimi dhe referimi, rezultatet mbeten shumë të ulëta, pasi nga 115 të dënuar të referuar vetëm 10 kanë marrë mbështetjen e nevojshme pas lirimit. Kuadri ligjor kërkon hartimin e planeve individuale prag-lirimi dhe bashkëpunim efektiv ndërmjet IEVP-ve, Shërbimit të Provës dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për të garantuar vazhdimësinë e procesit rehabilitues. Shkaqet kryesore lidhen me mungesën e planeve të personalizuar, koordinimin e pamjaftueshëm ndër-institucional dhe kapacitetet e kufizuara të njësive vendore për të ofruar shërbime mbështetëse. Si pasojë, shumica e të dënuarve lirohen pa ndihmën e nevojshme për strehim, punësim dhe mbështetje psiko-sociale, duke rritur rrezikun e rikthimit në sjellje kriminale dhe dobësuar ndikimin afatgjatë të trajtimit rehabilitues.

10.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të krijojë dhe zbatojë një sistem të unifikuar trajtimi individual, duke hartuar një metodologji standarde për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave, zhvillimin dhe rishikimin periodik të planeve të personalizuar të trajtimit, si dhe duke rritur kapacitetet profesionale të stafit psiko-social përmes shtimit të personelit dhe rishpërndarjes së ngarkesës së punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të krijojë një sistem të standardizuar monitorimi dhe vlerësimi të programeve rehabilituese, që përfshin tregues të matshëm performance, procedura të detajuara për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, mekanizma periodikë raportimi dhe analiza vjetore të rezultateve, me qëllim matjen e efektivitetit dhe identifikimin e ndërhyrjeve.

12.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, të zgjerojë aksesin në arsimin bazë në të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, duke krijuar ambiente të dedikuara mësimore të pajisura me materiale didaktike, duke vendosur një mekanizëm monitorimi të cilësisë së procesit arsimor dhe duke koordinuar transferimet e të burgosurve për të shmangur ndërprerjet e vitit shkollor

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të përcaktojë një buxhet të dedikuar për formimin profesional të të burgosurve, që të mbulojë pajisjet didaktike, materialet praktike, pagesat e instruktorëve dhe në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim, të ofrojë lehtësira në administrimin dhe verifikimin e dokumentacionit arsimor të të dënuarve, duke krijuar procedura standarde që eliminojnë vonesat dhe mundësojnë regjistrimin e tyre në programet e formimit profesional. Gjithashtu, AKPA, të rishikojë kriteret arsimore dhe kërkesën për numër minimal pjesëmarrësish për hapjen e një kursi, me qëllim zgjerimin e aksesit dhe rritjen e pjesëmarrjes së të burgosurve në programet e aftësimin profesional.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.2 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, të vendosë një mekanizëm motivues për rritjen e pjesëmarrjes së të dënuarve në formimin profesional, përmes skemave të tilla si kompensime simbolike financiare, bonuse për performancë apo përfitime administrative, me qëllim nxitjen e angazhimit të tyre gjatë ndjekjes së programeve të aftësimin.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.3 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të forcojë bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim dhe me qendrat publike e private të formimit profesional, me qëllim diversifikimin e kurseve të çertifikuara dhe të njohura nga tregu i punës, si dhe të mundësojë pjesëmarrjen e të dënuarve me risk të ulët në kurse profesionale jashtë burgut, në linjë me modelet evropiane të integritit gradual dhe përgatitjes për punësim pas lirim.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, së bashku me institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe partnerët e tjerë përgjegjës, të hartojë një program kombëtar për punësimin e të dënuarve, i cili të synojë rritjen e nivelit të punësimin dhe përfshirjen më të gjerë të të burgosurve, duke u orientuar drejt profesioneve më të kërkuara në treg, si: prodhim, riparime, shërbime teknike, bujqësi, përpunim dhe aktivitete të tjera, që krijojnë mundësi reale punësimi pas lirim.

Brenda muajit prill 2026

14.2 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me operatorë ekonomikë privatë, me qëllim rritjen e përfshirjes së të burgosurve në tregun privat të punës dhe krijimin e mundësive reale për angazhimin e tyre në punë të strukturuar dhe të paguar. Për të nxitur përfshirjen e bizneseve, të rishikohen procedurat e sigurisë për hyrje–daljet në institucionet e vuajtjes së dënimit, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve në procesin e punësimin, si edhe të ofrohen paketa incentivash, përfshirë lehtësime procedurale, mbështetje logjistike dhe ulje kostosh konform legjislacionit të punës.

Brenda vitit 2026

14.3 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim dhe institucionet e formimit profesional publik dhe privat, të krijojë programe punësimi që përfundojnë me certifikim profesional të njohur zyrtarisht, duke garantuar që aftësitë e fituara gjatë punës në burg të jenë të transferueshme dhe të vlefshme për punësim pas lirim.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të forcojë dhe operacionalizojë plotësisht mekanizmin ekzistues të përgatitjes prag-lirimi, duke siguruar hartimin e detyrueshëm të planeve individuale për çdo të dënuar, përmirësimin e koordinimit ndër-institucional dhe rritjen e kapaciteteve të njërive vendore për ofrimin e shërbimeve të domosdoshme (strehim, punësim, mbështetje psiko-sociale), në mënyrë që procesi të bëhet funksional, efektiv dhe të garantojë vazhdimësinë e rehabilitimit pas lirim.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.3 A ofrohen mekanizma dhe mbështetje e vazhdueshme për ish-të dënuarit pas lirim, për të lehtësuar rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri?

Në vlerësimin e mekanizmave për mbështetje të vazhdueshme në lehtësimin e rehabilitimit dhe riintegrimin të dënuarve pas lirim në shoqëri, konstatohet se është orientuar në ato mekanizma që mundësojnë funksionimin e një procesi që i shërben rehabilitimit psiko-emocional, moral dhe shpirtëror të të burgosurve, njëkohësisht riintegrimin të tyre. Nëpërmjet këtij procesi synohet që çdo të burgosuri t'i sigurohen njohuri, aftësi, burime dhe mundësi për të qenë anëtarë të suksesshëm dhe produktivë të komunitetit, pas lirim nga institucionet penitenciare. Kjo duhet të arrihet përmes një pune të programuar ku të përfshihet vlerësimi, planifikimi dhe menaxhimi i integruar të gjitha problematikave që kontribuojnë në rritjen e efektivitetit dhe eficientës së rehabilitimit dhe riintegrimin të dënuarve dhe recidivizmit (mos rikthimit në krim e burg). Përgatitja e një plani individual me bazë vlerësimi rrisht për fuqizimin e komponentit të riintegrimin nëpërmjet prag lirim, lirim me kusht dhe aktivizimi i mekanizmave të tjerë të zinxhirit përgjegjës, është kryer nga puna e bërë gjatë vuajtjes dënimit. Pozitiv ka qenë dhe bashkëpunimi me DP të Shërbimit Provës (për të ish-dënuar të liruar me kusht), si një mekanizëm i ndjeshëm dhe me impakt të lartë social si për të dënuarin por dhe për familjen e shoqërinë. Zhvillimi i takimeve dhe nënshkrimi marrëveshjeve të përbashkëta me pushtetin vendor (bashkitë, institucionet rajonale (DR Zyra Punësimi, DR Shërbimi Social, DRAP, etj., ku janë IEVP-të dhe ku kanë banim më shumë ish të dënuar, agjenci të tjera ligjzbatuese dhe organizata të shoqërisë civile, kanë sjellur zhvillimin e një qasje multidisiplinare në të mirë të kësaj shtrese vulnerabël. Rehabilitimi me efektivitet është i lidhur ngushtësisht me riintegrimin (R&R), pasi të burgosurit ndeshen me pengesa e barriera si ligjore, ashtu edhe informale për t'u bërë qytetarë produktivë në punë, të përgjegjshëm në familje dhe aktivë në komunitet. Problem kryesor i të dënuarve pas daljes nga burg është strehimi i tyre, pasi një pjesë e tyre braktisen nga familjarët për arsye të ndryshme. Dinamikat e grupit shoqëror ku i dënuari bën pjesë, përdorimi apo abuzimi me drogën dhe alkoolin, rrethanat financiare, mangësitë burokratike si dhe përgjigjet problematike ndaj tragjedive individuale, duhet të trajtohen individualisht dhe në kontekstin e rrezikut të kthimit në krim, pra ndryshon trajtimi kur është në burg dhe kur ka dalë në liri (me kusht ose përfunduar dënimin). DPB ka vizion: “*Sistemi penitenciar profesional, Shqipëri më e sigurt*”, ku synimi kryesor është shndërrimi i IEVP-ve në një mjedis i cili inkurajon fuqishëm rehabilitimin dhe përgatitjen e të burgosurve për riintegrim, në jetë pas burg.

Me miratimin e ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve e burgim dhe të paraburgosurve” dhe hyrjen në fuqi të tij, është hartuar paketa e re penitenciare, e cila ka synim mbrojtjen e të drejtave të tyre në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian, duke sjellë risi si :

Krijimin në IEVP-të i funksionimit me *regjim të hapur*, si një mekanizëm me ndikim të madh dhe sistem shumëdisiplinar, që synon rehabilitimin social për riintegrimin e të dënuarve në jetën familjare, sociale dhe ekonomike, nëpërmjet përfshirjes së burgjeve në legjislacionin e posaçëm të sistemit penitenciar. Në këtë mënyrë, kalimi i të dënuarve që përmbushin kriteret ligjore në këto institucione do të shërbejë si një fazë parapërgatitore për çastin e lirit të tyre, pra *përgatitja për riintegrim në burgjet me regjim të hapur lehtëson më pas jetën në liri*.

Ky ligj është hartuar e miratuar si nevojë e përmbushjes së detyrimeve që vijnë nga ndikimi i angazhimeve ndërkombëtare, si rregullat evropiane të burgjeve miratuar nga Komiteti i Ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës,⁸³ dhe rekomandimet e Komitetit Evropian për parandalimin e torturës dhe të trajtimit ose dënimit çnjerëzor dhe poshtërues (KPT).

Nga auditimi i kryer rezulton se megjithëse ligji **për regjim të hapur** është që nga viti 2020, nga Ministria e Drejtësisë dhe DPB akoma nuk është bërë asnjë hap i rëndësishëm që të zbatohet kjo risi e këtij ligji, pasi do të kishte impakt të lartë social e lehtësira financiare dhe ekonomike, duke siguruar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të ofrojnë një trajtim njerëzor të personave me liri të kufizuar, duke garantuar dinjitetin e tyre njerëzor dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi.

Zbatimi i burgut me regjim të hapur është caktuar si objektiv dhe detyrim në Masën 4.4, parashikuar në Masterplanin e miratuar me Urdhër të Ministrisë të Drejtësisë nr. 441, datë 6.9.2024.

Objektivi bazë i çdo sistemi të drejtësisë penale është rehabilitimi i të burgosurve dhe riintegrimi social në shoqëri, kjo e bazuar në Konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ligjërisht të detyrueshme⁸⁴, si dhe standardet dhe normat e Kombeve të Bashkuara në parandalimin e krimit dhe drejtësinë penale, ku theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve për të mbështetur riintegrimin social të të burgosurve si një mjet për parandalimin e krimit të mëtejshëm dhe mbrojtjen e shoqërisë.⁸⁵

Nga DPB është hartuar instrumenti “*Udhërrëfyes lidhur me Rehabilitimin dhe Riintegrimin e të burgosurve*”, i cili është një platformë e hartuar nga Drejtoria e Çështjeve Sociale që udhëheq punën në realizimin e dizenjimit, standartizimit të punës dhe unifikimit të planit individual të trajtimit të të burgosurit në IEVP në funksion të rehabilitim/riintegrimit të të burgosurve. Në këtë instrument janë të integruar një sërë dokumentesh të hartuar nga ekspertë të lartë të Këshillit të Evropës⁸⁶, si dhe zbatimit të metodës “*menaxhimit të rasteve*” dhe Intervistimit motivues, është synuar që çdo të burgosurinëpërmjet një sjellje pro-sociale e personelit t’i sigurohet njohuri, aftësi, burime dhe mundësi për të ndërmarrë procesin e rëndësishëm të rehabilitim / riintegrimit. Kjo do të arrihet nëpërmjet indikatorëve si:

- Ulja e krimit dhe recidivizmit duke vlerësuar ndryshimet individuale gjatë gjithë jetës;
- Alokimi i burimeve sipas strategjive të menaxhimit të risqeve dhe nevojave;
- Vlerësim i vazhdueshëm i instrumentave të vlerësimit të riskut dhe programeve të trajtimit për të përdorur praktikën më të mira.
- Ruajtja dhe funksionimi i një sistemi të pandërprerë bashkëpunimi që përfshin vlerësimin, programimin, planifikimin, dhe menaxhimin e integruar të rasteve.

⁸³ *Konventa Ndërkombëtare hartuar më 12 shkurt 1987, në mbledhjen e 404-rt të zëvendësministrave dhe rekomandimet e Komitetit Evropian për parandalimin e torturës dhe të trajtimit ose dënimit çnjerëzor dhe poshtërues (KPT).*

⁸⁴ *Më konkretisht, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 2200 A (XXI), aneks) thotë se “sistemi penitenciar do të përfshijë trajtimin e të burgosurve, qëllimi thelbësor i të cilit do të jetë reformimi dhe rehabilitimi i tyre social” (neni 10, paragrafi 3).*

⁸⁵ *Shih Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), Përmbledhje e Standardeve dhe Normave të Kombeve të Bashkuara në parandalimin e krimit dhe drejtësinë penale (Nju Jork, 2016).*

⁸⁶ *Hartuar përmes instrumentit “Mbështetje Horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, projekti “Forcimi i të Drejtave të Njeriut të të burgosurve në Shqipëri” me zbatues Zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë, financuar nga BE dhe KiE.*

Sigurimi i rehabilitimit social dhe të riintegritimit në jetën familjare, shoqërore e ekonomike të të paraburgosurve dhe të dënuarve madhorë e të mitur, duke vlerësuar për të miturit format e motivimit nxitës, në përputhje me parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturit, ndihmën sociale, edukative, arsimore, psikologjike dhe fizike, në përputhje me nevojat individuale dhe në përputhje me grupmoshën, gjininë dhe personalitetin e tij.

Në zbatim të detyrimit për marrjen e masave të plotësimin e Masës nr 1.2 lidhur me “Hartimin e një ligji të vetëm mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe me masa në komunitet, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit” të “Masterplanit “Për miratimin e planit të zhvillimit të sistemit të burgjeve 2024-2030” miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 441, datë 6.9.2024, konkretisht në pyetjen se si është zbatuar Objektivi 1 “Forcimi i kapaciteteve organizative dhe funksionale të sistemit zbatimit të vendimeve penale”, nisur edhe nga eksperiencat e vendeve të tjera, por edhe nevoja për një menaxhim më të mirë, si në aspektin e kostove ashtu dhe nisur dhe nevoja e trajtimit të unifikuar të stafit lidhur me karrierën, trajtimin ekonomik, rotacionin, statusin, etj.

Për rritjen e efektivitetit të sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim dhe në komunitet, referuar edhe eksperiencës evropiane, është parashikuar se nevojitet të krijohet një institucion i vetëm i këtij sistemi nëpërmjet hartimit të një ligji të vetëm. Kjo masë aktualisht nuk është realizuar akoma, pasi kërkon vendimarrje politike dhe në nivel qendror. Nga DPB e Ministria e Drejtësisë pritet marrja e një vendimi nga KM për të ngritur grupin e punës për aktivitetet e hartimit të akteve të nevojshme.

Edukimi dhe aftësimi profesional si mekanizëm kryesor në procesin e rehabilitimit dhe riintegritimit të liruarve nga burgu dhe funksionimi i tij.

Edukimi dhe aftësimi profesional synon mbështetjen e personave të burgosur në zotërimin e një kursi të formimit profesional i cili do t'i mundësonte atyre një punësim për të përmirësuar cilësinë e tyre të jetës në aspektin financiar dhe atë social. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj ndërhyrje synohet edhe që ndikohet në uljen e nivelit të analfabetizmit për të burgosur të vlerësuar si kategori “vulnerabël”: që i përkasin komunitetit rom, egjiptian, jetimë, familje me një prind, me të ardhura nën nivelin mesatar të jetesës, kushte të vështira jetese, etj., por edhe si ndihmesë për daljen në lirim me kusht ose prag lirimi. Kjo do të mundësohet në bashkëpunim me institucionet arsimore, OJF / ShKBSH apo biznese private, duke siguruar mundësinë e ofrimit të mjeteve shkollore, çanta e uniforma falas për fëmijët e të burgosurve (sipas vlerësimit të nevojave). Adresimi i rasteve të të burgosurve të motivuar dhe vlerësuar në nevojë për marrjen e formimit profesional përmes asistencës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Gjatë procesit të prag liritimit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Social Shtetëror si dhe Ministrinë e Arsimit të gjejnë rrugët e mundshme për të ndihmuar këta të dënuar me pagesa bonus qiraje apo shkollimin për arsimimin që synojnë të ndjekin.

Një ndër mekanizmat kryesorë që ka një impakt të lartë social dhe është pjesë e zinxhirit të procesit të rehabilitimit dhe riintegritimit të dënuarve pas liritimit, është roli i Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore (Bashkitë dhe institucionet e tyre të varësisë), për kontributin që duhet të japin në sistemimin e ndihmës për strehim, për punësim dhe për ndihmë sociale për të dënuarit pas liritimit, ose zbatimi i dënimit me kusht e ndjekje nga DP Shërbimi Provës. Në vlerësimin e informacionit për periudhën e auditimit të paraqitur nga Drejtoria e Çështjeve Sociale, konkretisht data-base e mbajtur vetëm për vitin 2024 dhe vazhdim për vitin 2025. Për periudhën e viteve 2022-2023 nuk na u paraqit pasqyrë e referimeve dhe përgjigjet e marra nga këto bashki, për personat që kanë përfunduar dënimin ose janë duke shlyer dënimin me kusht në monitorim nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, gjë që ka sjellë pasojë mungesën e gjurmës së auditimit për referim nga DPB për auditim nga grupi i auditimit. Konkretisht, sipas regjistrimit rezulton se për vitin 2024 nga DPB për vitin 2024 janë referuar 59 raste për kontribut dhe ndihmë si për punësim, për strehim dhe ndihmë sociale, por konstatohet se nga Bashkia Korçë, Tiranë, Durrës, Lushnjë, Berat, Burrel, Berat, Elbasan, etj., të cilat jo vetëm nuk kanë dhënë asnjë kontribut, por nuk kanë dhënë asnjë efekt konkret si në pjesën e

ndihmës sociale, punësimi në ndërmarrjet e tyre, strehimit, etj., duke mos ndikuar sadopak në përmirësimin e këtij procesi.

Ndikimi i Auditimit të Brendshëm në vlerësimin dhe rritjen e performancës së kushteve të trajtimit të dënuarve dhe në mirë administrimin e vlerave materiale e monetare në IEVP-të për periudhën 2022-2024.

Në auditimet e kryera nga DAB dhe rekomandimet e dërguara për përmirësimin e mangësive, konstatohet se nga kjo strukturë megjithëse ka patur përpjekje për të rritur nivelin e punës audituese, nuk janë arritur objektivat e caktuara, kjo e mbështetur në konstatimet e Grupit të auditimit të KLSH-it për disa ngjarje ekonomike, të cilat janë trajtuar edhe në materialet e auditimit të brendshëm. U evidentuan shkelje në administrimin e vlerave materiale si lëvizja e materialeve për hoteleri të dënuarve nga magazina në regjim, ku mungon dokumentacioni i plotë dhe në shumë raste u evidentuan mangësi e shkelje në përgatitjen e dokumenteve, pasi ato nuk ishin të plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 10296 datë 8.07.2010 “Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin nr.30 të MF datë 28.12.2011“Për Menaxhimi financiar të Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike” dhe nuk shkishin përmbajtje të plotë dhe lënë shteg për abuzime dhe lëvizjet e brendshme në shumë raste dokumentacioni ishte formal. DAB në DPB, në punën e saj audituese në sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit, është përqendruar edhe në kushtet e trajtimit të të dënuarve, veçanërisht në dhënien e normës ushqimore, detergjenteve për përdorim vetjak, pajisja me veshmbathje dhe artikujve të tjerë si shapka, peshqirë etj, si dhe marrja e barnave për personat në terapi mjekësore. Në informacionin e paraqitur grupit të auditimit KLSH-it, citojmë: “ *Sa më sipër është konstatuar se këto masa janë respektuar me ndonjë mangësi të vogël në mënyrën e dokumentimit të tyre, për të cilat grupi i auditimit të brendshëm të DPB-së ka lënë rekomandimet përkatëse..*”. Kjo nuk qëndron në IEVP-të kryesore , pasi kemi konstatuar shkelje të ligjshmërisë si në IEVP Shkodër, IEVP Korçë , QSB Tiranë, IEVP lezhë, etj., të cilat ne i kemi prezantuar dhe trajtuar në materilin e auditimit.

Gjatë vitit 2022 janë adresuar 36 rekomandime nga DAB, në vitin 2023 janë lënë 36 rekomandime dhe në vitin 2024 janë adresuar 122 rekomandime. Këto rekomandime janë pranuar nga strukturat e institucioneve duke përcaktuar dhe afatet për realizimin e tyre sipas fushave përkatëse, por vërehet se për dokumentimin e vlerave materiale janë rekomanduar 33 masa për përmirësim nga 194 rekomandime në total që kanë zënë 17 % të tyre, kur konstatohet se administrimi i vlerave materiale e monetare është më shqetësuesi, ku jo vetëm auditimi por edhe drejtuesit e Drejtorisë Financës e Buxhetit të kryejnë trajnime për punonjësit e sistemit financiar dhe në kurrikulat e trajnimeve të stafit të burgut të futet si element trajnimi, kjo do të rrisë përgjegjësinë e të gjithë punonjësve që kanë përgjegjësi materiale e monetare në përmbushjet e detyrave funksionale.

Përdorimi i fondeve buxhetore nga IEVP-të ka qenë objekt auditimi nga grupet e auditimit brendshëm të Drejtorisë Auditimit të Brendshëm në DPB, ku pjesa më e madhe e buxhetit të IEVP-ve është për pagat e punonjësve, shpërblimet, energjinë elektrike, ujin, telefoninë, shërbimin postar, dhe pjesa tjetër janë shpenzime për shërbime mirëmbajtjeje institucioni, pastrim kolektiv, mirëmbajtje ndriçimi dhe mirëmbajtjeje mjedisesh të përgjithshme në vlera të vogla. Rritja e cilësisë auditimit me bazë rrisht, duhet të ishte prioritet dhe të jepte impakt pozitiv në përmirësimin e MFK, duke kryer dhe auditime tematike me bazë sistemi për procese të veçanta. Kjo drejtori ka kryer 31 auditime mesatarisht 10 auditime/vit me 4 auditues dhe në vlerësimin tone kryerja mesatare 2.5 auditime është shumë e ulët pasi koha e një auditimi nuk mund të zgjasë më shumë se 2 muaj dhe efica e audituesve ka qenë e ulët. Kjo sipas tabelës mëposhtme:

Tabela nr.13 Numri i auditimeve të planifikuara dhe realizuara 2022-2024

Viti	Plani	Fakti
2022	11	11
2023	13	13

2024	11	9
------	----	---

Tabela nr.13.1 Numri i audituesve të brendshëm të përfshirë në auditime 2022-2024

Viti	Plani	Fakti
2022	4+1	3+1
2023	5+1	3+1
2024	5+1	4+1

Burimi DAB në DPB

DAB nuk ka planifikuar e kryer ndonjë auditim me objekt riintegrimin dhe rehabilitimin, veçanërisht për investimet për krijimin e kushteve për arsimim e formim profesional. Në auditimet e kryera DAB ka sqaruar se:” ..në vijim të punës grupi i auditit ka shqyrtuar kushtet e të dënuarve në IEVP sa i takon infrastrukturës, por nuk ka rekomandime të veçanta”.

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm në DPB ka kryer auditime, ku në program ka qenë të planifikuara auditimi i lëvizjeve të materialeve të inventarit në IEVP ku është konstatuar ekzistenca e dokumenteve përkatëse si pasqyra financiare, fletë dalje, lista shpërndarjeje dhe kartela. Për këto raste nga ana e grupit të auditimit të brendshëm të DPB-së janë lënë rekomandime përditësuese, për raportime më të sakta, por nga auditimi i kryer nuk rezultoj se këto auditime kanë patur ndikim në përmirësimin e dokumentimit dhe administrimit të vlerave materiale e të inventarit të IEVP-ve, kjo e mbështetur në mos administrimin e duhur të medikamenteve ku ne konstatuam shkelje ligjore në administrim, dokumentim dhe mbajtja në ambiente të papërshtshme të medikamenteve të skaduara, ardhur kjo situatë nga mungesa e auditimeve efektive e përdorimit me efikasitet të burimeve njerëzore të DAB në DPB.

Konstatimi i DAB është: **Ne sektorin e shëndetësisë**, u konstatua se dokumentet hyrje dhe dalje të farmacisë, ishin të hedhur në librin e medikamenteve, si dhe ishin azhurnuar kartelat financiare nga sektori i financës. Konsumi i medikamenteve për terapinë, mbahej në një pasqyrë të veçantë, dhe jepej sipas recetave të mjekëve. Nga analizimi i disa medikamenteve në farmaci, dhe intervistimi me punonjësin e farmacisë, rezultoi se nuk kishte **medikamente të skaduara apo me afat të afërt skadence**, të cilat ishin të sistemuara në dollape. Kjo nuk qëndron pasi faktet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-it ishin të kundërta e me shkelje deri në rrezik të mundshëm për përdorim e dëmtim të shëndetit të dënuarve (Në farmacinë e QSB, IEVP Shënkoll dhe IEVP Drenovë).

DAB të marrë masa dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave dhe Drejtorinë e Trajnimeve në DPB të përfshijnë në kurrikulat e trajnimit të stafit të IEVP-ve tema me objekt administrimin e vlerave materiale e monetare dhe përgjegjësinë materiale nëast dëmtimi e abuzimi, duke i njohur ato me legjislacionin përkatës, gjë kjo që do rrisë ndjeshëm përgjegjësinë e stafit në përmbushjen e detyrave dhe do i ndërgjegjësojë ato në përmbushjen e detyrave në përputhje me kërkesat ligjore dhe administrative e shmangur abuzimet.

Mbi klasifikimin e të dënuarve dhe lejet shpërblyese si mekanizëm kontribues në rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve.

Referuar Ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 72 dhe neni 73 i këtij ligji, janë parashikuar dy lloje lejesh; leje shpërblyese (neni 72) dhe Leje e veçantë (neni 73).

Leja e veçantë jepet në raste të sëmundjeve të rënda që kërcënojnë jetën e anëtarëve të familjes, të dokumentuara me raport mjekësor, ose në raste të ngjarjeve të rëndësishme familjare, etj dhe për këtë arsye, për çdo kërkesë për leje të veçantë, është i domosdoshëm dokumentacioni që vërteton shkakun e saj.

Më poshtë në tabelë, janë evidentuar lejet e dhëna për të dënuarit për periudhën 2022–2024, të ndara sipas institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP).

Tabela nr.14 Lejet e veçanta të dhëna për të dënuarit për periudhën 2022–2024

Nr.	IEVP	2022	2023	2024
1	Berat	2	2	4
2	Ali Demi	1	6	1
3	Rrogozhinë	8	4	3
4	Durrës	2	1	0
5	Fushë-Krujë	12	5	8
6	Burrel	1	2	1
7	Kavajë	0	0	2
8	Lushnjë	3	10	5
9	Malësi e Madhe (Reç)	20	14	16
10	Fier	16	28	12
11	Korçë	11	15	14
12	Vlorë	1	2	1
13	Peqin	5	9	5
	Totali	82	98	72

Të dhënat e paraqitura në Tabelën nr 14, tregojnë se numri i lejeve veçanta të dhëna ndër vite nuk ka qenë i qendrueshëm dhe ka pasur luhajtje. Në vitin 2022 janë dhënë gjithsej 82 leje, në vitin 2023 vërehet një rritje me rreth 19,5%, duke arritur në 98 leje, ndërsa në vitin 2024 vihet re një ulje e ndjeshme, duke u dhënë 72 leje, ose rreth 26,5% më pak sesa një vit më parë.

Burimi: DPB

IEVP-të me numrin më të lartë për trevjeçarin kanë qenë IEVP-të e Reçit, Fierit dhe IEVP Drenovë, Korçë, ndërsa institucione të vogla si IEVP-të Burrel, Vlorë dhe Kavajë rezultojnë me përfitime minimale. Kjo shpërndarje tregon diferenca të theksuara ndërmjet institucioneve, të lidhura me kapacitetet akomoduese dhe profilin e të dënuarve në secilin prej tyre.

Leja shpërblyese, jepet si shpërblim për të dënuarit që respektojnë rregullat e disiplinës dhe rregulloren e brendshme të institucionit, tregojnë motivim për të marrë pjesë në programet rehabilituese dhe të riintegrit, si dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore dhe kanë sjellje të përgjegjshme. Për të dënuarit e mitur, kohëzgjatja e lejeve shpërblyese përcaktohet në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Në tabelën më poshtë janë evidentuar lejet e dhëna për të dënuarit për periudhën 2022–2024, të ndara sipas institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP).

Tabela 14.1 Lejet shpërblyese të dhëna për të dënuarit për periudhën 2022–2024

Nr.	IEVP	2022	2023	2024
1	Berat	0	0	12
2	Ali Demi	0	0	1
3	Pojskë	0	0	6
4	Rrogozhinë	0	0	109
5	Durrës	0	0	11
6	Fushë-Krujë	0	0	9
7	Burrel	0	0	14
8	Kavajë	0	0	1
9	Lushnjë	0	0	28
10	Malësi e Madhe (Reç)	0	0	112
11	Fier	0	0	67
12	Vlorë	0	0	4
13	Korçë	0	0	12
	Totali	0	0	386

Burimi: DPB

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se gjatë viteve 2022 dhe 2023 nuk është dhënë asnjë leje shpërblyese sipas kësaj kategorie për të gjithë IEVP-të në vend, ndërsa në vitin 2024 vihet re një ndryshim i menjëhershëm, ku janë akorduar gjithsej 386 leje shpërblyese. Pjesa më e madhe e tyre është përqendruar në IEVP Reç me 112 leje (29% e totalit), ndjekur nga IEVP Rrogozhinë me 109 leje (28%) dhe Fier me 67 leje (17%). Institucionet e tjera, si Berat, Korçë dhe Lushnjë, paraqesin shifra më të ulëta përfitimesh, ndërsa Ali Demi, Kavajë dhe Vlorë regjistrojnë vetëm nga 1–4 leje në vit. Kjo situatë tregon një aktivizim të vonuar dhe të përqendruar vetëm në vitin 2024, me diferenca të theksuara ndërmjet institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Numri i lejeve shpërblyese lidhet ngushtë me klasifikimet periodike të rrezikshmërisë së të dënuarve. Të dënuarit që, gjatë vlerësimeve periodike, tregojnë sjellje të mire dhe rrezikshmëri të ulët, kanë më shumë gjasa të përfitojnë leje shpërblyese si formë nxitjeje dhe motivimi.

Ndërsa për ata me rrezikshmëri të lartë, dhënia e lejeve shpërblyese kufizohet ose përjashtohet plotësisht, pasi nuk plotësojnë kriteret e besueshmërisë dhe të sigurisë.

Referuar Ligji nr. 81/2020, neni 72 përcakton se: Të dënuarit që respektojnë rregullat e institucionit dhe angazhohen në programe rehabilitimi kanë të drejtë të marrin leje shpërblyese deri në 20 ditë në vit, si pjesë e procesit të riintegrit gradual në shoqëri. Dhënia e lejes dhe shqyrtimi i kërkesës duhet të bëhen brenda afateve të përcaktuara ligjore, duke vlerësuar motivimin, sjelljen dhe uljen e rrezikshmërisë së të dënuarit. Pra, leja shpërblyese është instrument ligjor detyrues për të lehtësuar marrëdhëniet sociale e familjare dhe për të ndihmuar rehabilitimin.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, me fillimin e pandemisë COVID-19, janë ndërmarrë masa kufizuese në nivel kombëtar për të minimizuar rrezikun e përhapjes së infeksionit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Konkretisht, me Urdhrin nr. 91 prot., datë 09.03.2020 dhe Urdhrin nr. 92 prot., datë 09.03.2020 të Ministrit të Drejtësisë, është vendosur pezullimi i të gjitha lejeve shpërblyese për të dënuarit.

Këto masa janë konsideruar të domosdoshme në atë kohë, duke synuar të parandalonin përhapjen e COVID-19 në ambientet e burgjeve, si dhe të ulnin risqet e arratisjes dhe të moskthimit në institucion pas përfitimit të lejes.

Megjithatë, auditimi evidentoi se pezullimi i kësaj të drejte ka vijuar për një periudhë shumë më të gjatë sesa kohëzgjatja e kufizimeve shëndetësore të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Edhe pasi situata shëndetësore e Covid –19 në vend është përmirësuar ndjeshëm dhe janë shfuqizuar kufizimet kryesore të pandemisë, nëpërmjet Urdhrit nr. 273 prot., datë 26.04.2022 të Ministrit të Shëndetësisë, i cili ka shfuqizuar Urdhrin nr. 351 prot., datë 29.05.2020, “Për marrjen e masave të vecanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID – 19”, lejet shpërblyese kanë mbetur të pezulluara për vitet 2022-2023-04/03.2024.

Kjo zgjatje e pajustificuar e kufizimit ka ndikuar drejtpërdrejt në mosfunksionimin e një mekanizmi kyç për rehabilitimin e të dënuarve, kjo e parashikuar në kuadrin ligjor i ekzekutimit të vendimeve penale. Lejet shpërblyese, synojnë të forcojnë lidhjet familjare, të rritin përgjegjshmërinë individuale dhe të përgatisë të dënuarit për riintegrim social. Kjo masë lehtësuese në procesin e rehabilitimit nuk ka mundur të ushtrohet nga shumica e të dënuarve, duke dobësuar qëllimin final rehabilitues për të dënuarit.

Vetëm me Urdhrin nr. 314/1 prot., datë 04.03.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, është rivendosur e drejta për të aplikuar dhe për të përfituar leje shpërblyese, duke rihapur procedurat e zbatimit për këtë mekanizëm rehabilitues.

Nga analiza e akteve dhe dokumentacionit administrativ rezulton se, pas shfuqizimit të masave shëndetësore në prill 2022, nuk është kryer një rivlerësim i menjëhershëm apo i dokumentuar i nevojës për vazhdimin e pezullimit të lejeve shpërblyese, sipas parimit të proporcionalitetit dhe rrezikut të menaxhueshëm. Mungesa e akteve reflektuese, udhëzimeve të brendshme dhe planifikimit institucional për rikthimin e lejeve shpërblyese ka sjellë zvarritje administrative në rikthimin e një të drejte të garantuar me ligj.

Gjithashtu, auditimi vlerëson se ka patur mungesë koordinimi ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për harmonizimin e masave shëndetësore me ato të ekzekutimit të vendimeve penale. Për më tepër, mungesa e burimeve njerëzore të mjaftueshme, të trajnimit dhe procedurave të standardizuara për vlerësimin e rrezikshmërisë së të dënuarve në procesin e paraqitjes së kërkesave për leje shpërblyese, ka shtuar hezitimin, zvarritjen për rikthimin në kohë të këtij mekanizmi.

Së fundi, pamundësia për të zhvilluar një analizë të ndikimit mbi rehabilitimin dhe riintegrimin gjatë fashës së pezullimit ka bërë që vendimmarrja administrative të mos konsiderojë plotësisht pasojat afatgjata të mbajtjes së këtij kufizimi përtej kohës së emergjencës shëndetësore.

Pezullimi i zgjatur i lejeve shpërblyese ka sjellë cenim të drejtpërdrejtë të procesit rehabilitues për të dënuarit, pasi ky mekanizëm është mjeti i vetëm ligjor që u mundëson atyre të ruajnë e të forcojnë lidhjet familjare e sociale gjatë vuajtjes së dënimit – elemento kyç për riintegrimin e qëndrueshëm në shoqëri. Mungesa e daljes graduale në komunitet ka krijuar rrezik të shtuar të izolimit social, stresit dhe regresit psiko-emocional, sidomos për kategoritë vulnerabël, duke cenuar të drejtën e trajtimit individual dhe të diferencuar.

Në planin institucional, mospërfitimi i lejeve shpërblyese ka ulur efektivitetin e investimeve rehabilituese brenda burgut, pasi puna e bërë për ndryshim të sjelljes, motivim dhe përgjegjësi individuale nuk është shoqëruar me testim praktik në realitetin social jashtë institucionit. Si pasojë, është kufizuar mundësia për të reduktuar recidivizmin, duke shtuar riskun që një pjesë e të dënuarve të riangazhohen në veprimtari kriminale pas lirimit.

Në nivel të menaxhimit të sistemit në burgje, është konstatuar se mungesa e një vendimmarrjeje të bazuar në indikatorë dhe analiza të impaktit dhe riskut, ka sjellur mangësi në zbatimin e parimeve të mirëadministrimit, duke sjellë një përjasje më shumë formale sesa funksionale të politikave të trajtimit të dënimit me burgim. Po ashtu, *zgjatja e pajustificuar e pezullimit të lejeve shpërblyese ka cenuar besimin e të dënuarve në sistemin e drejtësisë dhe në parimin e motivimit për sjellje të mirë, duke krijuar një perceptim negativ mbi shpërblimin dhe meritokracinë në trajtimin e tyre.*

Këto pasoja, nënkuptojnë se objektivi thelbësor i procesit të rehabilitimit dhe riintegrimin dhe efikasiteti i përdorimit të lejeve shpërblyese, siç është përcaktuar nga ligji dhe dokumentet strategjike të sistemit penitenciar, nuk është realizuar në mënyrë të plotë gjatë periudhës së pezullimit të zgjatur të lejeve shpërblyese.

Ndikimi i transferimeve të dënuarve në procesin e rehabilitimit dhe integrimin gjatë vuajtjes së dënimit.

Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, parashikon se administrimi i dënimit me burgim duhet të garantojë:

-Mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë personale të të dënuarve, si dhe integritetin fizik e psikologjik të tyre, duke parandaluar çdo rrezik që mund të cenojë mirëqenien e individit (nenet 5, 10 dhe 56 të ligjit).

-Të drejtën për të ruajtur lidhjet familjare, përmes mundësimit të kontakteve të rregullta me familjarët dhe vendosjen e personave të dënuar, sa herë që është e mundur, në institucione pranë vendbanimit të tyre ose të familjes (neni 38).

-Aksesin e pandërprerë në kujdesin shëndetësor, në përputhje me nevojat mjekësore të secilit individ, përfshirë shtrimet brenda ose jashtë institucionit, kur gjendja e tij e kërkon trajtim të specializuar (nenet 41-42-47).


-Vendosjen e të dënuarve në institucionin penal të përputhshëm me nivelin real të riskut, me qëllim garantimin e rendit, sigurisë dhe trajtimit të duhur të tyre, bazuar në procedurat e klasifikimit dhe vlerësimit periodik të sjelljes dhe rrethanave personale (nenet 13-14).

Gjatë vitit 2023 – 2024, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP-të kanë përballur me një volum shumë të lartë transferimesh të të dënuarve ndërmjet institucioneve të ndryshme.

Në vitin 2023 janë trajtuar gjithsej 13,404 të dënuar dhe janë kryer 1893 transferime, ndërsa në vitin 2024 janë trajtuar 13,858 të dënuar dhe janë kryer 2911 transferime, duke regjistruar kështu një rritje me rreth 54% në numrin total të lëvizjeve ndërinstucionale. Këto transferime të brendshme ndërmjet institucioneve, për një gamë të gjerë arsyesh si (arsye familjare, gjykimi, mbipopullimi, shëndeti, siguria, ndryshimi i statusit, masat mjekësore, futja në mbikëqyrje të veçantë, ndryshimi i llojit të sigurisë, arsye pune dhe arsye të tjera). Transferimet e shumta në numër brenda vitit tregojnë se, sistemi i vendosjes dhe menaxhimit të të dënuarve funksionon në masë të madhe në mënyrë reaktive, duke u përshtatur vazhdimisht me nevojat emergjente (mbipopullim, vendime gjyqësore, gjendje shëndetësore, situata sigurie), dhe më pak mbi bazën e një planifikimi afatmesëm të stabilizuar të vendosjes së tyre në institucione.

Grafiku nr.4


Përmbledhje e transferimeve 2023-2024 sipas kategorive



Burimi: DPB, Përpunimi: Grupi i auditimit

Rezulton se, pjesa më e madhe e transferimeve ndërmjet IEVP-ve gjatë periudhës 2023–2024 lidhet me marrjen e vendimit formë të prerë, të cilat përbëjnë 32.3% të totalit, duke konfirmuar ndjekjen e detyrueshme të ndryshimit të statusit procedural të personave të dënuar. Në vend të dytë renditen transferimet nga komisaritet në burg me 22.0%, si rezultat i flukseve hyrëse nga fazat fillestare të ndalimit. Kategoria e tretë më e lartë lidhet me mbipopullimin, që përbën 19.0%, duke reflektuar vështirësitë e vazhdueshme në menaxhimin e kapaciteteve të sistemit penitenciar. Transferimet për arsye sigurie (7.6%) dhe arsye familjare (5.5%) paraqiten në nivele më të ulëta, ndërsa ato për shëndet vetëm 0.5%, duke treguar përdorim më të kufizuar të trajtimeve shëndetësore jashtë institucionit. Transferimet për arsye gjykimi janë vetëm 0.9%, ndërsa të gjitha kategoritë e tjera (masa mjekësore, ndryshim statusi, 41-bis, mbikëqyrje e veçantë, rikategorizim dhe të tjera) së bashku përbëjnë më pak se 10% të totalit. Këto të dhëna tregojnë qartë se dinamika e sistemit penitenciar dominohet nga faktorë proceduralë dhe kapacitetet akomoduese, me ndikim të drejtpërdrejtë në lëvizshmërinë e të dënuarve ndërmjet institucioneve.


Grafiku nr.5. Mbi transferimet e kryera për vitin 2023, si më poshtë:



Burimi: DPB

Përpunimi: Grupi i auditimit

Grafiku 5.1 Transferimet për vitin 2024, si më poshtë:



Burimi: DPB

Përpunimi: Grupi i auditimit

Volumi i lartë dhe në rritje progresive i transferimeve të të dënuarve gjatë vitit 2024, reflekton mangësi strukturore në menaxhimin e kapaciteteve, planifikimin e vendosjes së të dënuarve dhe koordinimin me strukturat e drejtësisë. Sistemi klasifikues dhe vlerësues i riskut nuk arrihet të parashikojë me kohë nevojat e ndryshimit të regjimit, çka sjell zhvendosje të përsëritura për shkak të rivlerësimit të vonuar të statusit dhe profilit të të dënuarve. Mungesa e një analize të vendosjes gjeografike të të paraburgosurve tregon se planifikimi është i përqendruar në zgjidhje të menjëhershme dhe jo në eficiencë afatgjatë dhe ulje të transferimeve të panevojshme.

Lëvizjet e shpeshta të të dënuarve ndërpresin vazhdimësinë e programeve rehabilituese dhe të mbështetjes psikosociale tek psikologët e besuar e që ndjekin këtë proces, si dhe cenojnë planin individual të trajtimit për rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve. Ato krijojnë pasiguri personale tek i dënuari, e cila përkthehet në tensione dhe rrezikshmëri më të lartë për incidente brenda ambienteve të burgjeve. Largimi nga IEVP-të afër qendrave të banuara, ku të dënuarit kanë kontakte familjare e dobëson procesin e riintegritimit shoqëror dhe përkeqëson gjendjen psikologjike të tyre.

Këto lëvizje, përfshijnë angazhimin e personelit dhe mjeteve të transportit, duke shkëputur efektivet e sigurisë nga detyrat brenda institucioneve dhe duke rritur kostot financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë. Risku i sigurisë jashtë institucioneve shtohet ndjeshëm, për shkak se transporti i të dënuarve paraqet rrezik për arratisje, kontakte të paautorizuara, futje sendesh të ndaluara dhe situata të paparashikueshme gjatë shoqërimit në rrugë, spitale apo gjykata.

Po kështu, volumi i lartë i transferimeve shton në mënyrë të konsiderueshme ekspozimin ndaj risqeve të sigurisë, pasi çdo lëvizje kërkon shoqërim fizik të të dënuarve jashtë ambienteve të kontrolluara të I EVP-ve, përdorim të mjeteve të transportit dhe angazhim të personelit të sigurisë dhe rritje të panevojshme të shpenzimeve për të dënuarit.

Në të njëjtën kohë, kjo situatë sjell rritje të drejtpërdrejtë të kostove për çdo të dënuar, në përpjesëtim me numrin e transferimeve.

Forcat operacionale dhe stafi i sigurisë, që angazhohen në këto shoqërime të shpeshta, *shkëputen nga detyrat kryesore për sigurinë e I EVP-ve (ruajtja e rendit dhe sigurisë, monitorimi i të dënuarve, parandalimi i incidenteve, mbikëqyrja e aktiviteteve të brendshme)*, çka mund të dobësojë kapacitetin e brendshëm për të garantuar sigurinë dhe rendin në institucion. Në mungesë të një analize të thelluar të shkaqeve të këtij numri të lartë transferimesh dhe të masave për ta ulur atë në nivele të arsyeshme, sistemi rrezikon të funksionojë në mënyrë jo eficiente dhe me risk më të lartë për cënimin e sigurisë, si gjatë lëvizjeve, ashtu edhe brenda vetë institucioneve.

Mungesa e një analize të thelluar të vendosjes gjeografike të të paraburgosurve, në funksion të largësisë me institucionet e drejtësisë, tregon se planifikimi mbështetet më shumë në nevoja imediate operacionale sesa në efikasitet afatgjatë, ndërkohë që një riorganizim më i mirë i shpërndarjes së tyre mund të reduktojë numrin e transferimeve dhe të përmirësojë menaxhimin e përgjithshëm të burimeve.

Rritja e ndjeshme e numrit të transferimeve gjatë periudhës 2023–2024 vlerësohet si tregues i dobësive në planifikimin paraprak të shpërndarjes së të dënuarve dhe i varësisë nga masa të shpëjtimit për menaxhimin e kapaciteteve. Ky nivel i lartë lëvizshmërie rrit riskun për cenimin e sigurisë publike dhe institucionale, rëndon ndjeshëm koston operacionale dhe kufizon burimet njerëzore të disponueshme për garantimin e funksioneve bazë të sistemit penitenciar.

Shërbimi i Provës një mekanizëm i rëndësishëm në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin i të dënuarve pas lirimit ose lirimit me kusht.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Provës(DPSHP), është një institucion i krijuar në vitin 2009, posaçërisht për ekzekutimin e dënimeve alternative me burgim, të cilat synojnë rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve në shoqëri, duke garantuar sigurinë publike dhe ulur kostot për të dënuarit dhe sistemin penitenciar në tërësi si pjesë integrale e Ministrisë së Drejtësisë. Shërbimi i Provës është i organizuar në nivel qendror dhe 22 Degë Territoriale në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

Roli i Shërbimit të Provës gjatë periudhës së mbikëqyrjes së dënimit alternativ. (Rehabilitimi)

- *Mbikëqyrja dhe monitorimi* i dënimeve/masave alternative ndaj burgimit zbatohet sipas (nenit 58, 59, 59/a, 63, e 64 të Kodit Penal), në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë me qëllim që të mundësojë rehabilitimin dhe riintegrimin shoqëror të personave nën mbikëqyrje, parandalimin e veprave penale dhe uljen e rrezikut të përsëritjes së tyre, uljen e kostove sociale, si dhe të kontribuojë në mbrojtjen e interesit publik. Mbikëqyrja bazohet në hartimin e Planit Individual të Mbikëqyrjes (PIT) në bashkëpunim me të mbikëqyrurin, ku përfshihen:

- a) Vlerësimin e rrezikut të përsëritjes së veprës penale;
- b) Hartimi i sistemit të vlerësimit të rrezikshmërisë (SVR);
- c) Analizën e nevojave për rehabilitim dhe integrim social;
- d) Detyrimet për përfshirje në aktivitete komunitare dhe edukative.

Gjatë mbikëqyerjes për kohën e përcaktuar nga vendimi i gjykatës me të mbikëqyrur, kryhen **aktivitete rehabilituese** në drejtim të këshillimit psiko-social dhe orientim drejt sjelljeve pozitive, asistimin, këshillimin dhe riintegrimin në shoqëri të personit nën mbikëqyrje dhe e rëndësishme dhe përfshirja në punësim, kurse, trajnime dhe programe arsimore nëse ka detyrime apo kushte të vendosura nga gjykata. Kjo kryhet dhe nga trajtimi mjekësor në klinika trajtuese të specializuara nga varësia ndaj substancave/lëndëve narkotike apo të alkoolit, theksojmë se në Shqipëri edhe pse Shërbimi i Provës ka marrëveshje me QSUNT nga kjo e fundit nuk ofrohet si shërbim dhe të dënuarit/mbikëqyrurit me familjarët e tyre kanë gjetur vet klinika trajtuese me shpenzimet e tyre në shtete fqinje si Maqedonia e Veriut apo në Kosovë nëpërmjet OJF-ve vendase. Po kështu në aktivitetin e saj, *koordinimi ndërinstytucional* me IEVP-të, bashkitë, shërbimet sociale, qendrat e formimit profesional publik, zyrat e punësimit, zyrat arsimore, dhe OJF/OJQ-të në nivel vendor për realizimin e aktiviteteve rehabilituese.

Roli i Shërbimit të Provës pas përfundimit të dënimit. (Riintegrimi)

Në lidhje me riintegrimin, kërkohet të jetë e përcaktuar në vendimin gjyqësor ose me pëlqimin e të mbikëqyrurit për raste kur ndiqet edhe pas përfundimit të periudhës së provës, por për periudhën e auditimit 2022-2024 nuk ka patur raste të përcaktuara nga vendime gjykate.

Shërbimi i Provës si një mekanizëm që ka një rol thelbësor dhe ndërinstytucional në rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të dënuar duke i mbikëqyrur dhe duke synuar uljen e recidivizmit (përsëritjes) së veprave penale, mbështetjen e integritetit social dhe ekonomik të individëve dhe zbatimi efektiv i vendimeve gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Plani individual i trajtimit është dokumenti më i rëndësishëm, ku përcaktohen ndërhyrjet që do të kryhen për rehabilitimin dhe riintegrimin e personit nën mbikëqyrje.

Në bazë të nenit 27 të ligjit Nr.78/2020, datë 25.06.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës” të ndryshuar, specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës ndihmon dhe mbështet personin nën mbikëqyrje për riintegrimin e tij në shoqëri, duke e referuar atë pranë institucioneve dhe strukturave shtetërore kompetente për punësimin, strehimin, formimin profesional dhe strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kjo bazuar në informacionin e administruar gjatë të gjithë procesit dhe vlerësimin e personalitetit dhe të mjedisit shoqëror të personit nën mbikëqyrje. Për të miturit në konflikt me ligjin, specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës ofron gjithashtu mbështetje për ndjekjen e arsimit përkatës nga i mituri. Baza ligjore e funksionimit të DPSHP është;

- Ligji nr. 90/2024 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 78/2020 i ndryshuar, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës”, rregullon marrëdhëniet e punës me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Urdhri i Kryeministrit nr. 173, datë 10.09.2024 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së e Shërbimit të Provës” ku janë miratuar dhe struktura e këtij institucioni , ku fakti që nga Drejtori i Përgjithshëm, drejtori i financës dhe disa drejtues të tjerë, janë të komanduar dhe kryejnë dy pozicione pune, ka mbi 15 vende vakante me specialistë si në DP SHP dhe në Degët Rajonale kanë sjellur mungesë eficence të përdorimit të burimeve njerëzore dhe mos menaxhim me kopetencia të plota të institucionit. Po kështu kjo situatë aspak e pranueshme dhe që çënon direkt mirëmenaxhimin e institucionit në funksionimin e saj, është e shoqëruar edhe me mungesë ambientesh funksionale si në DPSHP por dhe në degët rajonale, ku kufizimi i fondeve ka çënuar funksionalitetin e plotë të institucionit. Nga mungesa e personelit dhe nga mosvlerësimi i duhur i Ministrisë Drejtësisë për këtë institucion, ka sjellur dhe mbingarkesa në numurin e të mbikëqyrurve nga një specialist, ku aktualisht sipas ndarjes ngarkesave kemi aktualisht 150 të mbikëqyrur/specialist, ndërkohë që në vendet fqinje ky numër është 50-60 të mbikëqyrur për një specialist. DPSHP si pjesë e zinxhirit të procesit të rehabilitimit dhe riintegritetit të dënuarve dhe pas lirimit si mekanizëm që mban peshë të rëndësishme dhe kërkohet një vëmendje të veçantë e Ministrisë Drejtësisë për mbështetje financiare,

menaxheriale në drejtim të përmirësimit me mbështetje infrastrukturore dhe amendimet e duhura ligjore e nënligjore, sipas objektivave strategjikë.

Bazuar në Urdhërin Nr. 456 datë 31.12.2020 të Ministrit të Drejtësisë “Për Miratimin e Formatit, Përmbajtjes, Mënyrës së Krijimit dhe Administrimit të Regjistrave të Shërbimit të Provës”, në Degët Territoriale e Shërbimit të Provës janë hartuar këto regjistra:

- 1) Regjistri i personave nën mbikëqyrje.
- 2) Regjistri i Kërkesë – Ankesave.
- 3) Regjistri i Organizatave Jofitimprurëse, institucioneve shtetërore ose subjekteve private që ofrojnë këshillim dhe asistencë për të dënuarit me me alternativë të dënimit me burgim.
- 4) Regjistri për Raportet e Vlerësimit të kërkuara nga Gjykata ose Prokuroria.

Në objektivat kryesorë të DPSHP, është ulja e % e numrit të vendimeve penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet, të cilat përfshijnë dënime alternative.

Treguesit e performancës për vitin 2023 është 67%, dhe llogaritet si raporti i numrit të vendimeve penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet, të cilat përfshijnë dënime alternative, me numrin total të vendimeve penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet. Megjithatë, DPSHP ka raportuar se nuk mban të dhëna mbi gjithë vendimet penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet, dhe mund të raportojë vetëm për numrin e vendimeve penale, ku vendoset një dënim alternativ gjë që duhet të përmirësohet menjëherë e në vijim.

Gjatë vitit 2023, DPSHP raportoi se 6679 vendime penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet kanë përfshirë dënime alternative. Këto janë ndarë sipas llojit në tabelën e mëposhtme:

Lloji i dënimeve alternative Janar - Dhjetor 2023

Neni 59 i KP, Pezullimi	5457
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	34
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	89
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	1097
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	2
Totali	6679 të mbikëqyrur

Raporti i personave nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës të liruar me kusht (ose forma të tjera të lirimit me kusht), të cilët kanë shërbyer me sukses në shërbimin e provës.

Ky tregues është i rëndësishëm për matjen e cilësisë së punës së Shërbimit të Provës. Vlera e synuar për vitin 2023 për këtë tregues të performancës është 99%. Për vitin 2023, Shërbimi i Provës raportoi shifrat e mëposhtme në lidhje me të paraburgosurit nën mbikëqyrjen e tyre, të liruar me kusht (ose forma të tjera të lirimit me kusht), të cilët kryen me sukses Shërbimin e Provës. Shifrat u ndanë gjithashtu sipas llojit të lirimit me kusht.

Lloji i dënimeve alternative Janar - Dhjetor 2024

Neni 59 i KP, Pezullimi	4402
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	48
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	187
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	1090
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	2
Totali	5729

Siç shikohet më sipër, DPSHP ka kryer punë voluminoze, por në vlerësimin e grupit të auditimi ky institucion megjithë punën e bërë, kërkon një riorganizim e vlerësim objektiv e real për të krijuar mundësimë e përdorimit me efektivitet e efencë të burimeve ekonomike financiare dhe ato njerëzore.

16. Gjetje nga auditimi: Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, përcakton krijimin e lehtësirave për të dënuarit në çastin e lirimit që plotësojnë kushtet për kalim në sistem regjimi të hapur. Deri tani Ministria Drejtësisë dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nuk kanë marrë asnjë masë për të vënë në zbatim këtë kërkesë ligjore, duke mos plotësuar kushtet e kërkuara për trajtim me regjim të hapur.

17. Gjetje nga auditimi: Është evidentuar fakti, sikurse nga vlerësimet e Avokatit Popullit, Ministrisë së Drejtësisë, institucionet mbikëqyrëse ndërkombëtare, se funksionimi i Drejtorisë e Përgjithshme e Shërbimit Provës, i ndarë nga sistemi i burgjeve nuk ka funksionuar me efektivitet dhe efikasitet. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtare dhe institucionet ndërkombëtare kanë vlerësuar si të nevojshme bashkimin e dy institucioneve dhe konkretisht: Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës. Kjo kërkon nevojën e ndryshimeve ligjore, *por konstatohet se deri tani nuk është bërë asnjë veprim në shërbim të plotësisht të bashkimit*, pasi kërkon vendimarrje politike dhe në nivel qendror. Kjo do të sillte një përmirësim të ndjeshëm në efektivitetin e procesit të rehabilitimit dhe riintegrimin pas lirimit nga burgju ose lirim me kusht.

18. Gjetje nga auditimi: Nisur nga mungesa e bashkëpunimit efektiv ndërmjet Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, nuk janë marrë akoma hapa ligjore apo iniciativa institucionale për të bërë amendime të ligjit ose akteve nënligjore, me objekt trajtimin si raste të veçanta pranimi të dënuarve në kurse më arsim në nivel të pranueshëm dhe që nuk cenojnë implementimin e politikave të arsimit parauniversitar për perjashtime nga detyrimi i arsimit të detyrueshëm.

19. Gjetje nga auditimi: Lidhur me procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin në shoqëri dhe familje të të liruarve nga burgju, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa bashki të vendit me qëllim krijimin e shërbimeve sociale si strehim, punësim etj. Pavarësisht kësaj, numri i marrëveshjeve të lidhura është i kufizuar duke lënë jashtë këtij procesi të liruarit nga burgju të atyre bashkive që nuk kanë marrëveshje bashkëpunimi. Gjithashtu, edhe në rastet e marrëveshjeve të lidhura midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore, rezulton se zbatimi i tyre është jo efektiv dhe nuk ka rezultate konkrete.

20. Gjetje nga auditimi: Me fillimin e pandemisë COVID-19 (mars 2020), me Urdhrin nr. 91 prot., datë 09.03.2020 dhe Urdhrin nr. 92 prot., datë 09.03.2020 të Ministrit të Drejtësisë, është ndaluar aplikimi i lejeve të daljes (leje të veçanta dhe leje shpërblyese) nga burgju i të burgosurve. Nga ana tjetër, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Urdhrin nr. 273 prot., datë 26.04.2022, urdhëroi heqjen e masave parandaluese që ishin vendosur në fillim të pandemisë. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve me Urdhrin nr. 314/1 prot., datë 04.03.2024, ka lejuar aplikimin e lejeve të daljes (leje të veçanta dhe leje shpërblyese). Ky Urdhër ka dalë 2 vjet me vonë nga Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke cenuar besimin e të dënuarve në sistemin e drejtësisë dhe në parimin e motivimit për sjellje të mirë.

21. Gjetje nga auditimi: Gjatë viteve 2023–2024, sistemi penitenciar ka kryer 4,704 transferime të të dënuarve dhe të paraburgosurve ndërmjet institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, me një rritje të fortë prej rreth 54% në vitin 2024. Shumica e lëvizjeve janë kryer për arsye procedurale dhe të kapaciteteve, si marrja e vendimit formë të prerë, transferimet nga komisarati dhe mbipopullimi, ndërsa transferimet për të drejtat e trajtimit (familjare, shëndetësore) janë në nivele të ulëta. Kjo tregon një funksionim të papërshtatshëm të sistemit të akomodimit të të dënuarve, me ndikim në stabilitetin e vendosjes dhe trajtimin e vazhdueshëm të tyre në institucionet e sigurisë dhe rehabilitimin e tyre në një strukturë penitenciare.

22. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u evidentua fakti, se në punën audituese nuk kanë kryer auditime me bazë rrezik dhe bazë sistemi dhe në auditimet e kryera nuk janë evidentuar në mënyrë të saktë konstatimet

e gjetura në lidhje me administrimin dhe dokumentimin e lëvizjes së vlerave materiale e inventariale, duke sjellë mosadministrim sipas kërkesave të të ligjit nr. 10296 datë 8.07.2010 “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Udhëzimin të MF nr.30 datë 28.12.2011“Për Menaxhimin financiar të Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike”. Po kështu është konstatuar, se mungojnë njohuritë e duhura të stafit në IEVP-të të personave që kanë përgjegjësi materiale e monetare, e për këtë nuk ka iniciativa apo propozime për trajnimin e këtyre punonjësve me njohuritë bazë të administrimit dhe dokumentimit të vlerave materiale e inventariale, duke rritur ndikimin e përgjegjësive materiale për dëmtimet e abuzimet në përmbushje të detyrave të caktuara.

23. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës është konstatuar se ka munguar vlerësimi i duhur nga Ministria e Drejtësisë për mbështetje në plotësimin e strukturës organizative, ku nuk ka emërimet e drejtuesve. Institucioni vazhdon të drejtohet me Drejtor të Përgjithshëm të komanduar prej më shumë se 1 viti dhe njëkohësisht kryen detyrën si Drejtor Drejtorie. Po kështu edhe drejtori i financës është i komanduar si dhe janë 15 vende vakant për specialistë. Ky institucion kryen funksionon në ambiente tepër të kufizuara dhe aspak stimuluese për rritjen e eficiencës së burimeve njerëzore. Kjo mangësi ka ardhur nga mos sigurimi i ambienteve si dhe mos planifikimi i investimeve të qëndrueshme.

6. Konkluzioni: Ka munguar vlerësimi i duhur dhe përkrahja e nevojshme e pushtetit vendor(Bashkitë) për të dënuarit e liruar për krijimin e lehtësirave për një rikthim dinjitoz në familje e shoqëri.

7. Konkluzion: Nuk janë zbatuar në kohë, urdhërat e nxjerr nga Ministriria e Shëndetësisë, për masat e marra për situatën e covid – 19, duke cënuar procesin e rehabilitimit në mungesë të reflektimit të dhënies së lejeve shpërblyese për periudhën Prill 2022–Mars 2024, ku të dënuarve nuk u është mundësuar ushtrimi i një të drejte ligjore të lidhur ngushtë me trajtimin individual dhe rehabilitimin e tyre.

8. Konkluzioni: Rritja e numrit të transferimeve procedurale tregojnë se menaxhimi i vendosjes së të dënuarve nuk po orientohet në mënyrë të mjaftueshme nga parimet e trajtimit dhe rehabilitimit sipas Ligjit nr. 81/2020. Lëvizjet e shpeshta cenojnë vazhdimësinë e programeve të trajtimit, shtojnë ekspozimin ndaj risqeve të sigurisë dhe rrisin kostot operacionale. Në mungesë të një planifikimi më afatgjatë të kapaciteteve, sistemi penitenciar rrezikon të mbetet në një cikël të kushtueshëm dhe me ndikim negativ në rezultatet e vuajtjes së dënimit dhe të drejtave të të dënuarve.

9. Konkluzioni: Stafi i IEVP-ve që administrojnë vlerat materiale e monetare nuk zotërojnë njohuri të mjaftueshme për administrimin e tyre dhe kjo mangësi nuk është evidentuar nga auditimet e kryera në periudhën 2022-2024.

10. Konkluzioni: Në DPSHP mungojnë emërimet definitiv të stafit drejtues dhe ka mbingarkesë të specialistëve mbikqyrës deri në 3 herë më shumë se kolegët në vendet fqinje dhe ka mambiente të kufizuara që pengojnë funksionalitetin e institucionit dhe pengojnë menaxhimin e duhur për të mbikëqyrurit.

16.1. Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe institucionet e tjera vendimmarrëse e ligj zbatuese, të marrë masa për të koordinuar veprimet dhe vendimmarrjen për plotësimin e legjislacionit, përditësimin e akteve ligjore (Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, etj.) e nënligjore, për nevojat që kanë për ndryshim, përgatitjen e rregulloreve përkatëse, për të filluar trajtimin e të dënuarve në “Regjim të hapur”, fillimisht me Institucionet e Ekzekutimit të Veprave Penale pilot e pastaj shtrirjen

sipas vlerësimeve përkatëse me grup pune me ekspertë të fushës, duke dhënë një ndihmesë të madhe në efikasitetin e zbatimit të proceseve të rehabilitimit dhe riintegritimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.1. Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët (*Drejtoria e Përgjithshme e Purgjeve/Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe Ministria e Drejtësisë*) për të hartuar një plan pune konkret dhe propozimet e duhura për riaktivizimin e projektit të bashkimit të këtyre dy institucioneve, nëpërmjet Qeverisë dhe aktorëve ndërkombëtarë. Këto hapa do të shërbejnë për lehtësimin e procesit rehabilitimit dhe riintegritimit të të liruarve nga burgu dhe një funksionim efikas të këtyre institucioneve të bashkuara.

Brenda vitit 2026

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim, të ngrejnjë një grup pune dhe të punojnë së bashku për të marrë iniciativa ligjore për të rregulluar këtë shqetësim në lidhje me kryerjen e kurseve profesionale nga të dënuarit. Kjo do të ishte një ndihmë e madhe për rehabilitimin dhe riintegritimin e të dënuarve që vuajnë dënimin, ato që janë në prag lirim,

Menjëherë dhe në vijimësi

19.1. Rekomandimi: Lidhur me procesin e rehabilitimit dhe riintegritimit në shoqëri dhe familje të të liruarve nga burgu, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore (të cilat nuk ka nënshkruar marrëveshje të tilla) për trajtimin e të liruarve me shërbime sociale, si: strehim, punësim etj. Gjithashtu, krahas nënshkrimit të marrëveshjeve të reja, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të ndjekë dhe zbatojë marrëveshjet e nënshkruara më parë me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa që në vijim të menaxhimit të sistemit të burgjeve të reflektojë në kohë dhe hapësirë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që ndikojnë drejtë për së drejti në progresin e procesit të rehabilitimit dhe riintegritimit, duke sjellë një trajtim sa më dinjitoz për të dënuarit, nëpërmjet instrumenteve shpërblyese dhe vlerësuese të sjelljes së të dënuarve në mjediset e vuajtjes së dënimit. Ndërsa, për ata me rrezikshmëri të lartë, dhënia e lejeve shpërblyese të kufizohet ose përjashtohet plotësisht, pasi nuk plotësojnë kriteret e besueshmërisë dhe të sigurisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

21.1. Rekomandimet: Të hartohet një plan kombëtar (i përgjithshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) i menaxhimit të vendosjes së të dënuarve, duke ulur numrin (varësinë) e transferimeve. Të përmirësohet analiza e kapaciteteve të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale dhe balancimi i flukseve të të dënuarve ndërmjet tyre. Të rishikohet vendosja gjeografike e paraburgimeve dhe të paraburgosurve (dënuarve) në raport me gjykatat dhe prokuroritë për uljen e shoqërimeve të shpeshta. Të forcohet dokumentimi dhe standardizimi i arsytimit të transferimeve. Të rritet përdorimi i transferimeve për arsye të trajtimit shëndetësor dhe familjar, në përputhje me Ligjin nr. 81/2020. Të forcohet vlerësimi i riskut dhe profilit të të dënuarve në momentin e vendosjes në regjim, për të shmangur zhvendosjet korigjuese të mëvonshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

22.1. Rekomandimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të hartojë Planin e Auditimeve të vitit 2026 me bazë rrisht, duke vënë në objektiva

auditimin e sistemeve të menaxhimit financiar të aktiveve, dokumentimin e administrimin e tyre në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrë masa dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave dhe Drejtorinë e Trajnimeve në DPB të përfshijnë në kurrikulat e trajnimit të stafit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, tema me objekt administrimin e vlerave materiale e monetare dhe përgjegjësinë materiale në rast dëmtimi e abuzimi, duke i njohur ato me legjislacionin përkatës, gjë kjo që do rrisë ndjeshëm përgjegjësinë e stafit në përmbushjen e detyrave dhe do i ndërgjegjësojë ato, në përmbushjen e detyrave në përputhje me kërkesat ligjore dhe administrative e shmangur abuzimet.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.1. Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, duke pasur parasysh problematikat e konstatuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, të marrë masa për zgjidhjen e tyre dhe të kryejë emerimet e nevojshme të stafit drejtues. Po kështu, nëpërmjet një grupi pune të vlerësohen nevojat për ambiente shtesë, si dhe të gjenden rrugët ligjore, për investime të qëndrueshme për mjedise dhe për ngritjen e sistemeve të menaxhimit me siguri kibernetike, sipas standardeve që kërkohen, sikurse dhe të plotësohet stafi me pajisjet elektronike të kohës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.4. A sigurohet bashkëpunim dhe koordinim efektiv ndërmjet institucioneve përgjegjëse për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve?

Marrëveshje bashkëpunimi midis institucioneve qendrore përgjegjëse në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin.

Koordinimi ndërinstitucional midis institucioneve përgjegjëse në sistemin penitenciar përbën një shtyllë thelbësore në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin të të dënuarve me burgim, duke kontribuar drejtpërdrejt në humanizimin e vuajtjes së dënimit dhe garantimin e të drejtave të njeriut gjatë qëndrimit në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe pas lirit. Një ndër objektivat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për përmirësimin e trajtimit rehabilitues dhe riintegruar të personave të dënuar, ka qenë fuqizimi dhe krijimi i marrëdhënieve transparente dhe bashkëpunuese me të gjithë grupet e interesit si dhe me organizatat qeveritare dhe joqeveritare.

Marrëveshja e parë ndërinstitucionale ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe ish-MPÇSSHB(MSHMS), me afat 5 vjeçar, është nënshkruar në vitin 2009 dhe rinovuar në vitin 2014. Që prej vitit 2017 e në vijim, përgjegjësitë për punësimin, formimin profesional dhe arsimin e mesëm profesional janë transferuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE sot ME). Kjo marrëveshje, bashkëpunimit të së cilës i ka kaluar afati, nga viti 2022-2023, nuk garantoi koordinim ndërinstitucional dhe solli si pasojë mungesën e përgjigjeve zyrtare ndaj kërkesave për bashkëpunim drejtuar Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional dhe Punësimin (DRFPP) për rifillimin dhe implementimin e kurseve profesionale. Kjo shtoj referimin e rasteve të të burgosurve të interesuar për ndjekjen e kurseve profesionale në IEVP-të.

Në zbatim të Ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, nisën përpjekjet e para për hartimin e një udhëzimi të përbashkët ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe ME për Arsimin dhe Formimin Profesional, të cilat u finalizuan me miratimin e Udhëzimit nr.5, datë 24.06.2024 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zhvillimin e arsimit dhe formimit profesional të personave të dënuar me burgim në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”.

Menjëherë pas miratimit të udhëzimit, ka filluar puna për nënshkrimin e marrëveshjes së re të bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive. Më datë 27.08.2024, me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është përcaktuar grupi i punës përgjegjës për hartimin e draft-marrëveshjes ndërinstitucionale. Ky proces, i mbartur prej vitesh, është finalizuar me miratimin e

Marrëveshjes së Bashkëpunimit në funksion të arsimit dhe kurseve të formimit profesional të burgosurve, midis MD (DPB) Nr. 2650 prot., datë 30.10.2024 dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) nëpërmjet AKPA nr. 17028 prot., datë 29.10.2024.

Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së mësipërme, IEVP-të, kanë referuar vështirësi proceduriale⁸⁷, gjë e cila nuk ishte bërë më parë, për shkak të mungesës së tyre. Në miratimin e marrëveshjes AKPA-së dhe DPB-së janë dy institucionet përgjegjëse për planifikimin, organizimin dhe monitorimin e procesit të formimit profesional në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive koordinon procesin e planifikimeve tremujore dhe vjetore të kurseve të formimit profesional në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP), duke u bazuar në kërkesat e të dënuarve dhe në kapacitetet teknike të IEVP-ve. Këto kapacitete lidhen kryesisht me ekzistencën dhe funksionalitetin e kabineteve praktike, pasi formimi profesional zhvillohet në masën 80% praktik dhe vetëm 20% teorik.

IEVP-të mbledhin kërkesat e të dënuarve, në përputhje me kabinetet praktike që kanë në dispozicion, dhe i përcjellin ato qendrave publike të formimit profesional për planifikim dhe organizim të mëtejshëm.

Problematikat e formimit profesional në IEVP-të.

Gjatë periudhës objekt auditimi, formimi profesional në IEVP ka patur problematika, të cilat janë kushtëzuar më së shumti nga koordinimi jo i mjaftueshëm ndërmjet institucioneve dhe motivimi jo i kënaqshëm i të burgosurve për t'u përfshirë në këtë proces, si dhe nga aspekte infrastrukturore, buxhetore, etj.

Gjatë periudhës 2021-2023, kurset profesionale janë ofruar respektivisht: në vitin 2021 në 6 IEVP⁸⁸ të cilat janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga 259 të burgosur, në vitin 2022 në 6 institucione IEVP dhe janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga 198 të burgosur dhe në vitin 2023 po në 6 institucione IEVP mbështetur në kërkesat e të burgosurve, hapësirat fizike dhe bazën materiale që disponojnë disa institucione, vetëm 27 % e të burgosurve kanë shfaqur interes për ndjekjen e të paktën një kursi profesional. Kjo tregon mungesën e vlerësimeve në vite mbi personat që vuajnë dënime dhe mosreferimin e saktë të rasteve të të burgosurve të interesuar për ndjekjen e kurseve profesionale në IEVP⁸⁹.

Me miratimin e Udhëzuesit të Përbashkët Nr. 5, Prot, datë 24.06.2024⁹⁰ ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si dhe miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit më 23 Tetor 2024 ndërmjet DPB – AKPA Nr. 17028, Prot, datë 29.10.2024, në zbatim të tij, u bë e mundur ofrimi i procesit të formimit profesional në 10 IEVP në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional. Në këtë proces është referuar dhe adresimi i gjetjeve dhe vështirësive të hasura në ofrimin e shërbimeve gjatë këtyre viteve, për secilin nga institucionet përgjegjëse.

Dhe pse mund të thuhet se është rritur numri i IEVP-ve që zhvillojnë kurse, përsëri ka problematika proceduriale⁹¹ në aspektin e bashkëpunimit ndërinstytucional, si më poshtë vijon:

- Vështirësi për shkak të kriterit të plotësimit të dosjes personale të të burgosurve me dokumentin / vërtetim lëshuar nga autoritetet arsimore në kuadër të nivelit arsimor përkatës;
- Vështirësi për sigurimin e transportit të instruktorëve që do të zbatojnë kurset profesionale në IEVP në rastet e largësisë së konsiderueshme së IEVP nga DRFPP;
- Vështirësi për sigurimin e infrastrukturës të përshtatshme dhe të mjaftueshme (ambiente) për realizimin e procesit të formimit profesional në IEVP;

⁸⁷ Ndryshe nga më parë

⁸⁸ Nga 10 IEVP gjatë vitit 2020

⁸⁹ Pranë institucioneve përkatëse shtetërore përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të formimit profesional


⁹⁰ Udhëzuesi i Përbashkët Nr. 5, Prot, datë 24.06.2024 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional të personave të dënuar me burgim që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”;

⁹¹ Ndryshe nga më parë

- Vështirësi për sigurimin e instruktorëve për zhvillimin e kurseve;
- Mungesë mbështetje nga autoritetet arsimore, gjatë përpilimit të dokumentacionit përkatës shkollor të të burgosurve si një dokument i domosdoshëm, për regjistrimin e të burgosurve në kurs;
- Mungesa e një buxheti të dedikuar për formimin profesional të të burgosurve ka bërë që ky proces të zhvillohet vetëm në nivel teorik dhe kjo ka sjellë për pasojë mungesë interesi për frekuentim nga të burgosurit, etj.

Nga informacioni i vënë në dispozicion⁹², vihet re shmangie nga detyrimet institucionale të marrëveshjes në planifikimet tremujore dhe vjetore, si edhe në organizimin e procesit të formimit profesional në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, për arsye subjektive dhe objektive.

Grafiku nr.6. Numri i IEVP ku u zhvilluan kurse të formimit profesional 2022-2024



Burimi: Të dhëna të marra nga DPB
Përpunoi: GA

- Gjatë periudhës 2022-2024, numri mesatar i të burgosurve që kanë frekuentuar kurset profesionale, paraqitet në tabelën dhe grafikun më poshtë:


Tabela nr. 14 Numri mesatar i të burgosurve që kanë frekuentuar kurset profesionale 2022-2024

Viti	2022	2023	2024
Mesatare të burgosurish	198	240	153

Burimi: Të dhëna të marra nga DPB
Përpunoi: GA

⁹² Përgjigje e pyetësorëve dhe MEMO drejtuar eprorëve

Grafiku nr. 6.1 Numri mesatar i të burgosurve që kanë frekuentuar kurset profesionale 2022-2024



Burimi: Të dhëna të marra nga DPB

Përpunoi: GA

Siç vihet re, gjatë periudhës 2022-2024, numri i IEVP-ve ku janë zhvilluar kurse profesionale, si dhe numri mesatar i të burgosurve që kanë frekuentuar kurset profesionale, ka qenë i ulët. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve gjatë vitit 2023 ka parashikuar zgjerimin e kurseve profesionale në IEVP, në bashkëpunim me ME, por kjo nuk është realizuar. Në përgjigjet e pyetësorëve, eprorët e DPB shprehen se: “Sa lidhet me *interesin e ulët të të dënuarve për ndjekjen e kurseve profesionale*, kjo ka ardhur për faktin se për arsye *buxhetore (mungesë fondesh)* kurset profesionale janë zhvilluar vetëm në nivel teorik dhe jo praktik. Për të adresuar këtë ngërç në vitin 2023, është kryer një proces vlerësimi të preferencave të të burgosurve për të ndjekur kurse të caktuara, sipas listës së kurseve profesionale që ofrohen nga AKPA dhe institucionet e saj të varësisë. Në përfundim të këtij procesi u përzgjedhën 6 kurse si më të preferuara, referuar edhe numrit të konsiderueshëm të të burgosurve që kishin bërë përzgjedhjen. Rezultatet e këtij procesi u referuan përmes Memo nr.13588 prot., datë 23.10.2023, me objekt “*Kërkesë për alokim fondesh me qëllim realizimin e punishteve të aftësimit profesional për të burgosurit në IEVP*”. Qëllimi ishte që alokimi i buxhetit të bëhej për vitin pasardhës buxhetor. Kërkesa për alokim fondesh me qëllim realizimin e punishteve të aftësimit profesional për të burgosurit në IEVP, është përsëritur përmes memos nr.1400/1 prot., datë 13.02.2025, kërkesë e cila do të adresohet përmes programit buxhetor të DPB për vitin 2026.”

Sa lidhet me mungesën e mbështetjes nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, prej vitit 2021 kanë nisur përpjekjet e DPB për rivitalizimin e bashkëpunimit ndërministror në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë për formimin profesional në burgje, gjë e cila është finalizuar në Tetor 2024, me nënshkrimin e marrëveshjes bashkëpunimit ndërmjet Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me Nr. 2650 Prot., datë 30.10.2024.

Bazuar në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, Strategjinë Ndërsektoriale për të Miturit, si dhe objektivat dhe prioritetet e vendosura në Planin Vjetor të Punës së Drejtorisë së Çështjeve Sociale për vitin 2023, sa lidhet me optimizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese për shtetasit në konflikt me ligjin, komponenti i formimit profesional, zë një vend tejet të rëndësishëm, në funksion të implementimit të planit individual të dënimit. Ky plan zhvillohet në bashkëpunim me AKPA/ Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional, përmes programeve të posaçme të aftësimit profesional.

Në institucionet e vuajtjes së dënimit siç janë p.sh. IEVP: Burrel, Lushnje, “Mine Peza”, “Jordan Misja”, Kukës, QSB, Rrogozhinë, “Ali Demi”, Tepelenë, me infrastrukturë të vjetër, kanë munguar ambientet e dedikuara për një veprimtari të tillë, siç është procesi arsimor apo

kurset e kualifikimit profesional, pasi këto burgje të ndërtuar dekada më parë, me kushte të kufizuara hapësinore dhe me një koncept të vjetër të dënimit, ku fokusi ishte vetëm në izolimin e individit dhe jo në riintegrimin e tij në shoqëri. Burgjet e reja janë projektuar me një qasje që ka në fokus dhe krijimin e kushteve të duhurra për rehabilitim – riintegrimin e të burgosurve. Lidhur me inkurajimin e pjesëmarrjes së të burgosurve në kurset profesionale, evidentojmë se informimi i të burgosurve lidhur me këtë proces në funksion të rehabilitimit të tyre dhe përgatitjes për liri, si dhe mbështetja psiko-emocionale është një nga detyrat themelore të punës së sektorit psiko-social.

Në të njëjtën kohë, neni 45, i ligjit nr. 81/2020, sanksionon: “*Arsimimi dhe formimi kulturor e profesional bëhen me anë të organizimit të programeve arsimore, si dhe të kurseve profesionale, sipas legjislacionit në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar dhe legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.*”

Fuqizimi i procesit të formimit profesional në nivel sistemi, për të burgosurit në I EVP, kërkon ndërmarrjen e një procesi vitalizimi të punishteve/laboratorëve të formimit profesional, veçanërisht në ato I EVP ku infrastruktura për zhvillimin e këtij procesi, ekziston, dhe ku kurset profesionale zhvillohen, ndonëse vetëm në nivel teorie, për shkak të mungesës së bazës së plotë materiale, sikundër dhe hapja e Workshop-eve të rinj, aty ku nuk ka.

Problematikat e procesit arsimor në I EVP-të.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për hartimin e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit, ka nisur procedurat që në vitin 2021, konkretisht:

- Me shkresë Nr.4463 Prot., datë 29.04.2021 “Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional për zbatimin në praktikë të së drejtës për arsimim të të burgosurve” drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, për dijeni Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka kërkuar një takim ndërinstitucional për të diskutuar me detaje problematikat dhe vështirësitë e procesit dhe për të gjetur zgjidhje adekuate.
- Në vijim të diskutimeve nga takimi i punës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në nëntor të vitit 2021 i ka dërguar MAS draft Marrëveshjen e Bashkëpunimit, duke synuar implementimin e kësaj marrëveshje në të gjitha I EVP-të.
- Në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë, me datë 26.07.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar relacion mbi Projekt-Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, draft Udhëzimin e përbashkët MD-MAS “Për rregullimin e procesit arsimor në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, si dhe draft Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet MD dhe MAS.

Në zbatim të së drejtës për arsim të shtetasve në konflikt me ligjin, pas një procesi të tejzgjatur, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit⁹³ Nr. 3414/1 prot, datë 18.06.2024, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Gjatë vitit 2022 procesi arsimor formal, është zhvilluar në 11 institucione zbatimi vendimeve penale, në vitin 2023 procesi arsimor është zhvilluar në 10 I EVP, dhe në 2024 në 13 I EVP, konkretisht: në I EVP Rrogozhinë, Vlorë, Pojskë, Korçë, Peqin, Shkodër, Kavajë, Fushë-Krujë, “Jordan Misja”, dhe së fundmi gjatë muajit Dhjetor 2024 ka nisur procesi arsimor në I EVP Fier, I EVP Berat, I EVP Lushnjë dhe I EVP “Mine Peza” Tiranë.

Gjatë periudhës objekt auditimi procesi arsimor në disa I EVP është zhvilluar formalisht . Ka disa I EVP që nuk e kanë nisur fare procesin arsimor, dhe kjo për shkak dhe të mosfunksionimit të marrëveshjes ose dhe mospërmbushjes të një detyrimi të marrëveshjes së bashkëpunimit me MAS.

Përveç 3 institucioneve ku procesi arsimor nuk mund të aplikohet për shkak të specifikave të tyre (I EVP “Ali Demi”, I EVP Lezhë dhe QSB), nuk është implemetuar procesi arsimor në I EVP Durrës, Tepelenë dhe Kukës. Sa i përket I EVP Kukës dhe I EVP Tepelenë, mungojnë hapësirat e dedikuara për zhvillimin e këtij procesi, si dhe nuk plotësohet numri i personave për të krijuar klasa mësimore, (minimalisht 7 persona për klasë). Sa i përket I EVP Durrës

⁹³ Protokolluar në MAS Nr. 4137/2 prot, datë 18.07.2024

pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të iniciuar procesin, dhe takimeve dhe shkresave të dërguara për të adresuar këtë ngërç, DPB shprehet se nuk ka marrë ende përgjigje zyrtare nga ZVA Durrës. Kjo vonesë në sigurimin e dokumentit të përfundimit të shkollës, është konstatuar dhe në Zyrat Vendore Arsimore, gjë e cila ka ndikuar në mos nisjen e procesit arsimor në disa IEVP.

Mungesa e bashkëpunimit nga ana e autoriteteve rajonale arsimore⁹⁴, me IEVP-të, pa përjashtuar këtu, numrin e vogël të të burgosurve që kanë shprehur interes për të ndjekur procesin arsimor, duke marrë në konsideratë specifikat infrastrukturore të institucionit dhe niveli i mbipopullimit⁹⁵, (IEVP Tepelenë, Kukës, Burrel) si dhe mungesën e ambienteve të përshtatshme infrastrukturore në IEVP⁹⁶, janë arsytet që disa IEVP-ve nuk kanë nisur procesin arsimor.


Gjatë periudhës 2022-2024, numri i IEVP-ve ku është zhvilluar procesi arsimor në 4 vitet arsimorë 2021-2024, paraqitet në tabelën dhe grafikun më poshtë:

Tabela nr.14.1 Numri i IEVP-ve ku u zhvillua procesi arsimor ndër vite 2021-2024

Viti	Nr. i IEVP-ve ku u zhvillua arsim
2021-2022	9
2022-2023	11
2023-2024	10
2024-2025	13

Burimi: Të dhëna të marra nga DPB Përpunoi GA

Grafiku nr.6.2 Numri i IEVP-ve ku u zhvilluaprocasi arsimor 2021-2024



Gjatë periudhës 2022-2024, numri mesatar i të burgosurve që kanë frekuentuar procesin arsimor, paraqitet si në tabelën dhe grafikun më poshtë:

Tabela nr. 14.2 Numri mesatar i të burgosurve që kanë frekuentuar procesin arsimor 2022-2024

Viti	2022	2023	2024
Nr. të burgosurve	198	240	170

Burimi: Të dhëna të marra nga DPB


Përpunoi GA

⁹⁴ IEVP Durrës, Elbasan,

⁹⁵ IEVP Tepelenë, Kukës, Burrel

⁹⁶ Në IEVP "Ali Demi", QSB dhe IMP Lezhë arsimit nuk aplikohet për shkak të specifikave të këtyre institucioneve.

Grafiku nr.6.3 Numri mesatar i të burgosurve që kanë frekuentuar procesin arsimor 2022-2024



Burimi: Të dhëna të marra nga DPB

Përpunoi GA

Gjatë periudhës 2022-2024, procesi arsimor sipas muajve gjatë viteve 2022 deri 2024, paraqitet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Tabela nr. 14.3 Arsimi sipas muajve gjatë viteve 2022 deri 2024

Muaji Viti shkollor	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2021-2022	143	205	164	139	135	185	159	138	143	128
2022-2023	158	170	167	188	180	178	175	174	170	145
2023-2024	155	181	182	175	177	167	171	152	146	134
2024-2025	126	120	143	150	161	153	142	136	131	130

Burimi: Të dhëna të marra nga DPB

Përpunoi: GA

Siç vihet re nga sa më sipër, gjatë periudhës 2022-2024, numri i IEVP-ve ku është zhvilluar procesi arsimor si dhe numri mesatar i të burgosurve që kanë frekuentuar procesin arsimor, si gjatë muajve dhe viteve, ka qenë i ulët.

Në disa IEVP, si dhe në strukturat përgjegjëse përkatëse, gjatë përpilimit të dokumentacionit përkatës shkollor të të burgosurve si një dokument i domosdoshëm, nuk pasqyrohen të dhënat lidhur me ndërprerjen e procesit arsimor për shkak të transferimit, mosndjekjen e procesit arsimor nga fillimi i vitit shkollor dhe shpeshherë ka munguar informacioni nga MAS, gjatë hapjes së vitit të ri shkollor. Gjithashtu mungojnë dokumentacionet përkatëse si, regjistrat e arsimimit, regjistrat e kurseve profesionale, etj.

Siç konstatohet, nga informacioni i vënë në dispozicion, megjithë përpjekjet e vazhdueshme për mundësinë e arsimimit të të burgosurve dhe aftësimin e tyre profesional, numri i të burgosurve përfitues deri tani është i ulët. Arsimimi nuk është një aktivitet sistematik, nuk ka qëndrueshmëri, nuk ka interes të mjaftueshëm.

Mangësitë e dokumentimit dhe ndikimi në referimin e rasteve.

Bazuar në nenin 12 të Ligjit nr. 81/2020, janë hartuar dokumentacioni(planet individuale të trajtimit, ndryshimi i tyre si pasojë e përshtatjes së përparimit të arritur nga IEVP-të) për

procesin e përgatitjes për riintegrim të personave të dënuar gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirimit.

IEVP-të në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat jofitimprurëse kanë hartuar programe rehabilitimi dhe programe riintegrimi praglirimi për adresimin e nevojave të posaçme të secilit të burgosur⁹⁷.

Nga informacioni dhe verifikimi në terren⁹⁸, analizat e nevojave aktuale të të burgosurve për planifikimin para lirimit, mbështetjen pas lirimit në nivel lokal dhe kombëtar, programet e individualizuara për përgatitjen e lirimit të hartuara për të gjithë të burgosurit sipas nevojave të tyre, për të mbështetur rehabilitimin dhe përgatitjen e tyre për lirim, janë kryer vetëm prej IEVP-ve. Nuk ka patur bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse, të cilat duhet të bëjnë më tej dhe gjurmimin e tyre pas lirimit, përfshirë dhe punësimin.

Për adresimin/referimin e rasteve për riintegrim pas lirimit të të burgosurve, secili prej të dënuarve duhet të ketë të plotë dokumentacionin përkatës, dosjen personale të të burgosurve me dokumentin / vërtetim lëshuar nga autoritetet arsimore në kuadër të nivelit arsimor përkatës, formimin profesional, vlerësimin psikosocial dhe opinionet të gjithë aktorët e përfshirë në proces.

Një pjesë e madhe e ish të dënuarve, nuk kanë aftësi të përditësuara pune ose përvojë pune përkatëse, pasi burgjet e Shqipërisë nuk u kanë ofruar mundësi punësimi të burgosurve, përveç disa shërbimeve të brendshme.

Punësimi është një nga faktorët kyç në riintegrimin e suksesshëm të ish-të burgosurve, por shanset e punësimit për këtë kategori kanë qenë të reduktuara⁹⁹, pasi dhe trajtimi i tyre nuk gjen mbështetje të plotë ligjore, si kategoritë e tjera të veçanta/vulnerabël. Të dhënat e punësimit mungonte planifikimi mujor i punës, organika e punës, kontratat e firmosura nga titullari për të dënuarit e punësuar etj.

Në pikën 4 të nenit 3 të Ligjit Nr. 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”, në punësimin e personave nga grupe të veçanta, ish të burgosurit janë punëkërkuar të disavantazuar në tregun e punës, si citojmë: “...e) persona që kanë vuajtur dënimin me burgim, apo ndaj të cilëve është vendosur pezullimi i vendimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me një dënim alternativ”.

Të burgosurit në ligjin për nxitjen e punësimit,¹⁰⁰ nuk përmenden si kategori në nevojë për punësim, por konsiderohen të papunë, jo klientë të Zyrrave të Punës. Ky ligj nuk ka asnjë parashikim në kuadër të trajtimit të të dënuarve me burgim, gjë e cila konstatohet dhe në analizat vjetore të AKPA, periudha 2022-2024, kur bëhet fjalë për punësim sipas kategorive të veçanta, që janë: Punëkërkuar të papunë me aftësi të kufizuar, romë /egjiptianë dhe ndihmë ekonomike, por nuk përmendet kjo kategori.

Referuar në sa më sipër, në AKPA nuk ka një informacion të plotë për rastet e analizuara dhe adresuara për zgjidhje pranë institucioneve përkatëse për personat e dënuar, gjatë periudhës objekt auditimi.

Në kuptimin e Ligjit nr. 81/2020, të dënuarit nuk vlerësohen në kushte vulnerabiliteti, dhe për këtë arsye planet individuale, janë hartuar nga IEVP-ve dhe ofrohet prej tyre ose në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për shërbimet e arsimit, formimit profesional, punësimit dhe organizatat jofitimprurëse. Plani individual i trajtimit mund të ndryshojë, duke iu përshtatur përparimit të arritur dhe rrethanave të tjera. Sipas tip marrëveshjeve të bashkëpunimit citohet: “.....I burgosuri inkurajohet që të bashkëpunojë në realizimin e programeve dhe aktiviteteve riedukuese në institucion.”¹⁰¹

⁹⁷ Ligji nr.81/2020, Neni 12 pika 3

⁹⁸ Përgjigje e pyetësorëve dhe intervistat në IEVP

⁹⁹Përgjigje pyetësorëve të DPB

¹⁰⁰ Ligji Nr. 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”

¹⁰¹ Përgjigje pyetësorëve të DPB

Mostrajtimi i tyre si grup vulnerabël, ose grup i veçantë në shoqëri, ka sjellë mungesën e programeve post-penale, të individualizuara.

Në Ligjin 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Neni 6: “Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, pika 1 “Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshijnë këto grupe shoqërore” germa d, citohet: “....të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri.” dhe Neni 7. “Kategoritë që nuk përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror”, germa ç) personat që vuajnë dënim me heqje lirie, me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Bazuar në nenin 12 pika 3 të Ligjit nr. 81/2020, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nga viti 2023, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 11 njësi të vetëqeverisjes vendore¹⁰² të cilat kanë si qëllim vendosjen e një bashkëpunimi të ndërsjelltë për koordinimin e punës dhe përcaktimin e roleve e përgjegjësi reciproke. Këto marrëveshje janë për riaftësimin dhe riintegrimin në shoqëri të personave të burgosur, duke i përfshirë në programet sociale vendore e në projekte të ndryshme sociale, që ofrojnë Bashkitë dhe në Qendrat Komunitare, në bashkëpunim me organizata jo qeveritare, shoqërinë civile, institucione arsimore, institucione fetare, si dhe krijimin e rrjeteve të operimit në nivel lokal dhe kombëtar për adresimin/referimin e nevojave aktuale të burgosurve për planifikimin para lirimit dhe mbështetjen pas-lirimit. Gjatë periudhës kohore 2023-2024, janë organizuar takime ndër-institucionale pranë IEVP-ve: “Durrës; Lushnjë; Rrogozhinë; Berat; Shkodër; “Ali Demi” Nr. 325, IEVP Lezhë, ku kanë marrë pjesë dhe përfaqësues të shërbimit social pranë pushtetit vendor, si dhe Qendra për Parandalimin e Krimit të të Miturve dhe të Rinjve, për referimin e rasteve të të dënuarve pranë bashkive dhe agjencive shtetërore.

Në funksion të masave për ri-integrimin e të dënuarve, përgjatë vitit 2022, janë referuar pranë 32 bashkive dhe agjencive të tjera shtetërore 288 të dënuar¹⁰³ por pa raste sukseesi, përgjatë vitit 2023 janë referuar¹⁰⁴ dhe 115 të dënuar gjatë 2024, prej të cilave 37 janë raste sukseesi. Rastet e suksesit nuk janë gjurmuar dhe nuk ka të dhëna më tej për integrimin e personave të liruar, pasi kjo nuk ka një referencë ligjore se cili institucion e kryen këtë proces.

Nga ky proces referimi nga ana e IEVP-ve, gjatë 2024 janë administruar 37 “Kthim Përgjigje” pozitive sa lidhet me nevojat e referuara nga ana e IEVP-ve respektive. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i të dënuarve të referuar, si dhe 10 ish të dënuar të cilësuar si raste sukseesi, në termat e nevojave të plotësuara nga ana e tyre, sipas shkresës zyrtare dërguar nga ana e IEVP-ve.

Tabela Nr. 15. Numri i të dënuarve të referuar sipas IEVP-ve gjatë periudhës 2022-2024

Nr.	IEVP	Raste referimi	Kthim Përgjigje	Raste Sukseesi
1.	IEVP “Pojskë”	2	-	-
2.	IEVP “Jordan Misja”	-	-	-

¹⁰² Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Tiranë, më datë 10.10.2023;

Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Korçë, më datë 23.10.2024;

Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Durrës, më datë 25.10.2024;

Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Rrogozhinë, më datë 25.11.2024;

Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Vlorë, më datë 23.12.2024;

Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Selenicë, më datë 24.12.2024;

Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Kukës, më datë 08.01.2025;

Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Has, më datë 26.12.2024;

Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Tropojë, më datë 26.12.2024;

Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Elbasan, më datë 17.09.2024;

Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Kamzë, më datë 28.07.2025

¹⁰³ Shkresat në këtë kuadër, viti 2022 (administruar në hard copy)


¹⁰⁴ Shkresat në këtë kuadër, viti. 2023 (administruar në hard copy)

3.	IEVP “Mine Peza”	-	-	-
4.	IEVP “Fier”	-	-	-
5.	IEVP “Durrës”	4	3	2
6.	“IM Kavajë”	27	7	2
7.	IEVP “Elbasan”	-	-	-
8.	IEVP “Vlorë”	5	3	2
9.	IEVP “Berat”	9	-	-
10.	IEVP “Tepelenë”	4	-	-
11.	IEVP “Burrel”	7	2	-
12.	IEVP “Peqin”	2	-	-
13.	IEVP “Kukës”	2	-	-
14.	IEVP “Shkodër”	-	-	-
15.	IEVP “Korçë”	14	3	-
16.	IEVP “Rrogozhinë”	8	3	1
17.	IEVP “Lezhë”	3	3	3
18.	IEVP “Lushnje”	25	13	-
19.	IEVP “Fushë – Krujë”	3	-	-
20.	QSB	-	-	-
21.	Totali	115	37	10

Burimi: Të dhëna të marra nga DPB

Përpunoi: GA

Grafiku nr. 7 Numri i të dënuarve të referuar gjatë periudhës 2022-2024



Bazuar në Ligjin nr.81/2020, kompetencë e autoriteteve të ekzekutimit të vendimeve penale është referimi pranë pushtetit vendor dhe agjencive të tjera, por duhet theksuar që pranë IEVP-ve janë referuar të dënuar - pjesë e kategorive vulnerabël, si dhe që kanë dhënë dakordësinë për t’u referuar pranë instancave.

Siç vihet re nga tabela, rastet e referuara për periudhë 2022-2024 nga IEVP-të pranë NJVQV-ve, për të cilat nuk ka një regjistër më vete, *rezultojnë në shumë pak raste suksesi*. Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” nuk i ngarkon bashkitë me detyrimin për të pasur programe të posaçme për ish-të dënuarit. Bashkitë nuk kanë strukturë dedikuar për riintegrim. Gjatë vitit 2023, DPB ka hartuar një plan lidhur me zhvillimin e takimeve ndërinstytucionale si dhe aktiviteteve me tërë aktorët relevantë në komunitet: Bashki, Shërbim Prove, Polici e Shtetit, dhe Qendra për Parandalimin e Krimit të të Miturve dhe të Rinjve, shoqëri civile, etj¹⁰⁵. Në të gjithë sistemin e burgjeve, zhvillohen aktivitete social edukative .Aktivitetet e zhvilluara si dhe numri mesatar i të burgosurve që ndoqën këto aktivitete për periudhën 2022-2024 është si më poshtë vijon:

Gjatë vitit 2022 numri i aktiviteteve social-edukative të organizuara mesatarisht në muaj me të dënuarit/të paraburgosurit në IEVP është 338. Numri mesatar i të burgosurve që kanë ndjekur gjatë muajit aktivitetet sportive në institucion është 3521 shtetas.

¹⁰⁵ Informacioni i dorëzuar në pyetësor

Gjatë periudhës vitit 2023 numri i aktiviteteve social-edukative të organizuara mesatarisht në muaj me të dënuarit/të paraburgosurit në IEVP është 343. Numri mesatar i të burgosurve që kanë ndjekur gjatë muajit aktivitetet sportive në IEVP-të, është 3428.

Gjatë vitit 2024 numri i aktiviteteve social-edukative të organizuara mesatarisht në muaj me të dënuarit/të paraburgosurit në IEVP është 308.


Tabela nr. 15.1: Numri i të burgosurve të përfshirë në aktivitete social-edukative 2022-2024

Viti	2022	2023	2024
Numër i pjesëmarrësve	3521	3428	3214

Burimi: Të dhëna të marra nga DPB
Përpunoi:GA

Në proceset e rehabilitimit dhe riintegritimit të personave të dënuar, referuar bashkëpunimit ndërinstitucional, konstatohen disa faktorë pengues në aktivitetet e shërbimit psiko-social, edukativ, e cila reflektohet në numrin e vogël të të burgosurve të përfshirë në to, si në grafikun më poshtë:

Grafiku nr. 7.1 Numri i të burgosurve të përfshirë në aktivitete social-edukative, periudha 2022-2024



Siç vihet re nga tabela dhe grafiku, numri i të burgosurve të përfshirë në aktivitetet social-edukative, në sistemin e burgjeve, gjatë periudhës 2022-2024 është i ulët. Numri i ulët i të burgosurve të përfshirë në aktivitetet social edukative, ka ardhur si rezultat i mungesës së bashkëpunimit gjatë përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm të të burgosurve, si një evidencë kriter për përfshirje në këto aktivitete, si edhe me mungesa e zërit në buxhet për krijimin e Workshopeve në IEVP. (Bashkitë, Shërbim Prove, Polici e Shtetit, dhe Qendra për Parandalimin e Krimin të të Miturve dhe të Rinjve, shoqëri civile, etj) ¹⁰⁶. Gjithashtu, në disa IEVP nuk ka regjistër për aktivitetet e realizuara.

Dhe pse qëllimi i këtyre aktiviteteve ka qenë fuqizimi i network-ut dhe mekanizmit të referimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim lehtësimin e riintegritimit të të dënuarve në komunitet, sukcesi i vogël i rasteve në vitet 2022-2024 dëshmon për një punë jo të konsiderueshme që është zhvilluar në cilësinë e asistencës post-penale në kuadër të lehtësimit të riintegritimit të këtyre shtetasve.

Monitorim jo sistematik i proceseve arsimore dhe formimit profesional në IEVP-të.

Marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet AKPA dhe DPB, ka përcaktuar dy institucionet përgjegjëse për komunikimin, monitorimin në mënyrë të vazhdueshme, si dhe shkëmbimin e çdo informacioni të nevojshëm për përmbushjen e angazhimeve të tyre. Komunikimi është kryer në formë shkresore dhe/ose nëpërmjet postes elektronike. Personat e kontaktit, që kanë

¹⁰⁶ Informacioni I dorëzuar në pyetësor

qenë përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, nuk kanë organizuar të paktën tri takime të përbashkëta në vit, për të analizuar ecurië e procesit të formimit profesional, për të planifikuar aktivitetet në vijim dhe për të marrë masat e nevojshme për zbatimin e detyrimeve ligjore të paleve¹⁰⁷. Palët duhet të informonin rregullisht njëri tjetrin, por kjo ka qenë më e konkretizuar na DPB, se sa nga AKPA, për shkak dhe të ngërçit ligjor të përmendur më sipër, si dhe të mosfunksionimit të marrëveshjes deri në vitin 2023. Në kuadër të marrëveshjes së Tetorit midis DPB dhe AKPA, janë zhvilluar takime konsultative për përmirësimin e procedurave për të ardhmen, gjithmonë duke respektuar kërkesat e ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për rnbrotjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Gjatë periudhës objekt auditimi, vihet re një shmangie nga detyrimet e marrëveshjeve në aspektin e komunikimit dhe monitorimit të procesit të formimit profesional në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, nga institucionet përgjegjëse, për arsye objektive dhe subjektive.

DPB-ve ka kryer inspektime pranë I EVP-ve, konkretisht: gjatë vitit 2022 - 10 inspektime, gjatë vitit 2023 - 16 inspektime dhe gjatë vitit 2024 - 22 inspektime. Për secilin proces inspektimi janë hartuar memot përkatëse dhe në fund është hartuar një memo e përgjithshme përmes së cilës janë parashtruar disa rekomandime për marrje masash në kuadër të heqjes së disa prej përgjegjësive të cilat nuk korrespondojnë me kompetencën e Drejtoria e Çështjeve Sociale(DCS) në DPB, si dhe që afektojnë punën dhe efikasitetin e tyre në institucion¹⁰⁸. Në raportet e inspektimeve të DCS janë parashtruar disa rekomandime për marrje masash në kuadër të heqjes së disa prej përgjegjësive të cilat nuk korrespondojnë me kompetencën e DCS, si dhe që kanë afektuar punën dhe efikasitetin e tyre në institucion. Por, në përshkrimet e punës së DCS, tek detyrat teknike përcaktohen dhe që kjo drejtori kryhen dhe çdo detyrë tjetër të caktuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk disponon raport monitorimi të cilësisë së mësimdhënies në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Qendrat e Formimit Profesional pranë AKPA, kanë për detyrë të raportojnë çdo muaj mbi zhvillimin dhe cilësinë e mësimdhënies në kurset e realizuara të formimit profesional, pranë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP). Këto qendra nuk kanë zhvilluar rregullisht monitorimin e në përputhje të plotë me standardet dhe kërkesat e arsimit dhe formimit profesional (AFP), implementimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstytucional për raportimin, organizimin e inspektimeve të përbashkëta, si dhe analizimin e hollësishëm të progresit dhe rezultateve të tyre.¹⁰⁹

Në qendrat e formimit profesional nuk ka ekzistur një pozicion specifik në strukturë që i dedikohet formimit profesional në IEVP. Ky rol është ndjekur nga përgjegjësi i njësisë së zhvillimit, i cili, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit, është përgjegjës për koordinimin e këtij procesi. Për më tepër, në secilin institucion publik ofruet të formimit profesional, është autorizuar një person përgjegjës për trajtimin e dosjeve të aplikantëve duke përfshirë formularët e aplikimit, plotësimin e kriterëve sipas kurrikulave, regjistrimin në sistem, si dhe monitorimin e regjistrave elektronikë, kjo pasi përmbajnë informacion sensitive.

Mungesë bashkëpunimi me operatorët ekonomikë.

Në planin e punës së vitit 2023 të DPB-së, në objektivin nr.3 është përcaktuar, hartimi i marrëveshjeve me OE për punësimin e të dënuarve (Rrogozhinë, Shkodër, Fier etj). Janë nënshkruar dy Marrëveshje Bashkëpunimi me dy operatorë ekonomikë privatë "Pro Eksport Albania" dhe "Efa Solution", në kuadër të punësimit të të dënuarve, por operatorët janë

¹⁰⁷ Neni 5 i marrëveshjes

^PPërgjigje pyetësori

¹⁰⁹ Neni 5 i marrëveshjes. Përgjigje pyetësori

tërhequr që në hapat e parë të bashkëpunimit, për shkak të risqeve operacionale dhe financiare që ata vlerësonin se do të hasnin në këtë kuadër.

Me miratimin e VKM-së për procedurat e punësimit dhe të shpërblimit të dënuarve, si një mbështetje e plotë nga ana ligjore e procesit, janë punësuar me kontratë rreth 500 të dënuar, nga të cilët 56 të burgosur, janë të punësuar nga operatori ekonomik që është kontraktuar për furnizimet e të burgosurve. Komuniteti i biznesit është aktor në procesin e ri-integrimit, për sa i përket trajnimit në vendin e punës dhe punësimit të shtetasve në konflikt me ligjin. *Si trajnimi dhe punësimi, janë dy format më të qëndrueshme të ri integrimit të shtetasve në konflikt me ligjin.*

Nga informacioni i vënë në dispozicion¹¹⁰, pothuajse nuk është realizuar asnjë nismë për punësimin e të burgosurve nëpërmjet OE, kompanive, apo vetëpunësim, as jashtë dhe as brenda institucionit.

24. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, me objekt planifikimin dhe organizimin e procesit arsimor dhe formimit profesional në institucionet e ekecutimit të vendimeve penale, nuk është garantuar koordinimi ndërinstytucional, kjo në zbatim të kërkesave të ligjit nr.81/2020, Mangësitë e konstatuara janë:

- Mos kthim përgjigje zyrtare ndaj kërkesave për bashkëpunim drejtuar DRFPP për rifillimin/implementimin e kurseve profesionale;
- Mos referimi i saktë i rasteve të të burgosurve të interesuar për ndjekjen e kurseve profesionale gjatë vuajtjes dënimit në IEVP¹¹¹;
- Mungesë planifikimi periodik tremujor dhe vjetor lidhur me procesin e formimit profesional në IEVP, si mjet për ndjekjen e realizimit të treguesve në këtë proces;
- proces arsimor formal dhe mosfillimi e mësimit në disa IEVP, sipas afateve të viti mësimor sipas pregrameve të miratuara;
- Vështirësi procedurale, për shkak të kriterit të plotësimit të dosjes personale të të burgosurve me vërtetim lëshuar nga autoritetet arsimore në rrethe në kuadër të nivelit arsimor përkatës .
-Mungesë mbështetje me specialistë nga autoritetet arsimore, gjatë përgatitjes së dokumentacionit përkatës shkollor të burgosurve, në rastin e hapjes së viti të ri shkollor, ndërprerjes së procesit arsimor për shkak të transferimit të tyre, mosndjekjes së procesit arsimor nga fillimi i vitit shkollor, etj;
- Vështirësi për sigurimin e transportit të instruktorëve që do të zbatojnë kurset profesionale në IEVP në rastet e largësisë së konsiderueshme së IEVP nga DRFPP;
- Vështirësi për sigurimin e infrastrukturës të përshtatshme dhe të mjaftueshme (ambiente, laboratorë e klasa me bazë teknike sipas profesionit) për realizimin e procesit të formimit profesional në IEVP-të;
- Mungesë buxheti të dedikuar për formimin profesional të të burgosurve, ka penguar zgjerimin e kurseve profesionale, zhvillimin vetëm në nivel teorik jo praktik dhe rrit mungesën e interesit për frekuentim nga të burgosurit, etj.

25. Gjetje nga auditimi: Personat e dënuar nuk referohen nga zyrat e punës në njësitë e vetëqeverisjes vendore si kategori të veçanta për punësim, por konsiderohen të papunë, jo klientë të Zyrave të Punës, sepse:

- Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” nuk i ngarkon NJVQV-të me detyrimin për të pasur programe të posaçme për ish-të dënuarit. Bashkitë nuk kanë strukturë dedikuar për riintegrim.
- Ligji nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nuk i ngarkon NJVQV-të me detyrimin për të pasur programe të posaçme për ish-të dënuarit.

¹¹⁰ Përgjigje pyetësori

¹¹¹ Pranë institucioneve përkatëse shtetërore përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të formimit profesional

Kjo ka sjellë mungesë informacioni në Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim/Qendrat e Formimit Profesional për rastet e referuara, mungesën e programeve post-penale, të individualizuara, josukses për ato pak raste të referuara, si dhe mungesën e strukturave të dedikuara për riintegrim pranë NJVQV-ve.

- Bazuar në pikën 3, të nenit 12, të Ligjit nr. 81/2020, dosjet personale/psikosociale, rezultojnë me mangësi dhe plotësuar vetëm nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Regjistrat e punësimit, plotësohen formalisht, me mungesa të dhënash për punësimin, si planifikimi mujor i punës, organika e punës, kontratat e firmosura nga titullari për të dënuarit e punësuar, etj. Shumë ish të dënuar nuk kanë aftësi të përditësuara pune ose përvojë pune përkatëse.

-Numri i ulët i të burgosurve të përfshirë në aktivitetet social edukative ka ardhur si rezultat i mungesës së bashkëpunimit gjatë përpilimit të dokumentacionit të nevojshëm të të burgosurve, si një evidencë kriter për përfshirje në këto aktivitete, si edhe me mungesa e zërit në buxhet për krijimin e workshop-eve në I EVP. (DPB/MD, MAS, MEKI). Gjithashtu, në disa I EVP nuk ka regjistër për aktivitetet e realizuara.

26. Gjetje nga auditimi: Qendrat e formimit profesional/Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim nuk kanë kryer monitorime të vazhdueshme të cilësisë së formimit profesional, si dhe analizimin e hollësishëm të progresit të kurseve të zhvilluara, si dhe implementimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional për raportimin, organizimin e monitorimeve të përbashkëta, me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe aktorët e tjerë në proces.

- Në qendrat e formimit profesional nuk ekziston një pozicion specifik në strukturë që i dedikohet formimit profesional në I EVP. Ky rol ndiqet nga përgjegjësi i njësisë së zhvillimit, i cili, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit, është përgjegjës për koordinimin e këtij procesi.

27. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës objekt auditimi nuk janë miratuar marrëveshjet me operatorët ekonomikë për punësimin e të dënuarve (në I EVP – të Rrogozhinë, Shkodër, Fier etj), bazuar në kërkesat e ligjit nr. 81/2020 që i lejon për të bashkëpunuar me operatorë ekonomikë privatë. Nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, nuk është realizuar asnjë nismë për punësimin e të burgosurve nëpërmjet operatorëve ekonomikë, komunitetit të biznesit, kompanive, apo vetëpunësim, në objekt jashtë ose brenda institucionit.

11. Konkluzion: Mosrinovimi në kohë i marrëveshjeve, mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional midis strukturave përgjegjëse, si dhe mungesa buxhetit të dedikuar për arsimim dhe formimin profesional të të burgosurve, impakton mospërbushje të detyrimeve nga institucionet përkatëse si dhe arsimim dhe formim profesional të paqëndrueshëm dhe pa interes nga personat e dënuar, gjë e cila reflektohet në numrin e vogël të përfituesve.

12. Konkluzion: Në mungesë të trajtimit ligjor si kategori vulnerabël/me nevoja të veçanta, si dhe në mungesë të bashkëpunimit ndërinstitucional për hartimin e dosjeve personale/psikosociale të plota për referimin e tyre, programeve post-penale të individualizuara pëer integrimin në shoqëri, ish të burgosurit do ta kenë të vështirë rilidhjen e tyre me komunitetin dhe rritjen e vetëvlerësimit, vetëbesimit dhe vetë-efikasitetit të tyre. Aktivitetet social edukative në sistemin e burgjeve ndikojnë në fuqizimin e network-ut dhe mekanizmit të referimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim lehtësimin e riintegrimit të të dënuarve në komunitet.

13. Konkluzion: Në mungesë të monitorimeve të vazhdueshme të, cilësisë së formimit profesional, analizimit të hollësishëm të progresit të kurseve të zhvilluara, implementimit të mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional për raportimin, organizimin e monitorimeve

të përbashkëta, trajtimi i personave të dënuarve, nuk do t'i realizojë pritshmëritë e kërkuara nga standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

14. Konkluzion: Mungesa e marrëveshjeve me OE dhe komunitetin e biznesit, aktor në procesin e ri-integrimit të personave të dënuar, në konflikt me ligjin vështirëson trajnimin dhe punësimin e tyre. Komuniteti i biznesit do të ishte tejet mbështetës në ofrimin e mundësive të trajnimit për t'i ndihmuar ish-burgosurit të zhvillojnë aftësi që janë të kërkuara në tregun e punës.

24.1. Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Arsimit, të marrin masat e duhura për të respektuar detyrimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit, lidhur me planifikimin dhe organizimin e procesit arsimor dhe kurseve të formimit profesional, për të garantuar koordinimin ndërinstitucional dhe procese efektive sistematike dhe të qëndrueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

25.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, të ndërmarrin të gjitha nismat e nevojshme për përmirësimet ligjore me njësitë e vetëqeverisjes vendore, lidhur me përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të aktorëve, në procesin e trajtimit të të burgosurve si kategori e veçantë për punësim, me synim rritjen e vetëvlerësimit, vetëbesimit dhe riintegrit të tyre në shoqëri.

Menjëherë dhe në vijimësi

25.2 Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe strukturat e tjera përgjegjëse për trajtimin e të burgosurve, të marrin masat për rishikimin dhe plotësimin e dosjeve personale/psikosociale me dokumentacionin përkatës, regjistrave të punësimit, regjistër të aktiviteteve social edukative, etj., me synim hartimin e programeve post-penale, të individualizuara, referimin e rasteve të suksesshme sipas nevojave të posaçme të secilit të burgosur.

Menjëherë dhe në vijimësi

26.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim/Qendrat e Formimit Profesional, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve të marrin masat për të kryer monitorime të vazhdueshme të cilësisë së formimit profesional, analizimin e hollësishëm të progresit të kurseve të zhvilluara, si dhe të rishikojnë strukturën organizative të qendrave të formimit profesional, me synim përcaktimin e një pozicioni specifik që t'i dedikohet formimit profesional në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Menjëherë dhe në vijimësi

27.1 Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve dhe Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim, të marrin masat dhe të nxisin më tej miratimin e marrëveshjeve me operatorë ekonomikë dhe komunitetin e biznesit, në realizimin e nismave sociale për punësimin e të dënuarve, si pranë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, ashtu dhe pranë operatorëve ekonomikë, para dhe pas lirimit nga burgu.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

